



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
MISIONI NË KOSOVË**

**Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete**

## **STRUKTURAT PARALELE NË KOSOVË**

*2006-2007*

## TABELA E PËRMBAJTJEVE

I. FJALORI .....	- 3 -
II. HYRJE .....	- 5 -
III. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	- 6 -
IV. REKOMANDIMET .....	- 9 -
A. Zvogëlimi i kërkesës .....	- 10 -
Gjykatat.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Siguria .....	- 10 -
Prona .....	- 10 -
Shkollat .....	- 11 -
Kujdesi shëndetësor .....	- 11 -
B. Zvogëlimi i ofertës .....	- 12 -
Gjykatat.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Siguria .....	- 12 -
Shkollat .....	- 13 -
Kujdesi shëndetësor .....	- 13 -
C. Masat për zbatimin e politikave .....	- 14 -
Gjykatat.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Siguria .....	- 14 -
Prona .....	- 14 -
Kujdesi shëndetësor .....	- 14 -
1. GJYKATAT PARALELE .....	- 16 -
1.1. Historiku .....	- 16 -
1.2. Struktura e gjykatave paralele ekzistuese .....	- 18 -
1.2.1 Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica.....	- 18 -
1.2.2 Prishtina/Priština .....	- 18 -
1.2.3. Rajoni i Gjilanit/Gnjilane.....	- 19 -
1.2.4 Rajonet e Pejës/Peç dhe Prizrenit .....	- 20 -
1.3. Aktivitetet e gjykatave paralele dhe reagimet.....	- 20 -
1.4. Shqetësimet e tanishme dhe analizat.....	- 21 -
1.4.1 Rreziku i aktgjykimeve kundërshtuese, hutia publike dhe shpenzimet e dyfishta nga jurisdikcioni përputhës dhe gjykatat e UNMIK-ut.....	- 22 -
1.4.2 Parimi i mosgjykimit të dyfishtë për të njëjtën vepër penale.....	- 23 -
1.4.3 Njohja e aktvendimeve jopenale .....	- 25 -
2. STRUKTURAT PARALELE – SIGURIA .....	- 26 -
2.1. Hyrje – sfondi historik .....	- 26 -
2.2. Zhvillimet dhe gjendja e tanishme .....	- 27 -
3. STRUKTURAT PARALELE ADMINISTRATIVE ME KOMPETENCA NË FUSHËN PRONËSORO-JURIDIKE .....	- 30 -
3.1 - Historiku .....	- 30 -

3.1.1 Bashkëpunimi ndërmjet UNMIK-ut, IPVQ-ve dhe Republikës së Serbisë ...	31 -
3.2 Strukturat paralele administrative që gjenden në territorin e Kosovës .....	32 -
3.2.1 Drejtoratet komunale të urbanizimit dhe drejtoratet për çështje pronëso- juridike .....	33 -
3.2.2. Zyret e Autoritetit të Gjeodezisë së Republikës së Serbisë .....	33 -
3.3 Strukturat paralele administrative që gjenden jashtë territorit të Kosovës ..	34 -
4. ARSIMIMI PARALEL .....	35 -
4.1 Strukturat .....	35 -
4.2 Shkaktarët dhe efektet e strukturave paralele në arsim .....	35 -
4.2.1 Shkaktarët e strukturave paralele .....	35 -
4.2.1.1 Mungesa e perceptuar e sigurisë .....	36 -
4.2.1.2 Qëndrimet e komuniteteve të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës kundrejt tolerancës dhe gjetja e bazës së përbashkët .....	36 -
4.2.1.3 Heqja dorë nga pagat e IPVQ-ve të serbëve të Kosovës .....	38 -
4.3.1. Efektet e strukturave paralele .....	40 -
4.3.1.1. Planprogrami ndryshues .....	40 -
4.3.1.2 Ndikimi në fëmijë dhe cilësia e arsimit .....	42 -
4.4 Arsimi terciar .....	44 -
5. KUJDESI SHËNDETËSOR PARALEL .....	45 -
5.1. Strukturat .....	45 -
5.2. Shkaktarët dhe efektet e strukturave paralele .....	46 -
5.2.1. Shkaktarët e strukturave paralele të kujdesit shëndetësor .....	46 -
5.2.1.1. Qëndrimet në mesin e komunitetit të serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës dhe mungesa e dialogut në nivel qendror .....	46 -
5.2.1.2. Mungesa e dialogut në nivel qendror .....	47 -
5.2.1.3. Heqja dorë e bërë rishtaz e pagave të IPVQ-ve nga serbët e Kosovës	48 -
-	-
5.2.1.4. Pagesa e pagave të dyfishta nga MSSH .....	51 -
5.2.2 Efektet e strukturave paralele të kujdesit shëndetësor	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5.2.2.1. Standardi i objekteve të kujdesit shëndetësor dhe mbikëqyrja nga MSSH – ndikimi në pacientët dhe cilësia e shërbimeve të kujdesit shëndetësor .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5.2.2.2 Mbikëqyrja e strukturave paralele të kujdesit shëndetësor nga MSSH .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5.2.2.3. Mundësitë për profesionistët mjekësor, shkëmbimi i informatave profesionale dhe arsimimi i vazhdueshëm mjekësor .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6. PËRFUNDIMET .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Shtojca I: Institucionet e arsimit paralel në Kosovë	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Shtojca II: Institucionet paralele të kujdesit shëndetësor në Kosovë .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## **I. FJALORI**

### **N**

Nënkryetari i Kuvendit Komunal (NKK)

### **K**

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNj)

### **F**

Republika Federative e Jugosllavisë (IRJ)

### **K**

Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB)

Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB)

### **P**

Personat e zhvendosur (PZH)

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP)

### **A**

Agjencioni Kadastral i Kosovës (AKK)

Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK)

Forca e Kosovës (KFOR)

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)

Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK)

Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK)

Plani për Implementimin e Standardeve të Kosovës (PISK)

### **M**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF)

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

Ministria e Shëndetësisë (MSH)

Ministria e Drejtësisë (MD)

Kryetari i Kuvendit Komunal (KKK)

### **N**

Organizata e Paktit Veriatlantik (NATO)

### **O**

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë (OSBE)

Qendra Regjionale e Misionit në Kosovë të OSBE-së (QR)

Ekipi Komunal i OSBE-së (EK)

**P**

Programa de Apoyo a la Democracia Municipal (PADEM)  
Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i zbatueshëm në Kosovë (KPPPK)  
Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ)

**SH**

Shtabi i Policisë Regjionale (SHPR)  
Autoriteti i Gjeodezisë së Republikës së Serbisë (ARRS)

**M**

Ministria Serbe e Arsimit dhe Sporteve (MSAS)  
Ministria Serbe e Punëve të Brendshme (*Ministarstvo Unutrasnih Poslova* – MPB)  
Ministria Serbe e Shëndetësisë (MSSH)  
Ministria Serbe e Drejtësisë (MSD)  
Këshilli Nacional Serb (KNS)  
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP)

**K**

Komiteti i Bashkuar Metodist për Ndhim (UMCOR)  
Administrata e Kombeve të Bashkuara në Mitrovicë/Mitrovica (AKB)  
Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK)  
Zyra e Kombeve të Bashkuara e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për procesin e statusit përfundimtar për Kosovën (UNOSEK)  
Policia Civile e UNMIK-ut (CIVPOL)  
Departamenti i Administratës Civile të UNMIK-ut (DAC)  
Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)

**U**

Ushtria e Jugosllavisë (Vojska Jugosllavija-UJ)

## II. HYRJE

Pas përfundimit të fushatës së NATO-s në vitin 1999, serbët e Kosovës të cilët mbetën në Kosovë nuk njohën menjëherë Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK). Faktorët e ndryshëm siç janë kufizimet në mungesën e lirisë së lëvizjes kanë kontribuar në përjetësimin *de facto* të administratës serbe. Në zonat e banuara me serb të Kosovës strukturat e tilla siç janë gjykatat, shkollat dhe spitalet vazhdojnë të përgjigjen drejtpërdrejt Beogradit duke vepruar kështu paralelisht me administratën e UNMIK-ut.

Në këtë raport, termi i përgjithshëm *strukturat paralele* përdoret për të përkufizuar organet dhe institucionet të cilat kanë qenë dhe janë duke vepruar në Kosovë që nga 10 qershori 1999 dhe të cilat nuk e kanë mandatin në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Në shumicën e rasteve, këto institucione veprojnë në bazë të *de facto* pushtetit serb dhe ushtrojnë jurisdikcionin e tyre ndaj Kosovës nga Serbia apo veprojnë në territorin e Kosovës. Këto struktura paralele veprojnë në mënyrë të njëkohshme me, apo shpeshherë madje edhe nën të njëjtën çati sikurse edhe organet e njohura të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ).<sup>1</sup> Në këtë drejtim është me rëndësi të ceket se Plani për Implementimin e Standardeve të Kosovës (PISK), edhe pse nuk ka karakter detyrues ligjor, kërkon që strukturat paralele të ç'instalohen apo të integrohen në kuadër të IPVQ-ve.<sup>2</sup>

Qëllimi i këtij raporti është që të përshkruajë dhe analizojë efektet e strukturave paralele që veprojnë në Kosovë dhe të ofrojë një informim për gjendjen që nga viti 2003 kur Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë (OSBE) kishte nxjerrur raportin e fundit për strukturat paralele në Kosovë. Gjykatat paralele, strukturat paralele të sigurisë, strukturat paralele administrative që kanë të bëjnë me çështjet pronëso-ro-juridike dhe institucionet paralele të kujdesit shëndetësor janë çështjet kryesore që shqyrtohen nga ky raport. Raporti nuk mëton që të mbulojë çdo aktivitet të qeverisë serbe në territorin e Kosovës.<sup>3</sup>

Ky raport ndahet në pesë kapituj, ku secili prej tyre ofron një pasqyrë të gjendjes së tanishme dhe analizë të efekteve të strukturave paralele të cilat ekzistojnë në Kosovë në vitin 2006. OSBE-ja bëri rekomandime specifike në vitin 2003 për atë se si duhet të zgjidhen disa nga problemet që kanë të bëjnë me strukturat paralele në Kosovë. Ky

---

<sup>1</sup> Organet administrative përgjegjëse për çështjet pronëso-ro-juridike e themeluar pas 10 qershorit 1999 ndonjëherë njohin mandatin e UNMIK-ut mirëpo gjithashtu veprojnë nën pushtetin *de facto* të Beogradit.

<sup>2</sup> Standardi 1 për funksionimin e institucioneve demokratike; veprimet 1.1 – 1.3 kërkojnë nga IPVQ-të dhe UNMIK-u që të hartojnë një strategji për zvogëlimin e kërkesës për strukturat paralele dhe ç'instalimin e tyre dhe integrimin e tyre në strukturat e IPVQ-ve; të fillohet me implementimin e strategjisë dhe të negociohet me Beogradin për çështjet teknike.

<sup>3</sup> Për shembull pensionet e paguara nga autoritetet serbe.

raport përmban rekomandimet të cilat marrin parasysh gjendjen e tanishme politike dhe procesin negociator për statusin përfundimtar të Kosovës.

### III. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ekzistimi i strukturave paralele vazhdon të ketë një ndikim kyç në shoqërinë kosovare. Ky raport ofron një pasqyrë të strukturave paralele ekzistuese në Kosovë dhe është një vazhdim i “Raportit të strukturave paralele në Kosovë” të nxjerrë nga OSBE-ja në tetor të vitit 2003. OSBE-ja ka shqyrtuar strukturat paralele në fushat e gjykatave, strukturave të sigurisë në veriun e Kosovës,<sup>4</sup> drejtat pronëso-ro-juridike, arsimin dhe kujdesin shëndetësor në Kosovë që ka për qëllim të vlerësojë vendimet e marra nga dhe shërbimet e ofruara nga këto struktura si dhe efektet e tyre në shoqëri.

Gjetjet e OSBE-së bëjnë me dije se ekzistimi i vazhdueshëm i strukturave paralele në këto fusha është rrjedhojë e tre faktorëve:

- Kërkesa për strukturat paralele është e lidhur me mungesën e vazhdueshme të qasjes nga disa pjesëtarë të komunitetit serb në shërbimet e UNMIK-ut dhe IPVQ-ve. Pozicionimi i enklavave monoetnike ka sforcuar kufizimet në lirinë e lëvizjes. Kjo e ka vështirësuar edhe më shumë qasjen në shërbime të komuniteteve pakicë, përfshirë këtu kujdesin shëndetësor, arsimin dhe ndihmën sociale. Është vështirë të parashikohet zvogëlimi i kërkesës dhe ofertës dhe integrimi i këtyre strukturave pa e siguruar së pari qasjen e barabartë në shërbime për të gjithë.
- Mungesa e vazhdueshme e besimit të serbëve të Kosovës në UNMIK-un dhe IPVQ-të e bazuar në perceptimet e tyre të sigurisë dhe ndjenja e diskriminimit nga ana e IPVQ-ve. Faktorët kryesor se pse serbët e Kosovës preferojnë të shfrytëzojnë objektet shëndetësore në enklavat e tyre dhe në veri të Kosovës raportohet të jenë shqetësimet e sigurisë dhe mosbesimi në cilësinë e shërbimeve të ofruara nga IPVQ-të. Duhet bërë përpjekje të vazhdueshme dhe të shtuara për trajtimin e këtyre shqetësimeve nëpërmjet përpjekjeve më aktive të depërtimit tek këto komunitete dhe aranzhimeve më fleksibile të ofrimit të shërbimeve.
- Përfundimisht, gjendja politike dhe çështja e pazgjidhur e statusit janë pengesë e madhe në integrimin e strukturave paralele. Janë ndërmarrë disa nisma në nivel lokal dhe disa të tjera nga bashkësia ndërkombëtare për të filluar me integrimin e strukturave paralele në strukturën qeverisëse të Kosovës. Gjithashtu ato nuk kanë pasur ndonjë ndikim më të madh për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe strategjisë gjithëpërfshirëse të hartuar nga ana e palëve kryesore të prekura. Shpresohet se marrëveshja në arritje e sipër për statusin do të mundësojë marrëveshjet për integrimin e këtyre strukturave.

Shumë nga këto pika janë ilustruar në kapitullin fillestar të raportit për gjykatat paralele të cilat veprojnë në Kosovë. Ato janë analizuar në disa raste të ndryshme dhe për to është raportuar rregullisht nga OSBE-ja që nga viti 1999. Sistemi i gjykatave paralele, i cili ka filluar në vitin 1999 dhe vazhdon edhe sot, vështirëson seriozisht vendosjen e sundimit të ligjit në Kosovë. UNMIK-u (dhe akterët e ardhshëm

---

<sup>4</sup> Për qëllime të këtij raporti referimi “veri i Kosovës” mbulon komunat e Leposavić/Leposaviqit, Zvečan /Zveçanit, Zubin Potokut dhe zonën e Mitrovica/Mitrovicës në veri të lumit Ibër.



ndërkombëtar) dhe autoritetet lokale në Kosovë duhet të adresojnë çështjet si në vijim përkitazi me sistemin e gjykatave:

- 1) Njohja, apo mosnjohja e aktvendimeve gjyqësore nga gjykatat paralele para së gjithash për periudhën ndërmjet vitit 1999 dhe janar 2003;
- 2) Dilema e mosakuzimit të dyfishtë për të njëjtën vepër penale me të cilën janë përballur gjyqtarët dhe prokurorët e UNMIK-ut në frymën e aktvendimeve gjyqësore të pruara nga gjykatat paralele të qarkut në Serbi; dhe
- 3) Ç'instalimi apo integrimi i sistemit të gjykatave paralele.

UNMIK-u dhe autoritetet lokale në Kosovë ende nuk e kanë adresuar çështjen nëse apo si të transferohen lëndët që janë në zgjidhje e sipër nga gjykatat paralele në gjykatat e UNMIK-ut. Çka është më e rëndësishme, nuk ekziston ndonjë marrëveshje me qeverinë e Serbisë për trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve që kanë buruar nga ushtrimi i kompetencave nga gjykatat paralele serbe për lëndët që bijnë në jurisdikcionin e gjykatave të UNMIK-ut. Njerëzit duhet të jenë në gjendje të fitojnë aktgjykime që janë të njohura në mënyrë ligjore si në Kosovë ashtu edhe në Serbi.

Në kapitullin e vet të dytë, raporti shqyrton disa nga rrethanat e posaçme që i përkasin gjendjes së sigurisë në veri të Kosovës dhe ilustron disa nga këto pika. Që nga qershori 1999, ekzistojnë disa nga dy subjektet kryesore të përfshira në sigurinë paralele në veri të Mitrovicës, të ashtuquajturit “Rojet e Urës,” dhe policia e Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme (*Ministarstvo Unutrasnih Poslova* – MUP). Prania e tyre e vazhdueshme, në mesin e arsyeve tjera, përfshirë këtu edhe politizimin e vazhdueshëm nga ana e liderëve politik vendës dhe të Beogradit të incidenteve penale është rrjedhojë e vazhdimësisë së incidenteve penale në atë zonë dhe mungesës së besimit të popullatës në përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare dhe IPVQ-ve për të parandaluar ndodhjen e tyre. Tensionet e vazhdueshme në veri dhe diskutimet në vazhdim për pozitën e saj në Kosovën e pas-statusit, një sasi e kufizuar e informatave është mundur të mbledhet për strukturat paralele të sigurisë për këtë raport.

Efektet e strukturave paralele që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore, qasjen në arsim dhe qasjen në kujdesin shëndetësor ngrisin çështje shtesë. Nëse shiqojmë të drejtat pronësore është alarmues ndikimi i dëmshëm i strukturave paralele në realizimin e kësaj të drejte; përfundimisht kjo mund të shpiejë dhe ka shpjer në humbjen e pronës private nga individët. Sa i përket arsimit, fëmijët kosovar nuk pranojnë të njëjtin arsim për shkak të ekzistimit të dy sistemeve shkollore me planprograme të ndryshme. Në vitet e fundit, autoritetet kanë lejuar zhvillimin e strukturave të ndara në vend se të adresojnë çështjen e diskriminimit në kujdesin shëndetësor. IPVQ-të duhet të krijojnë një shërbim publik të integruar për të adresuar mungesën e ofertës së mjaftueshme të kujdesit shëndetësor dhe arsimit për komunitetin serb. Krahas kësaj, segregacioni në shërbimet publike dhe në veçanti ideja që një komunitet mundet të shërbehet vetëm nga pjesëtarët e komunitetit të vet duhet të trajtohet dhe të zgjidhet si çështje.

Në shumë raste strukturat paralele veprojnë si një sistem de facto i mirëqenies sociale. Veçanërisht gjendja e tillë mbizotëron në kujdesin shëndetësor dhe arsim ku ata kanë më shumë staf se që duhet. Sipas zyrtarëve të Departamentit të UNMIK-ut për Administratë Civile (DAC), numri i të punësuarve në sistemin paralel të shëndetësisë

në Prishtinë/Priština ofron shërbime për më shumë se 400,000 njerëz. Në këtë drejtim një burim shtesë i të ardhurave nga strukturat paralele mbetet një faktor me rëndësi në mbajtjen e një numri të madh të serbëve në Kosovë.

Kompleksiteti i çështjes bën me dije se vullneti politik nevojitet që të mobilizohet në të gjitha anët për zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse që kërkohet për integrimin e strukturave paralele. Kjo strategji duhet të trajtojë në mënyrë sistematike anën e kërkesës dhe ofertës paralele të ofrimit të shërbimeve dhe zhvillojë mjete për zbatimin e politikave.

Mbyllja e thjeshtë e strukturave paralele që merren me kujdesin shëndetësor dhe arsimin nuk është një zgjidhje e pranueshme. Synimi përfundimtar duhet të jetë përfshirja gjithëpërfshirëse e shërbimeve ekzistuese paralele në një sistem të unifikuar. OSBE-ja ka përpiluar një varg rekomandimesh për IPVQ-të dhe bashkësinë ndërkombëtare, veçanërisht për UNMIK-un dhe pasardhësin e tij të mundshëm.

#### IV. REKOMANDIMET

Ende nevojitet një politikë koherente përkitazi me strukturat paralele në Kosovë. Për shkak se strukturat paralele kanë lindur pjesërisht për shkak të mungesës së qasjes apo alternativave për disa banorë dhe pjesërisht për shkak të mungesës së besimit dhe perceptimeve të përgjithshme të mjedisit të sigurisë si dhe mungesës së vullnetit politik për t'u angazhuar në mënyrë konstruktive në këtë çështje. Si rrjedhojë, OSBE-ja beson se një strategji gjithëpërfshirëse nevojitet dhe jo të gjitha strukturat paralele mund të trajtohen në të njëjtën mënyrë.

Disa vëzhgime gjithëpërfshirëse për muajt që vijnë burojnë nga ky raport:

- IPVQ duhet të zhvillojë alternativa të zbatueshme të strukturave paralele;
- Nuk duhet të ekzistojë ndonjë mbyllje e detyrueshme e strukturave paralele derisa të arrihet marrëveshja për statusin;
- Bashkësia ndërkombëtare duhet të kërkojë adresimin e shkaktarëve të strukturave paralele gjatë implementimit të marrëveshjes për statusin nëpërmjet të marrëveshjeve për çështjet e decentralizimit dhe mbrojtjes së pakicave;
- Pas marrëveshjes për statusin të dyja palët mundësisht nëpërmjet të ndërmjetësimit të bashkësisë ndërkombëtare duhet të sigurojnë një integrim të qetë, efektiv dhe gjithëpërfshirës të strukturave paralele në Kosovën e pas-statusit; dhe
- Bashkësia ndërkombëtare duhet të ndihmojë në zbatimin e marrëveshjeve relevante që rezultojnë nga marrëveshja për statusin.

Për të adresuar faktorët kyç të cilët përcaktojnë ekzistimin e vazhdueshëm të strukturave paralele, OSBE-ja ka ndarë rekomandimet në tri kategori:

- Kategoria e parë ka për qëllim *zvogëlimin e kërkesës* për shërbimet e strukturave paralele, p.sh për të përmirësuar shërbimet e ofruara nga UNMIK-u dhe IPVQ-të dhe së këndejmi fitojë besimin e publikut;
- Kategoria e dytë ka për qëllim *zvogëlimin e ofertës së shërbimeve paralele* duke negociuar me ofruesit e shërbimeve paralele me qëllim të sigurimit të *zvogëlimit të shërbimeve*; dhe
- Kategoria e tretë ka për qëllim *zbatimin e politikave/masave të caktuara* të cilat mund të zbatohen nga aktorët relevant për të integruar ofruesit e shërbimeve paralele në strukturat qeveritare të Kosovës.

Të tri kategoritë e rekomandimeve janë të nevojshme për të zvogëluar dhe eventualisht eliminuar varshmërinë e disa komuniteteve nga strukturat paralele në Kosovë. Ato janë gjithashtu të domosdoshme për të ndihmuar në integrimin e strukturave paralele në strukturat qeveritare të Kosovës. Disa rekomandime janë të aplikueshme në më shumë se një kategori.

## **A. Zvogëlimi i kërkesës**

### Gjykatat

- UNMIK-u (apo pasaardhësi i tij) dhe autoritetet lokale duhet të vazhdojnë me rekrutimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit gjyqësor nga rradhët e serbëve të Kosovës duke i'u ofruar paga konkurruese. UNMIK-u duhet të bind autoritetet serbe për të ndihmuar në këtë proces duke inkurajuar serbët e Kosovës që të aplikojnë nëpër konkurset e shpallura në kuadër të gjyqësisë.
- UNMIK-u dhe IPVQ-të, veçanërisht Ministria e Drejtësisë, duhet të rivërtetojnë zotimin e tyre për të garantuar qasjen në drejtësi për komunitetet pakicë në komunat anembanë Kosovës. Për shembull, më shumë zyre ndërlidhëse dhe gjykata duhet të merren parasysh në zonat e banuara me komunitete pakicë. Për më tepër, një konsideratë dhe vlerësim i mëtejshëm duhet t'i kushtohet sigurisë, transportit dhe gjendjes së banimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve për ndërlidhje me gjykatat nga rradhët e serbëve të Kosovës.

### Siguria

- Bashkësia ndërkombëtare duhet të vazhdojë të forcojë multietnicitetin në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK) si tërësi.
- Bashkësia ndërkombëtare duhet të përkrah zhvillimin e SHPK-së në aspektin e pajisjeve adekuate dhe sigurojë pagat e mjaftueshme për shkak se një shërbim funksional policor është me rëndësi kruciale për zhvillimin e një gjendje stabile në Kosovë.
- Sa i përket serbëve në Kosovë perceptimet për sigurinë e tyre janë realitet i tyre dhe së këndejmi bashkësia ndërkombëtare duhet të kushtojë një vëmendje më të madhe shqetësimeve të sigurisë së serbëve të Kosovës duke dizajnuar përgjigje proporcionale ndaj incidenteve të caktuara.
- Bashkësia ndërkombëtare duhet t'i komunikojë shpejtë dhe në mënyrë efektive faktet e vërteta të incidenteve penale që prekin serbët e Kosovës me qëllim të kundërveprimit ndaj shpjegimeve të rrejshme dhe politizuara të bëra nga autoritetet e Beogradit dhe mediat si dhe liderët politik të serbëve të Kosovës.
- Këshillat komunal të sigurisë së komunitetit dhe veçanërisht këshillat lokal të sigurisë publike, të cilat janë vegla të vlefshme për të përmirësuar gjendjen e sigurisë dhe trajtuar shqetësimet e pakicave duhet të sforcohen dhe mbështeten.

### Prona

- Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) duhet të zhvillojë një fushatë informative në komunat veriore duke inkurajuar individët që të shfrytëzojnë shërbimet e ofruara nga Zyret Komunale Kadastrale të Kosovës.

### Shkollat

- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Ministria Serbe e Arsimit dhe Sporteve (MSAS) duhet të negociojnë për hartimin e një plani për të siguruar njohjen e ndërsjellë të diplomave dhe certifikatave dhe për të standardizuar kushtet për lëshimin e këtyre dokumenteve.
- IPVQ-të duhet të sigurojnë një buxhet për të siguruar që nevojat e popullatës serbe dhe asaj gorane të jenë të akomoduar në kuadër të sistemit shkollor të Kosovës. Kjo duhet të fillojë me hartimin dhe ofrimin e teksteve shkollore dhe materialeve tjera arsimore-edukative në gjuhën serbe dhe përfshijë financimin dhe ndihmën teknike për hartimin e pjesëve opcionale të planprogramit mësimor për temat që kanë të bëjnë me nevojat specifike të komunitetit dhe/apo për të ruajtur identitetin kulturor të tyre, besimet dhe traditat fetare. Kjo duhet të përfshijë një përmirësim të cilësisë së arsimit në dispozicion si dhe ofrimin e qasjes së barabartë në arsim për të gjitha grupet e pakicave.
- IPVQ-të duhet të krijojnë një Fond të Posaçëm për arsimin e pakicave; të menazhuar nga IPVQ-të nën mbikëqyrjen ndërkombëtare; me kontributet financiare nga qeveria e Kosovës, shtetet amë të pakicave (përfshirë Serbinë, Turqinë dhe Bosnjë Hercegovinën) dhe bashkësia ndërkombëtare. Ky fond do të ofrojë grante të posaçme për shkollat e pakicave për të mbuluar pagat shtesë të stafit, infrastrukturën, hartimin e planprogramit mësimor opcional (15 deri në 20% të planprogramit mësimor), përkthimi i planprogramit mësimor të Kosovës dhe materialeve mësimore në gjuhët e pakicave.
- IPVQ-të duhet të adresojnë nevojat e vazhdueshme për arsimim në gjuhët e pakicave duke garantuar pjesëmarrjen e komuniteteve në hartimin e planprogramit mësimor në gjuhën e tyre amtare dhe duke shfaqur fleksibilitet në implementimin e reformave arsimore për nxënësit të cilët ende nuk janë integruar në sistemin e ri arsimor. Nëse komuniteti nuk arrin pragun e krijuar prej 14 nxënësve për klasë siç parashikohet me formulën e implementuar nga Banka Botërore, atëherë duhet adresuar gjendjen nëpërmjet të masave alternative për të garantuar qasjen në arsim në gjuhën e tyre amtare.

### Kujdesi shëndetësor

- IPVQ-të duhet të punojnë drejt përmirësimit të cilësisë dhe infrastrukturës së institucioneve shëndetësore në tërë Kosovën. IPVQ-të duhet të vërtetojnë zotimin e tyre për të garantuar qasjen në kujdes shëndetësor cilësor për të gjitha komunitetet në të gjitha komunat e Kosovës.
- Ministria e Shëndetësisë (MSH) duhet të themelojë objekte shumë cilësore multietnike të kujdesit shëndetësor të cilat punësojnë si staf shqiptar ashtu edhe serb në lokacionet të cilat do të jenë të qasshme nga të dyja komunitetet. Për më tepër, MSH duhet të promovojë struktura të tilla multietnike në mesin e të gjitha komuniteteve. Krahas kësaj, ekipet mobile multietnike të profesionistëve të kualifikuar, përfshirë këtu edhe në fushat e specializuara të mjekësisë duhet të vizitojnë rregullisht apo madje edhe të stacionohen në zonat

e largëta të banuara me pjesëtarë të pakicave të cilët përballen me vështirësi në qasjen në qendrat kryesore mjekësore.

- IPVQ-të duhet të adresojnë në mënyrë efektive çështjet përmbajtësore që kanë të bëjnë me qasjen e pakicave në shërbimet e kujdesit shëndetësor; kryesisht qasja e kufizuar në shërbimet sekondare dhe emergjente të kujdesit shëndetësor për komunitetet pakicë që jetojnë në enklava; distribuimi i keq i personelit mjekësor; mungesa e pajisjeve të specializuara dhe mjeteve të transportimit; shërbimet e pamjaftueshme gjinekologjike, oftamologjike dhe dentare dhe gjendja e dobët shëndetësore e disa komuniteteve pakicë, veçanërisht në rradhët e komunitetit rom.

## **B. Zvogëlimi i ofertës**

### Gjykatat

- Mekanizmat duhet të krijohen për të parandaluar proceset e dyfishta gjyqësore dhe për të siguruar qartësinë juridike për individët të cilët veç kanë fituar vendime nga gjykatat paralele. Duke e bërë një gjë të tillë, autoritetet duhet të kenë parasysh faktin që ndërmjet vitit 1999 dhe janarit 2003 në disa zona të Kosovës, gjykatat paralele ishin i vetmi forum praktik gjyqësor. Mekanizmat e tillë mund të jenë si në vijim:
  - a. Bashkësia ndërkombëtare mundet të vendos prezumimin e ligjshmërisë (prezumimi) me të drejtën për ankesë për aktvendimet gjyqësore civile dhe aktet e gjykatave paralele. (Duke e bërë një gjë të tillë, UNMIK-u apo pasardhësi i tij duhet të përcaktojë nëse një gjë e tillë do të mbulonte tërë periudhën në fjalë, 1999 – 2006, apo nëse do të mbulonte vetëm periudhën 1999 – janar 2003);
  - b. Kolegji për rishikim gjyqësor mund të themelohet nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut (apo pasardhësit të tij) për të përcaktuar ligjshmërinë e aktvendimeve dhe akteve që nuk mbulohen me prezumimin dhe për të vendosur përkitazi me ankesat;
  - c. UNMIK-u mundet të merr parasysh procedurën e bartjes së lëndëve të pazgjydhura nga gjykatat paralele në gjykatat e UNMIK-ut; dhe
  - d. Një mekanizëm mund të krijohet për të zgjidhur gjendjen në të cilën ekzistojnë aktvendimet e gjykatave të UNMIK-ut dhe atyre paralele që e kundërshtojnë njëra tjetrën.

### Siguria

- Bashkësia ndërkombëtare duhet të vazhdojë me përkrahjen e trajnimit dhe regjistrimit të kadetëve serb të Kosovës në Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK) dhe çka është me rëndësi të sigurojë një staf të mjaftueshëm dhe të rregullt me oficerë serb të SHPK-së në SHSHPK. Krahas kësaj, të gjithë kadetët e SHPK-së duhet të trajnohen në SHSHPK me qëllim të sigurimit të kohezionit në kuadër të SHPK-së.

### Shkollat

- Duhet të arrihet marrëveshje ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës/Priština, që ka për qëllim krijimin e një sistemi të unifikuar arsimor në Kosovë që është i pranueshëm për të gjitha komunitetet. Kjo marrëveshje duhet të përfshijë integrimin e sistemit të MSAS-së në MASHT. Përvojat belge, spanjolle dhe italiane në krahinat autonome të Bolzanos/Bozen dhe Trentos, ku sistemi arsimor është decentralizuar mund të konsiderohen si shembuj të dobishëm për marrëveshjet e tilla.
- IPVQ-të duhet të synojnë përmirësimin e cilësisë së stafit arsimor dhe të përkushtojnë më shumë burime në përmirësimin e infrastrukturës në institucionet akademike në tërë Kosovën për të siguruar akomodimin e të gjithë nxënësve të komuniteteve pakicë.
- IPVQ-të duhet të sigurojnë që fondet komunale shfrytëzohen për të subvencionuar përmirësimin e transportit shkollor, veçanërisht disponibilitetin e transportit të sigurtë për nxënësit nga rradhët e komuniteteve pakicë deri në objektet shkollore pavarësisht nga distanca.<sup>5</sup>

### Kujdesi shëndetësor

- Strukturat paralele të kujdesit shëndetësor duhet të ç'instalohen gradualisht dhe të integrohen në kuadër të një sistemi të unifikuar. Ç'instalimi dhe integrimi i strukturave paralele duhet të kuptohet si bashkim i institucioneve të udhëhequra nga Ministria Serbe e Shëndetësisë (MSSH) në një sistem të unifikuar. Një zgjidhje e mundshme mund të jetë "legalizimi" i të ashtuquajturave struktura paralele të kujdesit shëndetësor për shkak se në shumë raste ato ofrojnë mënyrën e vetme për serbët e Kosovës që të fitojnë qasje në kujdesin shëndetësor. Në këtë drejtim, institucionet e tilla duhet të mbahen dhe përmirësohen së bashku me institucionet e udhëhequra nga MSH.
- Pas marrëveshjes, IPVQ-të duhet të fillojnë me integrimin e strukturave paralele të kujdesit shëndetësor. Ky integrim mund të jetë i pranueshëm për serbët e Kosovës nëse IPVQ-ja do të bënte një zotim që të marrë përsipër një pjesë të shpenzimeve për institucionet shëndetësore për shkak se kjo do të siguronte një autonomi të sigurtë të objekteve që shërbejnë kryesisht pacientët serb të Kosovës. Për më tepër, IPVQ-të duhet të garantojnë cilësinë e trajtimit dhe lejimin e monitorimit ndërombëtar dhe serb të shërbimeve.
- Çështja e ofrimit të shërbimeve adekuate të kujdesit shëndetësor për komunitetet pakicë nuk duhet të politizohet dhe nuk duhet të shfrytëzohet si një vegël për Beogradin dhe Prishtinën/Priština për të arritur qëllimet e caktuara politike të tyre.

---

<sup>5</sup> Rregullorja Nr. 2002/19 për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, Neni 22.1 "Komuna rregullon transportin e sigurtë dhe efikas për nxënësit në arsimin e detyrueshëm për të ndjekur mësimet."

## **C. Masat e zbatimit të politikave**

### Gjykatat

- Marrëveshja për statusin dhe implementimi i saj duhet të ruajë si qëllim në negociatat për statusin zgjidhjen e problemeve që ndërlidhen me gjykatat paralele.

### Siguria

- Bashkësia ndërkombëtare duhet të vazhdojë të monitorojë ngushtë rezultatet e punës së SHPK-në dhe Policisë Civile të UNMIK-ut nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut sidomos në veri të Kosovës.

### Prona

- Bashkësia ndërkombëtare duhet të kërkojë të sigurojë që çfarëdo marrëveshje për statusin të përfshijë integrimin e të gjitha strukturave administrative paralele në institucionet e Kosovës që kanë mandat ligjor dhe ndërprerja e lidhjeve të tyre financiare me Republikën e Serbisë. Çdo marrëveshje për statusin duhet gjithashtu të sigurojë një mekanizëm monitorues që duhet të kryhet nga ana e bashkësisë ndërkombëtare për të siguruar që strukturat e reja t'i përmbahen kornizës ligjore të Kosovës.
- UNOSEK-u duhet të sigurojë që çfarëdo marrëveshje për statusin të përfshijë bartjen institucioneve të Kosovës të të gjitha shënimeve (evidencave) kadastrale dhe pronëso-ro-juridike të zhvendosura nga Kosova që për momentin mbahen në Serbi.
- UNOSEK-u duhet të sigurojë që çfarëdo marrëveshje për statusin të parashikojë implementimin e regjistrimit të të drejtave pronëso-ro-juridike në komunat veriore. Kjo do të kërkojë një fazë kalimtare në të cilën AKK-ja dhe Autoriteti i Gjeodezisë i Republikës së Serbisë (AGJRS) bashkëpunojnë në themelimin e Zyreve Komunale Kadastrale në komunat veriore dhe mbylljen e zyreve të zhvendosura kadastrale në Serbi.
- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovën (PSSP) duhet të nxjerr një sqarim që do t'ju drejtohet gjykatave dhe komunave përkitazi me vlefshmërinë e aktvendimeve administrative për lëndët pronëso-ro-juridike të lëshuara nga strukturat paralele në Serbi dhe vlefshmërinë e strukturave paralele administrative që veprojnë në territorin e Kosovës.

### Kujdesi shëndetësor

- “Praktikat e mira” të izoluar dhe sporadike dhe përpjekjet për bashkëpunim në nivelin lokal duhet të spikaten dhe promovohen anembanë Kosovës nga ana e IPVQ-ve. Bashkësia ndërkombëtare duhet të demonstrojë përkrahjen e vet për nismat lokale që kanë për qëllim arritjen e një sistemi të unifikuar të kujdesit shëndetësor në Kosovë.



- Të gjitha komunitetet e pakicave duhet të konsultohen plotësisht për çfarëdo arranzhime të ardhshme në fushën e kujdesit shëndetësor, përfshirë këtu edhe faktorët kyç siç janë perceptimet për mungesën e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes si dhe trajtimi i pakicave në institucionet e kujdesit shëndetësor.
- Duhet të sigurohet qasja e barabartë në punësim për profesionistët nga rradhët e komuniteteve pakicë në tërë Kosovën. Në këtë drejtim, IPVQ-të duhet të rekrutojnë në mënyrë proaktive më shumë profesionistë mjekësor nga rradhët e komuniteteve pakicë. Profesionistët mjekësor nga rradhët e të gjitha komuniteteve pakicë duhet të inkurajohen që të aplikojnë në konkurse. Personeli mjekësor që përbëhet nga personat e zhvendosur (PZH) të koncentruar në veri të Kosovës duhet të përfitojnë nga më shumë mundësi për zhvillim profesional brenda Kosovës.

## 1. GJYKATAT PARALELE

### 1. 1. Historiku

Shtatë vjet pas themelimit të vet, UNMIK-u ende nuk e ka fituar pushtetin e plotë ndaj procedurave gjyqësore në Kosovë. Një nga vështirësitë më të mëdha në themelimin e sistemit juridik koheziv në Kosovë ka qenë dhe vazhdon të jetë sistemi paralel serb i gjykatave.<sup>6</sup> Këto gjykata paralele, të cilat veprojnë në Kosovë dhe në Serbi parandalojnë krijimin e një mjedisi në të cilin të gjithë etnicitetet mundet të jetojnë duke gëzuar qasje në drejtësi në bazë të të njëjtit ligj. Gjykatat paralele aplikojnë ligjet që për momentin janë të zbatueshme në Serbi të cilat dallojnë nga ligjet e tanishme në Kosovë. Gjykata Supreme e Serbisë është organi përfundimtar i apelit për aktvendimet gjyqësore të formës së prerë të gjykatave paralele.

Gjer më tani, UNMIK-u ka ndërmarrë disa hapa konkret për të adresuar problemet ligjore dhe praktike të lindura si rrjedhojë e ekzistimit të sistemit të gjykatave paralele.<sup>7</sup> Hapa të rëndësishëm duhet të ndërmirren njëherë e përgjithmonë për të zgjidhur problemet e tilla, përndryshe kosovarët mundet të mbesin në gjendje të hutisë përkritazi me atë se cilave gjykata duhet t'u drejtohen ata. Kjo situatë ngritën shqetësimet e veçantë sot për shkak të bartjes së vazhdueshme të kompetencave në autoritetet lokale për shkak se ekziston rreziku që gjendja nuk mundet të adresohet në mënyrë të duhur në të ardhmen. UNMIK-u duhet të ngris përpjekjet për të zgjidhur këto probleme.

Disa vjet pas vitit 1999, sa i përket qasjes në drejtësi, pjesëtarët e komunitetit serb në veçanti janë mbështetur në gjykatat paralele. Në veri të Kosovës, gjykatat paralele kanë ofruar një varg të nevojave ligjore të popullatës serbe të Kosovës të cilat qoftë nkanë qenë në pamundësi ose nuk kanë pasur vullnet për t'ju qasur gjykatave të UNMIK-ut. Jo vetëm që ka pasur zbrastësi ligjore në gjyqësinë e administruar nga UNMIK-u në veri të Kosovës mirëpo edhe gjendja e sigurisë për serbët e Kosovës nuk ka lejuar gjithmonë që të udhëtohet lirisht në zonat ku gjykatat e UNMIK-ut kanë vepruar. Shfrytëzimi i gjykatave paralele nuk duhet domosdoshmërisht të

---

<sup>6</sup> Gjykatave paralele gjithashtu mund t'ju referohemi si gjykata të "zhvendosura". Zgjidhja për t'ju referuar atyre si "paralele" dhe jo si të "zhvendosura" do të thotë që të jetë në pajtim me praktikat paraprake siç janë përcaktuar nga UNMIK-u dhe OSBE-ja. Shih shqyrtimin *Strukturat Paralele në Kosovë*, tetor 2003, faqet 16 deri në 23, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimit të Ligjit të Misionit të OSBE-së në Kosovë.

<sup>7</sup> Bazat ligjore për juridikcionin e vetëm të gjykatave të UNMIK-ut në Kosovë është Rezoluta 1244 të Këshillit të Sigurimit, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/1 për pushtetin e administratës së përkohshme në Kosovë siç ndryshohet me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/25 dhe 2000/54 ("I gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv përkritazi me Kosovën, përfshirë administrimin e gjyqësisë, i është dhënë UNMIK-ut [...]"), dhe neni 9(4) i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Korniza Kushtetuese). Korniza Kushtetuese parashikon një strukturë të gjykatave të UNMIK-ut si "Gjykata Supreme e Kosovës, Gjykatat e Qarkut, Gjykatat Komunale dhe Gjykatat për Kundërvajtje." Ky kapitull nuk trajton ligjshmërinë e strukturave të gjykatave të tanishme paralele apo zgjidh statusin juridik të gjykatave paralele. Në vend të kësaj, ai përmbledh të dhënat për strukturat e tanishme të gjykatave paralele, përshkruan problemet të cilat lindin kur gjykatat paralele ushtrojnë kompetencën e tyre në lëndët të cilat bijnë në juridikcionin e gjykatave të UNMIK-ut dhe bën rekomandime për atë se si duhet të zgjidhen problemet.

interpretohet si një deklaratë politike nga ata që kanë shfrytëzuar gjykatat mirëpo në vend të kësaj ka qenë opcioni më i qasshëm. Deri më janar 2003 sistemi i gjykatave të administruara nga UNMIK-u nuk ishte vënë në dispozicion të banorëve që jetojnë në të gjitha rajonet e Kosovës.

Gjatë viteve të fundit gjykatat paralele, në mesin e aktiviteteve të tjera kanë udhëhequr procedurat civilo-juridike, procedurat hetimore dhe penale, lëndët trashëgimore, vërtetimin e dokumenteve dhe kërkesat për ndihmë gjyqësore nga gjykatat serbe dhe të huaja.<sup>8</sup> Hulumtimi i OSBE-së bën me dije se ndërmjet qershorit 1999 dhe janarit 2003,<sup>9</sup> gjykatat paralele komunale dhe të qarkut kishin dëgjuar apo lehtësuar në zhvillimin e përafërsisht 5,300 lëndëve vetëm të rajonit të Mitrovicës/Mitrovica.<sup>10</sup>

Krahas gjykatave paralele të cilat veprojnë në territorin e Kosovës, gjykatat komunale dhe të qarkut brenda Serbisë ende kërkojnë të ushtrojnë jurisdikcionin e tyre në Kosovë. Për shembull, gjykatat paralele të qarkut në Serbi ende veprojnë si gjykata të apelit për lëndët e dëgjua nga gjykatat paralele në Kosovë dhe gjykatat e shkallës së parë në lëndët e rënda penale të cilat lindin në Kosovë.

Ekzistimi i strukturës paralele të gjykatave është veçanërisht problematik përkitazi me lëndët penale për shkak të problemeve që lindin për shkak të parimit të mosgjykimit të dyfishtë për të njëjtën vepër penale – për shkak se i pandehuri mund të ndjeket penalisht apo dënohet dy herë për të njëjtën vepër penale. Për shkak të mungesës së udhëzimit të qartë nga UNMIK-u, prokurorët vendës në Kosovë kanë zhvilluar praktika kundërshtuese përkitazi me efektet e aktvendimeve gjyqësore në lëndët penale të prura nga gjykatat paralele në Serbi. Efekti në të pandehurit, veçanërisht në serbët e Kosovës të cilët kanë kaluar nëpër gjykime në Serbi dhe pastaj kthehen në Serbi ka qenë trazuese për shkak se ata nuk janë imun nga gjykimi i dyfishtë për të njëjtat akuza në gjykatën e UNMIK-ut.

Në të njëjtën kohë, duhet të ceket se gjykimet penale në gjykatat paralele në Serbi kanë pasur efekte të ngjashme trazuese përkitazi me viktimat e krimit. OSBE-ja ka identifikuar disa raste në të cilat gjykatat e qarkut në Serbi duke shqiptuar dënime më të lehta kanë shfaqur mospërfillje për standardet ndërkombëtare të drejtësisë. OSBE-ja ka vërejtur se kur të pandehurit serb të Kosovës kishin pranuar dënime më të lehta nga gjykatat paralele për krime të pohuara të kryera kundër shqiptarëve të Kosovës, aktvendimet e tilla gjyqësore kanë mundur të bihen me qëllim të parandalimit të procedurave penale kundër të pandehurve serbë të Kosovës në Kosovë.

---

<sup>8</sup> Shih *Strukturat paralele në Kosovë, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit, OSBE, Tetor 2003*, faqet 19-20.

<sup>9</sup> Këto statistika përkitazi me numrin e lëndëve të dëgjua bazohen në të dhënat e raportuara në *Strukturat Paralele në Kosovë, tetor 2003 i Departamentit për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimit të Ligjit pranë OSBE-së* dhe nuk janë azhuruar për shkak rritjes së vështirësive në mbledhjen e të dhënave nga gjyqtarët që shërbejnë në gjykatat paralele.

<sup>10</sup> Shih *Strukturat paralele në Kosovë, tetor 2003, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit, OSBE, faqet 19-20.*

## **1.2. Struktura e gjykatave ekzistuese paralele**

Sipas informatave të OSBE-së, gjykatat serbe për momentin përpiqen të mbulojnë kompetencat territoriale të secilës gjykatë komunale dhe të qarkut në Kosovë. Madje edhe pse shumica e këtyre gjykatave janë të vendosura në Serbi ekzistojnë disa degë të tyre në Kosovë. Megjithatë, OSBE-ja ka përjetuar vështirësi të dukshme në mbledhjen e informatave specifike përkitazi me gjykatat paralele për shkak të hezitimit të gjyqtarëve për të diskutuar këto çështje me stafin e OSBE-së.

### 1.2.1 Rajoni i Mitrovicës

Pavarësisht nga prania e gjykatave në rajonin e Mitrovicës, OSBE-ja mund të konfirmojë ekzistencën e Gjykatës paralele të Qarkut të Mitrovicës (“Gjykata e Qarkut e Mitrovicës së Kosovës”) në Komunën e Zvečan/Zveçanit, dhe gjykatat paralele komunale të Leposavić/Leposaviqit dhe të Mitrovicës që gjenden në komunat gjegjëse. Ndërsa, nuk ka informata shtesë sa i përket gjykatave paralele të Leposavić/ Leposaviqit , gjykata paralele komunale e Mitrovicës gjithashtu merret me lëndët nga komunat Vushtrri/Vučitrn dhe Skenderaj/Srbica dhe po ashtu ka një zyrë që funksionon në Zubin Potok. Sipas hulumtimit të OSBE-së, gjykatat paralele në Mitrovicë merren vetëm me lëndët civile dhe çështjet administrative. Megjithatë, OSBE-ja mund të konfirmojë ekzistimin e një dege të Gjykatës paralele të Qarkut të Mitrovicës në Kralevë (Serbi), e cila, mes tjerash, merret me procedimet penale.

Megjithëse OSBE-ja nuk ka mund të marrë informata të azhurnuara që nga vlerësimi i fundit i OSBE-së përkitazi me numrin e gjykatësve dhe lëndëve në gjykatat paralele,<sup>11</sup> këto gjykata ende janë të lidhura me Ministrinë e Drejtësisë së Serbisë (MDS) në Beograd. Pjesëtarët e të gjitha komuniteteve që jetojnë në rajonin e Mitrovicës i përdorin gjykatat paralele, sidomos ata që kanë nevojë që aktvendimet gjyqësore t’u njihen në Serbi në çështjet civile siç janë e drejta trashëgimore dhe e drejta familjare. Gjykatat paralele herë pas here i kanë udhëzuar palët që t’u drejtohen gjykatave të UNMIK-ut për lëndët trashëgimore dhe pronësore (për shembull, kur patundshmëria gjendej në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica, me qëllim që t’u jepet efikasitet aktvendimeve gjyqësore para autoriteteve të Kosovës).

### 1.2.2 Prishtinë/Priština

OSBE-ja është në dijeni të ekzistimit të gjykatave komunale paralele dhe atyre të qarkut të Prishtinës/Priština dhe të zyrave të prokurorisë në Nish, Serbi. Zyra e ndërlidhjes (me tre të punësuar) të gjykatës në Nish është e vendosur në Gračanica/Graçanicë dhe kryesisht është e përfshirë në çështjet administrative të gjykatës (p.sh. verifikimi i autencitetit të dokumenteve, verifikimi i nënshkrimeve të kontratave). Ajo përdor vulat e Republikës së Serbisë në kryerjen e detyrave të veta dhe sipas rastit në zyrë punon një gjykatës nga gjykata e Nishit.

---

<sup>11</sup> *Shih Strukturat paralele në Kosovë, tetor 2003, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit, OSBE, faqe 21.*

OSBE-ja ka konstatuar se shërbimet e zyrës së vendosur në Gračanica/Graçanicë shfrytëzohen nga të gjitha komunitetet në Kosovë, të cilët kanë nevojë që dokumentet t'u njihet si valide në Serbi. Megjithatë, duket se kjo zyra në mënyrë tipike përmbahet nga procesimi i dokumenteve dhe i kërkesave që kanë të bëjnë me bartjen e pronave të patundshme kur dy palët u përkasin komuniteteve të ndryshme që banojnë në Kosovë, ose kur patundshmëria gjendet në Kosovë. Kjo bëhet për t'i shmangur konfliktet me gjykatat e UNMIK-ut.

Gjykata Komerciale paralele e Prishtinës/Priština gjendet në Kralevë, Serbi, ndërkaq Gjykata Komunale paralele e Lipjanit/Lipljan gjendet në Prokupje, Serbi. Prokupja ka dy gjykatës që trajtojnë lëndët penale dhe gjykatës të tjerë në çështjet civile. Një degë e Gjykatës Komunale paralele të Lipjanit/Lipljan aktualisht është e vendosur në fshatin Lepi (Komuna e Lipjanit/Lipljan), ndërkaq vetëm një gjykatës merret me çështjet civile dhe është i vendosur atje në baza të rregullta.

Gjykata në Lepi në mënyrë tipike merret me lëndët nga e drejta trashëgimore dhe ajo familjare, por gjykata në Prokupje shqyrton llojloj lëndësh nga pjesëtarë të të gjitha komuniteteve në Kosovë, të cilët kanë nevojë që aktvendimet gjyqësore t'u njihen si valide në Serbi.

Sipas gjetjeve të OSBE-së, gjykata në Lepina/Lepi shqyrton rreth një qind lëndë në vit. Për lëndët e ndërlikuara ku kërkohet prania e gjyqtarëve porotë, palët normalisht i dorëzojnë kërkesat e tyre drejtpërdrejt në Prokupje, ku paneli i plotë i gjykatës mund të shqyrtojë rastin.

Në fund, disa gjykatës të vendosur në Prokupje ndihmojnë gjykatat e tjera paralele të Nishit dhe të Krushevcit në Serbi kur ka nevojë.

### 1.2.3. Rajoni i Gjilanit/Gnjilane

OSBE-ja është në dijeni të pranisë së gjykatave paralele të Gjilanit/Gnjilane në Vranjë, Serbi, Gjykata Komunale paralele e Ferizajit/Uroševac në Leskovc, Serbi, dhe Gjykata Komunale paralele e Kamenicës/Kamenica në Jagodinë, Serbi. Autoritetet serbe i kanë themeluar këto tri gjykata paralele menjëherë pas konfliktit në Kosovë.

Dega e gjykatës paralele e Leskovcit, Serbi, është e vendosur në Štrpce/Shtërpçë, Kosovë, rreth 400 metra nga ndërtesa e komunës, me një gjykatës dhe shtatë të punësuar të tjerë (duke përfshirë personelin administrativ dhe një roje sigurimi) e vendosur atje në baza të rregullta dhe e paguar nga MDS-ja.

Gjykata paralele e Leskovcit, Serbi, shqyrton lëndët civile, ndërkaq lëndët penale ndahen ndërmjet saj dhe Gjykatës së Qarkut të Prishtinës/Prištinas në Nish, Serbi, në çështjen e juridiksionit sipas ligjit serb. Megjithatë, roli kryesor i degës së gjykatës në Štrpce/Shtërpçës duket të jetë administrativ, siç është lëshimi i certifikatave të ndryshme (p.sh. se një person asnjëherë nuk është ndjekur penalisht nga autoritetet serbe), verifikimi i autencitetit të dokumenteve dhe çështje që lidhen me autorizimet e ngasjes.

#### 1.2.4 Rajoni i Pejës dhe i Prizrenit

Sipas informatave të grumbulluara nga OSBE-ja, gjykatat paralele të rajonit të Prizrenit janë të vendosura në Pozharevc, Serbi, ndërkaq gjykatat paralele përgjegjëse për rajonin e Pejës janë të vendosura në Leskovc, Serbi.

### **1.3. Aktivitetet e gjykatave paralele dhe reagimet**

Gjykatat paralele si në Kosovë, ashtu edhe jashtë saj vazhdojnë të paraqesin problem që lidhet me administrimin e duhur të drejtësisë dhe vendosjen e sundimit të ligjit në Kosovë.<sup>12</sup> Derisa efekti i përgjithshëm negativ i sistemit paralel të gjykatave në sundimin e ligjit në Kosovë mund të jetë zvogëluar në sektorë të caktuar, gjykatat paralele ose zyrat e ndërlidhjes që i përfaqësojnë këto gjykata vazhdojnë të veprojnë në disa enklava dhe komuna në tërë Kosovën. UNMIK-u vazhdon të mos jetë në gjendje ose i gatshëm të ndërprejë punën e gjykatave paralele.

Me sa ka kuptuar OSBE-ja, në vitin 1999, Qeveria e Serbisë – dhe Republika Federative e Jugosllavisë – kishin një politikë që të mbaheshin ato struktura në Kosovën veriore. UNMIK-u ka qenë përgjegjës për ndërtimin e sistemit gjyqësor në tërë Kosovën, por për arsye të ndryshme nuk ka qenë në gjendje të themelojë gjykata në komunat Zvečan/Zveçan dhe Leposavić/Leposaviq. Ndërmjet viteve 1999 dhe 2002, gjykatat paralele komunale e kanë plotësuar zbrastësinë në strukturën gjyqësore të UNMIK-ut, sidomos në këto komuna veriore. Që nga muaji maj i vitit 2002, kanë qenë 34 gjykatës që kanë punuar në gjykatat paralele të Kosovës veriore dhe një numër i pacaktuar i personelit gjyqësor që ka punuar në komuna të ndryshme në pjesët e tjera të mbetura të Kosovës.<sup>13</sup>

Në të kaluarën UNMIK-u ka kërkuar t'i bind gjykatësit serb që të mbeten në postet e tyre pas bartjes së kompetencave në UNMIK dhe po ashtu është përpjekur të bind personelin tjetër gjyqësor që të largohet nga gjykatat paralele. Gjatë vjeshtës së vitit 2000, përfaqësuesit e KB-ve, përfshirë këtu Hans Corell-in, Nën-Sekretar i Përgjithshëm për Çështje Ligjore dhe Këshilltar Ligjor i Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, ishin të përfshirë në negociatën me këta gjykatës.<sup>14</sup> Mirëpo, këto përpjekje u dëshmuan të pasuksesshme dhe gjykatësit serb kanë qenë ngurrues që t'i bashkohen sistemit të UNMIK-ut.

Pas negociatave të mëvonshme, më 9 korrik 2002, palët, UNMIK-u dhe RFJ-ja nënshkruan “Deklaratën e Përbashkët mbi Rekrutimin e Gjykatësve dhe të Prokurorëve të etnisë serbe në sistemin shumetnik të drejtësisë në Kosovë,” nën të cilin UNMIK-u kërkonte që të zvogëlonte joshjen e sistemit të gjykatave paralele

---

<sup>12</sup> *Shih Strukturat paralele në Kosovë, tetor 2003, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit, OSBE, shih gjithashtu Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë, Raporti i Katërt Vjetor, 12 korrik 2004, faqe 12; po ashtu shih, nga i njëjti Institucion, Raporti i Pestë Vjetor, 11 korrik 2005, faqe 20 dhe Raporti i Gjashtë Vjetor, 11 korrik 2006, faqe 13 dhe 21, që janë në dispozicion në <http://www.ombudspersonkosovo.org> në linkun Raportet Vjetore, i shikuar më 19 shtator 2006.*

<sup>13</sup> *Shih Strukturat paralele në Kosovë, tetor 2003, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit, OSBE, faqe 17.*

<sup>14</sup> *Shih Strukturat paralele në Kosovë, tetor 2003, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit, OSBE, faqet 1-2.*

duke premtuar vëmendje më të madhe ndaj integritit gjyqësor.<sup>15</sup> Sipas Deklaratës së Përbashkët, në Kosovë në muajin janar 2003, në komunat me shumicë dërmuese serbe të Zubin Potokut dhe të Leposavić/Leposaviqit u themeluan gjykatat komunale dhe ato për kundërvajtje.<sup>16</sup> Për më tepër, ishte arritur hyrja e gjykatësve serb të Kosovës në gjykatat e UNMIK-ut në Mitrovicë/Mitrovica, me pritjen që gjykata më përfshirëse e UNMIK-ut do të dobësonte ndikimin e strukturave paralele.<sup>17</sup> Megjithëse këto gjykata tani janë aktive, ato nuk ishin plotësisht operative që nga muaji tetor 2003 dhe ato mbeten me personel të mangët edhe sot.<sup>18</sup>

Duhet të vihet në dukje se UNMIK-u, dhe tani Departamenti për të Drejtat Civile në MD, po kërkojnë që aktivisht të përmirësojnë drejtësinë për serbët e Kosovës të cilët jetojnë atje në afërsi të një gjykate të UNMIK-ut. Për shembull, më 10 dhjetor 2004, UNMIK-ku ka hapur degën e Gjykatës Komunale të Prishtinës/Priştinas në Gračanica/Graçanicë, një enklavë e madhe serbe në juglindje të Prishtinës/Priştinas. Ndër të tjera, UNMIK-u dhe MD-ja mbajnë rrjetin e zyrave ndërlidhëse të gjykatave në zonat me shumicë dërmuese me popullatë serbe, të cilat ndihmojnë në paraqitjen e dokumenteve të gjykatave në emër të serbëve të Kosovës dhe të organizojnë transportin e sigurtë për ta për në gjykatat e UNMIK-ut dhe anasjelltas. Përpjekjet e tilla, megjithëse të dobishme prapëseprapë nuk e zgjidhin problemin që është në thelb të kësaj - mosnjohja reciproke e UNMIK-ut dhe e gjykatave paralele serbe.

#### 1.4. Brengat aktuale dhe analizat

Struktura e gjykatave paralele, si brenda, ashtu edhe jashtë Kosovës, paraqet disa probleme që ndërlidhen me administrimin e drejtësisë, me sa duket validitetin dhe njohjen e aktvendimeve gjyqësore, hutinë dhe shpenzimet shtesë që janë si pasojë e ndeshjes së juridiksioneve dhe problemin e gjykimit të dyfishtë në lëndët penale. Tashmë UNMIK-u është orvatur që t'i trajtojë këto probleme në mënyra të ndryshme, por çështjet ende mbeten njësoj.

Në të vërtetë, mosnjohja në përgjithësi e aktvendimeve të gjykatave paralele mund të shpie në probleme të konsiderueshme. Gjykatat paralele kanë lëshuar vendime të rëndësishme dhe praktike që kanë të bëjnë me pagesën e mbajtjes, të huave, bartjen e pronës, martesat dhe shkurorëzimet. Shpesh, serbët e Kosovës janë mbështetur në

---

<sup>15</sup> OSBE/UNHCR, *Vlerësimi i Dhjetë i Situatës së Minoriteteve Etnike në Kosovë (Që ka përfshirë periudhën Maj 2002 deri Dhjetor 2002)*, Mars 2003, faqe 33, që është në dispozicion në: [http://www.osce.org/documents/mik/2003/03/903\\_en.pdf](http://www.osce.org/documents/mik/2003/03/903_en.pdf). Shikuar më 1 shtator 2006.

<sup>16</sup> *Shih Vlerësimin e Dhjetë të Gjendjes së Pakicave Etnike në Kosovë të OSBE/UNHCR (periudha që mbulon maj 2002 deri në dhjetor 2002)*, mars 2003, faqe 33.

<sup>17</sup> *Shih Vlerësimin e Dhjetë të Gjendjes së Pakicave Etnike në Kosovë të OSBE/UNHCR (periudha që mbulon maj 2002 deri në dhjetor 2002)*, mars 2003, faqe 33. Kjo të paktën pjesërisht ka qenë e suksesshme. Që nga Qershori i vitit 2006, 13 gjykatës serb të Kosovës janë duke punuar në gjykatat e UNMIK-ut. Historikisht, gjykatësit dhe prokurorët serb kanë qënë ngurrues sa i përket aplikimit për postet në UNMIK nga frika se do të humbnin përfitimet sociale dhe për shkak se autoritetet serbe ofrojnë paga dhe beneficione më të mira.

<sup>18</sup> Në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës janë vetëm dy gjykatës serb dhe asnjë gjykatës serb i Kosovës në gjykatën komunale. Ndërkaq, Gjykata Komunale e Zubin Potokut e ka vetëm një gjykatës që merret me lëndët civile dhe penale.

gjykatat paralele, qoftë për shkak të volisë ose për shkak se ata me arsye kanë besuar se këto gjykata janë valide pasi Beogradi zyrtar i mbështeste ato.<sup>19</sup>

Edhe pse gjykatat paralele nuk do të duhet të kenë asnjë fuqi zbatimi në Kosovë, serbët e Kosovës, shqiptarët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera ende mbështetën në to, sidomos kur ata kanë nevojë që një aktvendim gjyqësor t'u njihet në Serbi. Kështu që, duke patur parasysh këtë realitet, dihet që palët në Kosovë aktualisht i sjellin lëndët njëkohësisht në gjykatat e UNMIK-ut dhe në gjykatat paralele. Si rrjedhojë, kjo nevojë për njohjen e aktvendimeve gjyqësore në Serbi dhe në Kosovë shpie në dyfishimin e resurseve dhe nganjëherë në rezultate ligjore të kundërta. Shpesh, gjykata e njërit sistem (qoftë e UNMIK-ut ose e atij serb) nuk janë në dijeni të lëndëve ose aktvendimeve gjyqësore që janë në vazhdim e sipër në sistemin tjetër.

#### 1.4.1 Rreziku nga aktvendimet gjyqësore të kundërta, hutia e publikut dhe shpenzime e dyfishta

Një llojllojshmëri problemesh lindin si rezultat i ndeshjes së juridiksioneve. Për shembull, aty ku ka patur dy vendime nga dy gjykata të ndryshme për një grumbull të njëjtë faktesh, ose kur kontesti i njëjtë është sjellur para gjykatave të dy sistemeve të ndryshme. Ndeshja e juridiksioneve është burim i hutisë si për serbët e Kosovës, ashtu edhe për shqiptarët e Kosovës dhe kjo shkakton paqartësi ligjore.

Një nga efektet fatkeqe të ndeshjes së juridiksioneve është se sidomos në lëndët civile, koha dhe paratë e shpenzuara për të çuar një çështje në gjykatë ose vërtetuar një çështje në njërin sistem duhet që të shpenzohen për herë të dytë që vetëm aktvendimi gjyqësor ose vërtetimi të validohet në kuadër të sistemit të dytë. Ndërkaq, ekziston rreziku që të dy gjykatat të nxjerrin përfundime ligjore të kundërta. OSBE-ja e ka monitoruar situatën në të cilën ka patur dëshmi për huti dhe shpenzime shtesë për palët.

Për shembull, në një lëndë të paraqitur në Gjykatën Komunale të Zubin Potokut, që më vonë u përcjell në Gjykatën Komunale të Mitrovicës/Mitrovica, një person ka dorëzuar një kërkesë kundër Shoqatës së Gjahtarëve për të sfiduar shkarkimin e tij siç thuhet të paligjshëm më 9 dhjetor 1999, dhe kërkohet që ai të rikthehet në vendin e tij të mëparshëm të punës. Padiësi nuk e dinte nëse padia duhet të paraqitet në gjykatën e UNMIK-ut apo në gjykatën paralele, dhe si rrjedhojë të dy paditë i ka paraqitur në të dy gjykatat. Padiësi u ankua për shkak të shpenzimeve të dyfishta, ndërkaq avokati i tij u ankua rreth ligjeve të ndryshme në fuqi në të dyja gjykatat dhe rreth problemit të rrezikut që të ketë dy aktvendime gjyqësore të ndryshme. Më 3 dhjetor 2001, gjykata paralele ka nxjerrë një vendim në favor të parashtruesit të kërkesës. Në ndërkohë, lënda ka qenë ende e pazgjidhur në Gjykatën Komunale të Mitrovicës/Mitrovica që nga muaji gusht 2006.

Në lëndën e dytë para Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, një grua ka paraqitur kërkesën për shkurorëzim dhe për kujdestari ndaj fëmijës. Mirëpo, gjykata paralele tashmë kishte lëshuar një vendim me të cilin fëmijën ia besonte babait. Pasi që nëna nuk ishte e kënaqur me vendimin e gjykatës paralele, ajo parashtrroi një kërkesë të re

---

<sup>19</sup> *Id.*, faqe 22.



në gjykatën e UNMIK-ut të bazuar në faktet e njëjta. Gjykata e UNMIK-ut ka marrë një vendim të kundërt, duke ia dhënë kujdestarinë nënës.

Në lëndën e tretë, gjykata paralele e Mitrovicës ka lëshuar një vendim për një lëndë shkurorëzimi dhe mjete të mbajtjes. Mirëpo, meqë vendimi i gjykatës paralele për mjete të mbajtjes nuk është i ekzekutueshëm në Kosovë, nëna e fëmijës ka paraqitur një kërkesë të re për mjete të mbajtjes në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës. Shuma e mjeteve të mbajtjes që duhet të paguhet nga ish-bashkëshorti i saj është e ndryshëm në secilin prej aktgjykimeve.

Në lëndën e katërt, më 22 nëntor 2000, dyja palët kanë marrë aktvendimin gjyqësor me të cilin u jepej shkurorëzimi nga gjykata paralele në Leposavić/Leposaviq. Mirëpo, në procedurën pasuese për ndarjen e pasurisë para Gjykatës Komonale të UNMIK-ut në Leposavić/Leposaviq, gjykata e UNMIK-ut nuk e kishte njohur aktvendimin gjyqësor për shkurorëzim të gjykatës paralele. Prandaj, palët kishin iniciuar një procedurë tjetër për shkurorëzim në Gjykatën e Qarkut të UNMIK-ut në Mitrovicë, dhe e kanë marrë vendimin e dytë për shkurorëzim më 27 maj 2004, gjatë procedurës që ishte në vazhdim e sipër për ndarjen e pasurisë.

Këto lëndë janë vetëm shembuj të problemeve me të cilat ballafaqohen njerëzit për shkak të mosnjohjes reciproke të aktvendimeve gjyqësore mes gjykatave të UNMIK-ut dhe gjykatave paralele. Kjo ka për pasojë pasigurinë ligjore dhe shpenzimet e dyfishta. Kjo krijon huti për njerëzit të cilët nuk e dinë se cilës gjykatë t'i drejtohen dhe dëshirojnë që vendimet e tyre t'u njihen si në Serbi, ashtu edhe në Kosovë.

#### 1.4.2 Rreziku nga gjykimi i dyfishtë

Ekzistimi i gjykatave paralele shtron problemin e gjykimit të dyfishtë. Sipas nenit 4 të Protokolit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ) dhe nenit 14(7) të Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KNDKP), gjykimi i dyfishtë është e ndaluar.<sup>20</sup> Në ligjin e kaluar të procedurës penale që është në fuqi në Serbi, dhe deri në prill të vitit 2004 edhe në Kosovë, thuhet se gjykata duhet të hedhë poshtë një lëndë “nëse i akuzuari tashmë ka qenë i dënuar në mënyrë valide për krimin e njëjtë ose të lirohet nga akuza...”<sup>21</sup> Në Kodin e tanishëm të Përkohshëm të Procedurës Penale që është në fuqi në Kosovë (KPPPK) në mënyrë të ngjashme afirmohet se “Askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale, nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës...”<sup>22</sup>

Gjykimi i dyfishtë në mënyrë tipike e ndalon ri-ndjekjen penale në një juridiksion kur i pandehuri ka qenë i dënuar ose i liruar nga akuza në po atë juridiksion të njëjtë. Kjo bëhet e paqartë kur një person dënohet në një gjykatë të strukturës paralele që shpall juridiksionin mbi atë territor të njëjtë. Mirëpo, me qëllim të zgjidhjes së kësaj dykuptimshmërie në favor të të pandehurit, përveç se kur aplikohen rrethanat e

<sup>20</sup> KEDNJ-ja, Protokolet e saj dhe KNDKP-ja janë drejtpërdrejt të aplikueshme në Kosovë, duke qenë se janë inkorporuar në ligj në nenin 3.2 të Kornizës Kushtetuese.

<sup>21</sup> Neni 349(5) i Kodit të Procedurës Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Nr. 4/77.

<sup>22</sup> Neni 4(1) i KPPPK-së. Shih edhe nenin 389(1) pika 3 e KPPPK-së.

jashtëzakonshme (d.m.th. kur zbulohen fakte të reja ose kur ka parregullsi procedurale thelbësore), gjykatat në përgjithësi duhet të ndjekin parimin e gjykimit të dyfishtë kur kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave paralele.

Për shembull, OSBE-ja është në dijeni për një lëndë që lidhet me një vrasje nga viti 1999 në të cilën hetimi ka çuar në një akt padi nga Prokuroria e Gjykatës së Qarkut të Gjilanit/Gnjilane.<sup>23</sup> Mirëpo, në ndërkohë i dyshuari është shpërngulur për në Serbi ku kundër tij është ngritur një akt padi për krimin e njëjtë nga Gjykata paralele e Qarkut të Vranjës, që vepronte në rolin e saj si Gjykatë e Qarkut e Gjilanit/Gnjilane.<sup>24</sup> Gjykimi për vrasjen u zhvillua në Vranjë më 20 gusht 2004, dhe gjykata e shpalli fajtor të pandehurin për vrasje dhe i shqiptoi dënimin me një vit burgim. Dënimi për vrasje duket i ulët. Lënda ende është e pazgjidhur në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit/Gnjilane, ku është paraqitur akt padia dhe ku kryeprokurori ka deklaruar qëllimin e tij për të kërkuar arrestimin e tij/saj sapo i pandehuri të kthehet në Kosovë.

Në lëndën tjetër, një person kishte kryer një vrasje në vitin 2001 në Mitrovicë dhe i ishte dorëzuar Gjykatës paralele të Qarkut të Krlevës, Serbi. Kryeprokurori i Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës kishte informata se i pandehuri ishte dënuar dhe se ai aktualisht po e vuante dënimin e shqiptuar në Serbi. Megjithatë, prokurori pohoi se pasi që gjykata paralele në Krlevë nuk njëhej, në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës kishte filluar një hetim lidhur me kryesin e supozuar të veprës, por për shkak të mungesës së të pandehurit, prokurori kishte vendosur të pezullonte hetimin derisa i dyshuari të kthehet në Kosovë.

Në lëndën e tretë, më 7 dhjetor 1999, një prokuror i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit/Gnjilane kishte ngritur një aktakuzë kundër një personi për tentim vrasje të kryer në Kosovë. Kryesi i supozuar kishte ikur në Serbi. Atje, Gjykata paralele e Qarkut të Vranjës, Serbi, e kishte ndjekur penalisht dhe e kishte dënuar me dy vjet e gjashtë muaj burgim për veprat e supozuara penale të kryera në Kosovë. Më 17 mars 2005, Gjykata Supreme e Serbisë ia kishte zvogëluar dënimin në një vit e gjashtë muaj burgim. Në të njëjtën kohë, Gjykata e Qarkut e Gjilanit/Gnjilane kishte zhvilluar procedimin penal kundër personit të njëjtë për akuza të njëjta. Mirëpo, gjykata e hodhi poshtë akuzën për arsye se i akuzuari tashmë kishte qenë i dënuar nga gjykata paralele.<sup>25</sup> Më 22 maj 2006, prokurori publik i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit/Gnjilane kishte ushtruar ankesë ndaj vendimit, duke pretenduar se ai vendim ishte marrë nga një gjykatë jokompetente, dhe që nga gushti i vitit 2006, lënda është ende e pazgjidhur në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Nga prokurorët në rajonin e Gjilanit/Gnjilane dhe atë të Mitrovicës janë shprehur shqetësime se me afrimin e Kosovës kah marrëveshja për statusin, Gjykatat paralele të Qarkut në Krlevë dhe Vranjë në Serbi do të bëhen më aktive në lëshimin e aktakuzave dhe në shqyrtimin e lëndëve të dala nga aktivitetet kriminale në Kosovë. Në lëndët e krimeve të rënda të supozuara siç janë vrasjet, vjedhjet e rënda, grabitjet

---

<sup>23</sup> Aktakuza është trajtuar drejtpërdrejt nga gjykata e qarkut dhe jo nga një gjykatë komunale, për shkak të natyrës serioze.

<sup>24</sup> Në kohën e aktakuzës në Gjilan/Gnjilane dhe pas aktakuzës në Vranjë, të dyja gjykatat do të duhej të kishin aplikuar Kodin e Procedurës Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

<sup>25</sup> Gjykata e ka bazuar vendimin e saj në nenin 389(1) pika 3 e KPPPK-së.

dhe falsifikimi, të pandehurit shpesh kanë ikur për në Serbi,<sup>26</sup> me siguri duke shpresuar për një dënim më të butë nëse do të ndiqeshin penalisht në Serbi.

Në përmbledhje, sa u përket gjykimeve të veprave penale, në përgjithësi personat e gjykuar nga një gjykatë e UNMIK-ut ose gjykatë paralele nuk duhet të ndiqen penalisht dhe/ose të gjykohen për grupin e njëjtë të fakteve nga gjykata që funksionon në sistemin tjetër. Mirëpo, në rrethana të jashtëzakonshme, siç janë provat e reja ose parregullsitë procedurale, duhet të lejohet ndekja penale e sërishme.

### 1.4.3 Njohja e vendimeve

Një çështje e madhe që ende duhet të trajtohet nga UNMIK-u dhe autoritetet lokale është statusi i lëndëve për të cilat është vendosur në gjykatat paralele, sidomos në çështjet gjyqësore civile. OSBE-ja tashmë e ka theksuar këtë në raportin e saj të mëparshëm.<sup>27</sup> Mund të jetë e dobishme që të bëhet një dallim ndërmjet periudhës deri në janar të vitit 2003, ku gjykatat paralele kanë që më aktive, ndërkaq që nga janari i vitit 2003, kur në Kosovën veriore janë themeluar zyrtarisht gjykatat e UNMIK-ut. Gjatë periudhës deri në janar të vitit 2003, UNMIK-ku kishte vetëm kontroll të kufizuar mbi komunat në Kosovën veriore, dhe megjithëse gjykatat e UNMIK-ut në Mitrovicë kanë patur juridiksion zyrtar mbi këto territore, disa lëndë janë trajtuar nga këto gjykata paralele.

Ekzistojnë dy zgjidhje të mundshme sa i përket periudhës së parë deri në janar të vitit 2003. Njëri opsion mund të jetë që UNMIK-u të vendos formalisht që vendimet e këtyre gjykatave paralele thjesht janë të pavlefshme nga pikëpamja ligjore. Ose ndryshe, mund të krijohen mekanizmat përkatës për të vlerësuar vlefshmërinë ligjore të vendimeve dhe të veprimeve të gjykatave paralele dhe të trajtohet bartja e lëndëve të pazgjidhura.

Mosnjohja e aktvendimeve gjyqësore dhe të veprimeve të gjykatave paralele mund të arsyetohet me bazën se strukturat paralele janë të paligjshme për shkak të Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Rregullores së UNMIK-ut nr. 1 1999/1 (mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë), dhe nenit 9(4) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese. Gjersa kjo do të mund të ishte zgjidhja më e lehtë, ajo mund të krijojë probleme sociale. Kjo po ashtu nuk do të përfillte faktin se gjykatat paralele kanë lëshuar aktgjykime dhe vendime që konsiderohen valide në kuadër të sistemit juridik serb. Jo vetëm kaq, disa do të mund të shfrytëzonin paqartësinë ligjore duke ndalur pagimin e mjeteve për mbajtje ose kredive, ose do të përpiqen të zaptojnë pronën e bartur. Përveç tjerash, një zgjidhje e tillë nuk do të përfillte faktin se serbët e Kosovës që jetojnë në Kosovën veriore janë mbështetur në gjykatat paralele, atëherë kur nuk kanë patur qasje në gjykatat e UNMIK-ut. Mirëpo, kjo arsyeja e fundit mund të mos vlejë pas janarit të vitit 2003, kur në tërë Kosovën qe themeluar sistemi i gjykatave të UNMIK-ut.

---

<sup>26</sup> Këta shembuj janë marrë nga lista që i është dhënë OSBE-së nga Gjykata e Qarkut e Gjilanit/Gnjilane. Sipas gjykatës, të gjithë personat e përmendur në aktakuza kanë ikur për në Serbi.

<sup>27</sup> *Shih Strukturat Paralele në Kosovë, tetor 2003, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit pranë OSBE-së, faqet 22-23.*

## 2. STRUKTURAT PARALELE – SIGURIA

### 2.1. Hyrje – historiku

Në këtë kapitull do të jepen informatat më të reja përkitazi me situatën aktuale që ka të bëjë me strukturat paralele të sigurisë deri në shtator të vitit 2006, kryesisht në veri, por edhe si vështrim në zhvillimet e sigurisë gjatë këtyre muajve të fundit. Është me rëndësi të vihet në dukje se situata e sigurisë në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica është dinamike, shumë komplekse dhe mund të ndryshojë brenda orësh.

Pas konfliktit të vitit 1999, disa serbë të Kosovës në Mitrovicë/Mitrovica, në veri të lumit Ibër u tubuan për të parandaluar kalimin e lumit nga shqiptarët e Kosovës nga ana jugore. Në fillim njerëzit u tubuan spontanisht rreth urës, pa udhëheqje ose strukturë. Gradualisht, ata u bënë më të organizuar. Rojat e Urës, siç u bë i njohur ky grup, e konsideronte veten strukturë të sigurisë me tri funksione kryesore: të parandalojë hyrjen e shqiptarëve të Kosovës në Mitrovicën veriore; të grumbullojë informata mbi Forcën e Kosovës (KFOR) dhe Policinë Civile (CIVPOL); dhe të grumbullojë informata për çdo shqiptar të Kosovës që jetonte në veri. Kah fundi i vitit 1999, Rojat e Urës ishin një organizatë e strukturuar, që aktivitetet e veta i koordinonte me ndihmën e radiove dhe formave të tjera të telekomunikimit.

Këto aktivitete u shndërruan në punë të rregullt të Rojave të Urës, duke përfshirë këtu pagat dhe ndërrimet e caktuara. Pagat mblidheshin nga donacionet vullnetare të banorëve të Mitrovicës veriore, si dhe nga spitali i Mitrovicës së veriut, i financuar nga Ministria Serbe e Shëndetësisë (MSSH). Me kalimin e kohës, disa Roja të Urës u përfshin edhe në aktivitete kriminale, përjetuan përleshje të brendshme serioze dhe filluan të humbin në një masë përkrahjen nga Beogradi dhe nga popullata vendore.<sup>28</sup> Si rezultat, kjo pati ndikim në numrin dhe fushëveprimin e aktiviteteve të tyre.

Aktualisht, ende ekziston një bërthamë aktive me një numër të papërcaktuar të Rojave të Urës, si dhe një grup më i madh i vlerësuar i cili mund të thirret sa herë që paraqitet nevoja. Rojat e Urës vazhdojnë ta monitorojnë urën dhe luajnë një rol jetik në mbajtjen e baraspeshës së pushtetit në Kosovën veriore.<sup>29</sup>

Përveç Rojave të Urës, ekziston një prani e vazhdueshme e oficerëve të MPB-së në veri, përfshirë këtu si ish-oficerët e policisë në Mitrovicë para konfliktit ashtu dhe ata që janë dërguar nga Serbia për të grumbulluar informata dhe për të kryer shërbime të caktuara administrative, siç është lëshimi i patentë shoferëve. Angazhimi i tyre në aktivitete policore ka shënuar rënie të konsiderueshme që nga viti 1999. Oficerët e MPB-së nga Mitrovica kanë mbajtur një prani të pandryshueshme në këtë rajon, ndërsa oficerët nga Serbia me kalimin e kohës janë ndërruar me rotacion.

---

<sup>28</sup> Shih, *faqen 12 të Raportit Strukturat Paralele në Kosovë të Departamentit të të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit të OSBE-së, tetor 2003.*

<sup>29</sup> Shih, *Raportin Bazë, Strukturat Paralele të Sigurisë në Veri të Mitrovicës të Departamentit të të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit të OSBE-së, 21 maj 2002.*

## 2.2. Zhvillimet dhe situata aktuale

OSBE-ja ka trajnuar policë serbë të Kosovës në SHSHPK në Vushtrri/Vučitrn dhe i ka dislokuar ata në mbarë Kosovën që nga viti 2000. Dokumenti i Përbashkët ndërmjet UNMIK-ut dhe ish-Republikës së Jugosllavisë (RFJ) qartë parashihte që oficerët e SHPK-së që janë serb të Kosovës kryesisht do të punojnë në zonat e banuara me shumicë nga serbët e Kosovës, si dhe në komunitetet e përziera.<sup>30</sup> Duket se udhëheqja e serbëve të Kosovës do të përkrahte trajnimin dhe dislokimin e oficerëve serbë të Kosovës të SHPK-së, me kusht që ata të jenë të dislokuar vetëm në zonat e banuara me serbë të Kosovës dhe se asnjë oficer shqiptar i Kosovës të mos dislokohej në zonat e banuara me serbë të Kosovës.<sup>31</sup>

Po ashtu nga Komisioneri i Policisë dhe PSSP-ja të asaj kohe, që të angazhohen në rekrutimin e pikësnyuar të ish-oficerëve të MPB-së, ashtu që ata të mund të dislokohejshin në Kosovën veriore. Rekrutimi i këtyre oficerëve gjatë këtyre pesë viteve të fundit ka qenë shumë efikas duke patur parasysh se në vitin 2002, prania e policëve serb të Kosovës pjesëtarë të SHPK-së mund të ishte e paparamendueshme.<sup>32</sup> Aktualisht, të gjitha (4) stacionet policore në Kosovën veriore janë nën komandën e pjesëtarëve serbë të SHPK-së, dhe prania e oficerëve serb pjesëtarë të SHPK-së tash duket normale. Njëri nga zëvendëskomandantët rajonal të SHPK-së është një nënkolonel serb i Kosovës. Përkundër këtij suksesi të madh për SHPK-në, situata e sigurisë ende mbetet larg prej normales.

Nga fundi i vitit 2004 deri në fillim të pranverës së vitit 2006, situata e sigurisë në veri ka vazhduar të normalizohet. Ish-oficerët e MPB-së, që shërbejnë tani si oficerë të SHPK-së, po punonin mirë në stacionet e policisë dhe nën zinxhirin komandues të SHPK-së dhe ka patur pak oficerë të MPB-së që janë dërguar nga Serbia. Megjithatë Rojat e Urës ende kanë qenë të pranishëm, prania e tyre ishte e profilit të ulët.

Tani, të gjitha stacionet e policisë në rajonin e Mitrovicës kanë kaluar transicionin nga komanda e Policisë së UNMIK-ut në atë të SHPK-së, me përjashtim të shtabit rajonal të policisë (SHRP), i cili mbetet i vetmi SHR në Kosovë nën komandën e Policisë së UNMIK-ut.<sup>33</sup>

<sup>30</sup> Dokumenti i Përbashkët UNMIK-RFJ, 5 nëntor 2001, faqe 5.

<sup>31</sup> Pretendimi për një marrëveshje gojore me ish-Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) Steiner, është përmendur dhe i është referuar disa herë në të kaluarën nga udhëheqja e serbëve të Kosovës afër të incidenteve të sigurisë dhe kur policët shqiptarë të Kosovës ishin të përfshirë në pikëpamje operative. Për shembull, arrestimi në qendër të Mitrovicës veriore i një të dyshuari më 10 nëntor 2005 dhe demonstratat që pasuan pas këtij aksioni të policisë; një incident në Portën 31, kur një qytetar serb i Kosovës e kishte sulmuar KFOR-in/CIVPOL-in më 7 korrik 2006; një incident në Portën 1, në të cilin ishte përfshirë Nënkryetari i Komunës së Leposavić/Leposaviqit më 15 korrik 2006; dhe dislokimi i policëve shqiptarë të Kosovës të Policisë Kufitare të SHPK-së në Portat 1 dhe 31. Megjithatë, gjatë formimit të nën-stacioneve më të mëdha policore në zonat e banuara nga serbët e Kosovës, udhëheqësit lokal të komunitetit vazhdimisht kanë pranuar dislokimin e disa policëve shqiptar dhe të komuniteteve jo-serbe, me kusht që shumica e policëve të dislokuar të jenë serb të Kosovës.

<sup>32</sup> Shih, faqen 6 të Raportit Bazë, *Strukturat Paralele të Sigurisë në Veri të Mitrovicës të Departamentit të Drejtave të Njeriut dhe të Sundimit të Ligjit të OSBE-së*, 21 maj 2002.

<sup>33</sup> Stacioni i policisë në Leposavić/Leposaviq ka patur transicion në dhjetor 2003; Stacioni i policisë në Vushtrri/Vučitrn më 24 shkurt 2004; Stacioni i policisë në Zvečan/Zveçan 2 dhjetor 2004; Stacioni i policisë në Skenderaj/Srbica më 31 mars 2005; Stacioni i policisë në Mitrovicën jugore më 29 prill 2005; Stacioni i policisë në Zubin Potok më 7 gusht 2005; Stacioni i policisë në Mitrovicën veriore ka patur transicion më 25 gusht 2005.

Aktualisht, janë rreth 50 ish-zyrtarë të MPB-së që janë dislokuar në kuadër të SHPK-së në rajonin e Mitrovicës. Krahas kësaj ekziston një numër i papërcaktuar i zyrtarëve aktiv të MPB-së në Kosovë, gjysma e tyre supozohet të jenë në rajonin e Mitrovicës.

Në Mitrovicën veriore, ekziston një stacion i MPB-së prapa kafenesë Zonja e Zezë, e cili ende funksionon.<sup>34</sup> Ekziston po ashtu një nënstacion në Lagjen e Boshnjakëve. Këto stacione kryesisht merren me çështje administrative.<sup>35</sup> Përveç stacionit në Kosovën veriore, stacione të MPB-së ka edhe në Shtërpcë/Štrpce përballë ndërtesës së komunës dhe një tjetër në Ranilug/Ranillug (Komuna e Kamenicës/Kamenica).

Serbët e Kosovës në veri të Kosovës besojnë se Rojat e Urës dhe MPB-ja mund të ofrojnë një shkallë të sigurisë të cilën SHPK-ja, CIVPOL-i dhe KFOR-i nuk mund ta ofrojnë. Incidentet e sigurisë ndodhin herë pas here dhe në njëfarë mase instrumentalizohen në media nga liderët serbë të Kosovës (dhe autoritetet në Beograd) duke përforcuar perceptimin në mesin e disa serbëve të Kosovës se ata jetojnë në situatë të paqëndrueshme të sigurisë. Disa shembuj të këtyre incidenteve mund të jenë:

- Më 28 mars 2006, në Mitrovicën veriore, një mashkull i ri serb i Kosovës është therur në urën kryesore mbi lumin Ibër para kafenesë Dolce Vita;
- Autobusët që qarkullonin ndërmjet Kosovës veriore dhe zonave të banuara me serb të Kosovës në Kosovën perëndimore janë gjuajtur me gurë në Komunën e Skënderajt/Srbica më 9 maj 12 maj dhe 8 qershor 2006;
- Më 16 maj 2006, një granatë ishte lansuar në një dyqan në Komunën e Leposavić/Leposaviqit;
- Me 1 qershor 2006, një mashkull i ri serb i Kosovës ishte vrarë në Komunën e Zvečan/Zveçanit;
- Më 15 korrik 2006, një konflikt verbal dhe fizik ka ndodhur në Portën 1 në mes të Zëvendëskryetarit të Kuvendit Komunal (ZKKK) të Leposavić/Leposaviqit dhe oficerëve të Policisë Kufitare të SHPK-së;
- Më 26 gusht 2006, një granatë dore është hedhur në kafenenë Dolce Vita, duke lënduar nëntë njerëz. Komunikacioni në urën kryesore ka qenë i kufizuar që nga ndodhja e sulmit. Tani ka një prani të përforcuar të Rojave të Urës në afërsi të kafenesë. Më 27 gusht 2006, Këshilli Nacional Serb (KNS) ka mbajtur një konferencë për shtyp, ku mes çështjeve të tjera ka paralajmëruar se nëse forcat e tanishme të sigurisë nuk janë në gjendje të ruajnë sigurinë, udhëheqja e serbëve të Kosovës do të ofrojë praninë e vet të sigurisë. Komandanti Rajonal i Policisë së UNMIK-ut ka deklaruar se nëse kjo është paramenduar që të jetë vetëm një “ruajtje e lagjes”, atëherë ai nuk do ta kundërshtonte këtë gjë;
- Më 30 gusht 2006, një autobus që vinte nga Mali i Zi, e që bartte nxënës serb të Kosovës siç pretendohet ishte goditur me gurë në një fshat jashtë qytetit të Mitrovicës; dhe
- Më 25 shtator 2006, kishte shpërthyer një përleshje mes serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës në Lagjen e Boshnjakëve, e cila pastaj u pasua me

<sup>34</sup> Shih faqen 26 të Raportit mbi Evropën Nr. 165 të Grupit Ndërkombëtar të Krizave, *Ndërtimi i Urave në Mitrovicën e Ndarë të Kosovës*, 13 shtator 2005.

<sup>35</sup> Stacioni në Lagjen e Boshnjakëve kryesisht u lëshon pasaporta të Serbisë shqiptarëve të Kosovës.

demonstrata në veri dhe me ngritje tensioni në të dyja anët. Ura u mbyll edhe një herë vetëm disa orë pasi që ri-hapur për komunikacion<sup>36</sup>.

Më 2 qershor 2006, Kryetari i Kuvendit Komunal (KKK) të Zvečan/Zveçanit raportohet të ketë deklaruar se për shkak të përkeqësimit të situatës së sigurisë në Kosovë, 385 anëtarë të personelit civil administrativ nga Ushtria Jugosllave (UJ) do të dislokohen në Kosovën veriore. KKK-ja më vonë mohoi të ketë bërë ndonjëherë një deklaratë të tillë.

Pavarësisht nga aktivitetet hetimore pozitive nga agjencitë e zbatimit të ligjit, perceptimet e komunitetit vendor mbeten thellë të ngulitura dhe vështirë mund të ndryshohen. Është me rëndësi të vihet në dukje se faktet që lidhen me incidentet shpesh kanë shumë pak rëndësi, pasi që incidentet në mënyrë të përsëritur po shfrytëzohen për përfitime politike. Udhëheqja politike vendore po e shfrytëzon perceptimin e pasigurisë për të dëshmuar qëndrimin e saj se nevojitet një prani shtesë serbe e sigurisë, duke deklaruar se prania ndërkombëtare e sigurisë dhe SHPK-ja nuk janë në gjendje ose të gatshme për t'i mbrojtur individët.

---

<sup>36</sup> Duhet të ceket se nga shtatori 2006 deri në janar 2007, OSBE-ja ka vërejtur një rënie graduale të incidenteve të sigurisë në Mitrovicën veriore.

### **3. STRUKTURAT ADMINISTRATIVE PARALELE ME KOMPETENCA QË KANË TË BËJNË ME PRONËN**

#### **3.1 – Informata themelore**

Komunat në Kosovë kanë kompetenca që lidhen me shfrytëzimin e tokës, planifikim hapësitor, ndërtim dhe strehim social nën mbikëqyrjen e ministrive përkatëse dhe brenda kufizimeve të kompetencave të rezervuara të PSSP-së.<sup>37</sup> Përveç tjerash, komunat i hartojnë dhe i zbatojnë planet komunale dhe planet e hapësirave urbane, lëshojnë leje ndërtimi dhe për shfrytëzim të tokës dhe menaxhojnë strehimin social. Për më tepër, zyrat kadastrale të komunës, të mbikëqyrura nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), e mirëmbajnë dhe e azhurnojnë Regjistrin e të Drejtave mbi Pronat e Paluajtshme të Kosovës.

Në tetor të vitit 2003, OSBE-ja kishte identifikuar brenda Kosovës një numër të strukturave administrative kompetente për çështjet pronësore që ende po funksiononin nën kornizën dhe autoritetin e Beogradit, pavarësisht kornizës ligjore dhe institucionale të themeluar në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.<sup>38</sup> Siç u demonstrua në vlerësimin e mëparshëm, strukturat administrative paralele vazhdojnë t'i referohen ligjit që nuk është në fuqi dhe t'u ofrojnë informata të pasakta qytetarëve lidhur me mjetet juridike në dispozicion. Këto praktika ende vazhdojnë të krijojnë një klimë të paqartë ligjore, e cila mund të ketë për pasojë keqpërdorimin e pushtetit në nivel komunal, mund të ndikojë negativisht në mbrojtjen gjyqësore dhe administrative të së drejtës në pronë (Neni 1, Protokoli 1, KEDNJ), si dhe të drejtën për mjet juridik efikas (Neni 13, KEDNJ).

Në gusht 2006, OSBE-ja e ka rivlerësuar situatën në këto komuna. Në përgjithësi, situata nuk ka ndryshuar në mënyrë substanciale në tri vitet e fundit. Ky vlerësim jo vetëm që demonstron ekzistencën e vazhdueshme të strukturave paralele në komunat veriore të Kosovës (Leposavić/Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan/Zveçan) ku popullatë shumicë janë serbët e Kosovës, por po ashtu identifikon se si ngriten shqetësimet për të drejtat e njeriut nga fakti se strukturat administrative paralele po shkelen ligjin e aplikueshëm.<sup>39</sup> OSBE-ja mëtej është e brengosur se kjo lënie anash e sundimit të ligjit ka krijuar një ambient institucional që mund të ketë për pasojë keqpërdorimin e pushtetit.<sup>40</sup>

---

<sup>37</sup> Për shembull, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, neni 3.1 (h) "Çdo komunë përgjigjet për menaxhimin e pronës komunale". Shih po ashtu, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/22 mbi Shpalljen e Ligjit të Kuvendit të Kosovës mbi Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme; Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/37 mbi Shpalljen e Ligjit mbi Ndërtimin të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/30 mbi Shpalljen e Ligjit mbi Planifikimin Hapësitor të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

<sup>38</sup> OSBE, *Strukturat Paralele në Kosovë*, Tetor 2003.

<sup>39</sup> Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/45, neni 33 "Të gjitha veprimet administrative duhet t'u përmbahen ligjeve në fuqi." Ligji i aplikueshëm është i përcaktuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/59.

<sup>40</sup> OSBE, *Strukturat Paralele në Kosovë*, tetor 2003, Kapitulli 3 "Strukturat Administrative Paralele – Çështjet Pronësore".



Siç është shpjeguar në vlerësimin e mëparshëm, ekzistimi i këtyre strukturave paralele nuk është për shkak të krijimit të organeve të reja, por më shumë është vazhdimësi e administratave komunale të para vitit 1999 të Republikës së Serbisë. Aktualisht, ato paraqesin të vetmet organe ekzistuese të qeverisjes vendore në Kosovën veriore.

Aktet administrative që përdoren si bazë për vendimet e këtyre organeve komunale, siç janë drejtoritë e urbanizmit, në përgjithësi bazohen në kornizën ligjore të Republikës së Serbisë dhe nuk i njohin dhe pranojnë ligjet e Kuvendit të Kosovës që kanë të bëjnë me kompetencat komunale, siç janë ndërtimi, planifikimi hapësinor dhe regjistrimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme.<sup>41</sup> Nuk ka struktura administrative paralele që funksionojnë në komunat e tjera të mbetura të Kosovës ku popullatë shumicë janë shqiptarët e Kosovës.

Problemet e përshkruara në këtë kaptinë rrjedhin nga jovlefshmëria e dokumenteve të lëshuara nga strukturat administrative paralele në gjykatat e Kosovës dhe organet tjera publike si dhe mosaplikimi i kompenzimeve kundruall vendimeve të tyre administrative. Për shembull mosimplementimi i ligjeve të Kosovës për rregjistrimin e të drejtave të pasurisë së patundshme ndikon në ofrimin e shërbimeve siç janë rregjistrimi i trashëgimisë, testamenteve, shitjeve dhe transfereve tjera të pasurisë dhe mund të çojë në praktika mashtrimi.

Gjithashtu edhe zhvillimi i ekspropriimit përmes procedurave që nuk janë në fuqi do të mund të çonte drejt shkeljeve të të drejtave pronësore. Në rrethana të tilla privimi nga e drejta pronësore nuk plotëson kushtin e legjitimitetit të dhënë nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

### 3.1.1 Bashkëpunimi mes UNMIK-ut, IPVQ-ve dhe Republikës së Serbisë

Përkundër mungesës së përgjithshme të përparimit të shënuar që nga viti 2003, OSBE ka monitoruar disa nivele të bashkëpunimit mes UNMIK-ut, IPVQ-ve dhe Republikës së Serbisë në lidhje me çështjet pronësore, kryesisht ato që kanë të bëjnë me qasjen në regjistrat kadastral dhe të gjyqësorit që u bartën në Sërbi që nga qershori 1999.

Që nga viti 1999, Republika e Serbisë ka ofruar qasje UNMIK-ut në këto regjistra në baza ad hoc (p.sh ofrimi i ekstrakteve të regjistrave që kanë të bëjnë me Ndërmarrjet e Sektorit Shoqëror që kanë të bëjnë me procesin e privatizimit dhe për shfrytëzim Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB) dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB) të Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB). Ndërkohë që përparimi për të siguruar qasje dhe/ose kthimin e regjistrave ka qenë i ngadalshëm. PSSP ka kërkuar zyrtarisht nga Kryeministri i Republikës së Serbisë kthimin e këtyre regjistrave po nuk ka marrë as sot e kësaj dite ndonjë përgjigje.<sup>42</sup>

---

<sup>41</sup> Para vitit 1999, ligjet e Republikës së Serbisë janë të aplikueshme në Kosovë nën kushte të caktuara. Në nenin 1.2 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/24, Mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë, thuhet se “Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj”.

<sup>42</sup> Shiko letrat e PSSP-së Kryeministrit të Serbisë më 5 qershor 2005 dhe 14 shkurt 2006.

Në prill të vitit 2005, në një tjetër rast të bashkëpunimit mes UNMIK-ut, IPVQ-ve dhe Republikës së Serbisë, UNMIK-u dhe Komuna e Mitrovicës ka pranuar, falë ndihmës së CCK, kopjet që mungonin të të dhënave të nevojshme kadastrale për rindërtimin e Mahallës Rome në komunën e Mitrovicës/Mitrovica (një lagje e madhe e romëve e shkatëruar menjëherë pas konfliktit në vitin 1999). Të dhënat kadastrale (të datuara nga viti 1998) arkivat e të cilave gjenden në Krushevc, Sërbi, që nga viti 1999, janë vërtetuar nga AKK, për të mundësuar demarkacionin e kufijve mes pronës private dhe publike, dhe përvijëzimin e pronës individuale të tokës së paraparë për rindërtimin e shtëpive dhe ndërtesave, si dhe kompletimin eventual të planeve të infrastrukturës. Rindërtimi i lagjes filloi në prill të vitit 2006.

Përkundër përpjekjeve të AKK mbështetur nga UNMIK-u, nuk është shënuar përparim në implementimin e ligjeve të Kuvendit të Kosovës për rregjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme.<sup>43</sup> Si rrjedhojë, zyrat kadastrale në komunat veriore nuk kanë përfituar nga përmirësimet teknike të implementuara në Kosovë përmes Programit për Mbështetjen e Kadastrit të Kosovës dhe as nga ato që janë implementuar në Republikën e Serbisë AGJRS Kadastrit i Pasurisë së Patundshme dhe Projekti për Regjistrim.<sup>44</sup>

Megjithatë janë bërë përpjekje për bashkëpunim në fushën e të drejtave pronësore me QKK sepse “QKK është krijuar me qëllim të ofrimit një pike ndërlidhëse 9 në emër të Qeverisë së Serbisë) e cila do të bashkonte dhe harmonizonte të gjitha kapacitetet shtetërore, politike dhe sociale që synojnë zgjidhjen e problemeve në Kosovë dhe Metohi që kanë të bëjnë me implementimin e rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.”<sup>45</sup>

### **3.2 Strukturat paralele administrative të lokalizuara në territorin e Kosovës**

Strukturat paralele administrative që kanë të bëjnë me pronën janë të identifikuara si Drejtoritë për Urbanizëm, Departamenti për Çështje Pronësore-Juridike dhe Zyrat e RSGA të lokalizuara në komunat veriore.

---

<sup>43</sup>Më 14 qershor 2005, zyrtarë të AKK me ndihmën e UNMIK-ut ka dhënë të ligjet përkatëse dhe aktet tjera zyrtarëve të kadastrave në komunat veriore.

<sup>44</sup>Kadastra për Pasuri të Patundshme e Republikës së Serbisë dhe Plani për Implementimin e Projektit për Regjistrim, faqe 12 dhe Raporti final I profesor Patrick McAusian dhe znj. Katarina Nedeljkovic, faqe 2. Të dy raportet mund të lexohen në faqen e internetit të Agjencionit Gjeodezik të Republikës së Serbisë <http://www.rgz.sr.gov.yu/>, qasur më 15 shtator 2006.

<sup>45</sup>Korniza Kushtetuese and IRJ-UNMIK Dokumenti i përbashkët (5 nëntor 2001) konfirmojnë obligimin për të ofruar siguri, respektim të të drejtave të njeriut dhe kthimin e personave të zhvendosur dhe refugjatëve. Për më shumë informata për QKK shiko <http://www.kc.gov.yu>, qasur më 15 shtator 2006. Sipas Dokumentit të Përbashkët, fushat specifike të angazhimit dhe interesat e përbashkëta kanë të bëjnë me sigurinë, mbrojtjen dhe lirinë e lëvizjes, mbrojtjen e pasurisë dhe vendeve kulturore, gjyqësorin, bashkëpunimin policor, pushtetin lokal, arsimin dhe mediat. Përpjekjet për bashkëpunim në fushën e kthimit janë elaboruar tutje në vitin 2006 me nënshkrimin e Protokollit për Kthim të Qëndrueshëm dhe Vullnetar. Protokoli është nënshkruar mes UNMIK-ut, IPVQ dhe Qeverisë së Serbisë më 6 qershor 2006. Protokoli mund të lexohet në <http://www.unmikonline.org/pio/returns/Protocol-on-returns-eng.pdf>, qasur më 27 shtator 2006.

### 3.2.1 Drejtoratet Komunale për Urbanizëm dhe Drejtoratet për Çështje Pronësore-Juridike

Drejtoritë Komunale për Urbanizëm në komunat veriore vazhdojnë të implementojnë kornizën e Republikës së Serbisë për ndërtimin dhe planifikimin hapësinor dhe të injorojnë ekzistimin e legjislacionit relevant të Kuvendit të Kosovës. Gjithashtu edhe OSBE ka identifikuar rastet e ekspropriimit të strukturave administrative paralele. Gjatë një rasti të monitoruar në Zvečan/Zveçan, Komuna ka këshilluar bartësit e të drejtave pronësore që të ankohen për vendimin e ekspropriimit të Ministrisë së Financave të Republikës së Serbisë si instanca e dytë e shqyrtimit administrativ. Ky vendim ka ndikuar negativisht në të drejtat pronësore dhe të kompenzimit të të drejtave pronësore, meqë janë referuar tek organet që nuk kanë autoritet në territorin e Kosovës dhe nuk mund të ofrojnë trajtim adekuat dhe efektiv të këtyre të drejtave.<sup>46</sup>

Në një rast të monitoruar në komunën e Zubin Potokut, pushteti lokal ka reduktuar procedurën e ekspropriimit me blerjen e tokës nga bartësit e të drejtës pronësore që kanë pësuar nga ndërtimi i rrugës dhe i ka vëretuar mëpas kontratat në gjykatën paralele të panjohur të Mitrovicës/Mitrovica.<sup>47</sup> Për më tepër, OSBE-ja ka identifikuar një ndarje komunale të tokës me ç'rast kanë injoruar kompetencat e rezervuara të UNMIK-ut për shfrytëzimin e pronës shoqërore.<sup>48</sup>

Në përgjithësi, në fushat ku operojnë strukturat paralele, implementimi i kornizës së Republikës së Serbisë për Ndërtim dhe Planifikim Hapësinor është i pavend dhe krijon pasiguri ligjore duke i lënë të drejtat individuale të pambrojtura.

### 3.2.2. Zyrat e Autoritetit të Gjeodezisë së Republikës së Serbisë

Zyrat e AGjRS janë të pranishme në komunat e Leposavić/Leposavić/Leposaviqit , Zvečan/Zveçanit, Zubin Potokut dhe në tërë Serbinë. Në komunat veriore këto zyra lëshojnë listat poseduese dhe dokumentet tjera përkatëse, por nuk i implementojnë ligjet e Kuvendit të Kosovës për regjistrimin e të drejtave të pronës së patundshme. Fakti që ekzistojnë dy regjistra kadastral për të njëjtat prona (Kadastr i Kosovës për të Drejtat e Pronës së Patundshme dhe AGJRS), krijon pasiguri ligjore dhe e bën më të lehtë mashtrimin meqë një individ mundet teorikisht të bartë pasurinë e njëjtë të patundshme dy herë personave të ndryshëm. Gjithashtu edhe mos implementimi i ligjeve të Kuvendit të Kosovës në mënyrë efektive ua mohon individëve që jetojnë në këto hapësira të drejtën e regjistrimit të hipotekave.

Bartësit e të drejtave pronësore të komuniteteve pakicë (në këto hapësira, shqiptarët e Kosovës), në përgjithësi kanë qasje në shërbimet që ofrohen nga zyrat kadastrale në baza ad hoc përmes Zyrave Komunale për Komunitete dhe/ose zyrtarëve ndërkombëtar të UNMIK-ut. Për shembull në Zubin Potok, në kuadër të procesit për vërtetimin e të drejtave pronësore, bartësit e të drejtave pronësore nga fshati Çabër/Čabra kanë marrë kopjet e listave poseduese të tokave të tyre (si parakusht i domosdoshëm për rindërtimin e shtëpive të tyre). Banorët shqiptarë të Kosovës të

<sup>46</sup> Shiko vendimin e Komunës së Zvečan/Zveçanit – Drejtorisë për Çështje Pronësore Juridike 03, Nr.35-351/49-1, 15 nëntor 2001.

<sup>47</sup> Zubin Potok; Kontratat për transferim të pasurisë së patundshme, Nr.01-464-40/42/43/44/47 20 Mars 2003,.

<sup>48</sup> Komuna e Zubin Potokut, vendimi Nr. 08-464/220, 4 gusht 2004.

fshatrave Koshutovë/Košutovo, Bistricë/Bistrica dhe Cerajë/Ceranja në komunën e Leposavić/ Leposaviqit gjithashtu kanë marrë listat poseduese për qëllim të njëjtë. Por banorët në Zvečan/Zvečan banorët e fshatit Zhahë/Žaža është raportuar të kenë shfrytëzuar shërbimet nga Zyra Kadastrale e Komunës së Mitrovicës.

### 3.3 Strukturat paralele administrative të lokalizuara jashtë territorit të Kosovës

Siç pasqyrohet në vlerësimin për vitin 2003, Republika e Serbisë ka mbajtur zyrat e zhvendosura të ADRS –së në qytete të ndryshme në Serbi. Kështu që kosovarët kohë pas kohe kanë shfrytëzuar dokumentet pronësore si për shembull listat poseduese të lëshuara nga këto zyra të zhvendosura kadastrale të lokalizuara në territorin e ngushtë të Serbisë.

Në këtë vlerësim, OSBE-ja mendon që situata nuk ka ndryshuar shumë. ADRS ka mbajtur zyrën e saj regjionale të Prishtinës/Priština në Leposavić/Leposaviq. Zyrat tjera që ishin të lokalizuara në Kosovë para qershorit të vitit 1999 vazhdojnë të zhvendosen në qytete të ndryshme brenda Serbisë, kryesisht në Krushevc, Leskovc dhe Nish.<sup>49</sup>

OSBE gjithashtu ka vërejtur që këto dokumente të lëshuara nga këto zyra të zhvendosura të shfrytëzohen kohë pas kohe edhe nga OJQ-të dhe /apo agjencionet implementuese për të mbështetur rindërtimin e shtëpive për personat e zhvendosur dhe të kthyerit e mundshëm. Por vlefshmëria e këtyre dokumenteve është i paqartë. Disa prej këtyre regjistrave kadastral të lëshuara nga zyrat e zhvendosura iu referohen komunave prej nga vijnë si vendi i lëshimit. Për rezultat zyrtarët e Kosovës kanë refuzuar ti pranojnë ato si dokumente valide. Për shembull, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike në Ferizaj i ka deklaruar OSBE-së se nuk i konsideron dokumentet e tilla si të vlefshme.<sup>50</sup>

Në disa raste tjera, autoritetet lokale kanë gjetur zgjidhje tjera *ad hoc*. Përveç bashkëpunimit në procesin e ndërtimit të Mahallës Rome në Mitrovicë/Mitrovica që përmendet mësipër, Zyra Kadastrale Komunale në Ferizaj/Uroševac në një rast ka pranuar dokumentet e dorëzuara nga personat e zhvendosur dhe të lëshuar nga zyrat e zhvendosura kadastrale në Krushevc përkundër faktit që regjistrat ekzistonin edhe në komunë. Zyra Kadastrale Komunale pastaj i ka përtërirë regjistrat e vet për të lëshuar certifikatat e nevojshme kadastrale për procesin e rindërtimit.<sup>51</sup>

---

<sup>49</sup> Shiko faqen e internetit që Autoritetit Gjeodetik të Republikës së Serbisë. [http://www.rgz.sr.gov.yu/centar\\_list.asp?CentarID=8&LanguageID=3&PageNumber=1](http://www.rgz.sr.gov.yu/centar_list.asp?CentarID=8&LanguageID=3&PageNumber=1), qasur më 15 shtator 2006. regjistrat e zhvendosur kadastral nga komunat tjera janë mbajtur nga OSBE në Shtime, Shtërpçë (regjistrat që vijnë nga Leskovci) Kamenica, Ferizaji, Vitia, Rahovec/Orahovaci (Krusheci) . Disa transaksione të pasurisë janë regjistruar në Gjykatën Komunale të Leskovcit.

<sup>50</sup> Intervistë me Kryesuesin e Departamentit për Çështje Pronësore-Juridike në Komunë, 2 gusht 2006.

<sup>51</sup> Intervistë me Menaxherin e Projektit për Perspektivën Europiane, partnerin implementues të projektit të kthimit në Fshatin Babushi Serb, 26 korrik 2006. OJQ/partnerë të tjerë për projektin për kthim në komunë kanë konfirmuar që të gjithë kërkojnë të marrin dokumentet përkatëse nga strukturat paralele administrative (p.sh. CARE International në Talinoc dhe Këshilli i Bashkuar Metodist për ndihma në Bablak (UMCOR).

## **4. SISTEMI PARALEL I ARSIMIT**

### **4.1 Strukturat**

Në Kosovë veprojnë dy sisteme të arsimit. Shkollat në hapësirat e banuara me goranë dhe serb të Kosovës përbëjnë shumicën që shfrytëzojnë planprogramet e Ministrisë së Arsimit të Serbisë. MAS gjithashtu i furnizon këto shkolla me tekste shkollore, diploma dhe vula. Mësimdhënësit dhe stafi tjetër përkrahës mbikëqyren dhe udhëhiqen nga Beogradi dhe deri vonë kanë marrë pagat nga MAS dhe MASHT.<sup>52</sup> Deri tani nuk ka ende njohje të certifikatave dhe të diplomave mes dy sistemeve.

Shkollat paralele veprojnë në tërë rajonin e Kosovës.<sup>53</sup> Në regjionin e Prishtinës/Priština, janë identifikuar 19 shkolla fillore dhe 9 të mesme në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Prishtinë/Priština, Lipjan/Lipljan dhe Obiliq/Obilić.

Në regjionin e Prizrenit ekzistojnë 11 objekte të arsimit paralel në Rahovec/Orahovac dhe Dragash/Dragaš me tetë shkolla fillore dhe dy të mesme.

Tridhjetë e katër shkolla paralele janë të lokalizuara në Mitrovicë dhe Kosovën veriore, ku të gjitha institucionet arsimore janë paralele. Gjithashtu ekzistojnë shkolla paralele të lokalizuara në Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn.

Në regjionin e Pejës, tri shkolla fillore dhe tri të mesme gjenden të lokalizuara në komunitet Istog/Istok, Klinë/Klina dhe Pejë/Peć .

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, janë identifikuar 21 shkolla fillore dhe 10 të mesme të strukturave paralele në Gjilan/Gnjilane, Viti/Vitina, Novobërdë/Novo Brdo, Štrpce/Shtërpçë dhe Kamenicë/Kamenica.

### **4.2 Shkaqet dhe pasojat e strukturave paralele në arsim**

OSBE vazhdon të identifikojë dhe shqyrtojë pengesat që ekzistojnë në Kosovë dhe Serbi të cilat pengojnë integrimin e strukturave institucionale paralele në një sistem të unifikuar arsimor. Është gjithashtu e rëndësishme që të përmendet që fare pak ndryshime janë shfaqur nga viti 2003 për të shëruar pasojat dhe shkaqet e shkollave paralele, madje në disa raste ndarja mes dy sistemeve vetëm sa është thelluar.

#### **4.2.1 Shkaqet e ekzistimit të strukturave paralele**

---

<sup>52</sup> Shiko paragrafin (4.2.1.3) në vijim për detajet tjera për pagat e dyfishta të marra nga mësimdhënësit serb të Kosovës.

<sup>53</sup> Shiko Shtojcën I për listën e plotë të gjitha institucioneve paralele të arsimit në Kosovë.

#### 4.2.1.1 Ndjenja e perceptuar e mungesës së sigurisë

Dhuna e marsit 2004 ka dëmtuar në mënyrë serioze mjedisin e sigurisë për komunitetet pakicë kudo në Kosovë. Por ka patur një ulje të dukshme të dhunës ndëretnike posaçërisht gjatë gjashtë muajve të fundit. Sërish, keqtrajtimi, provokimi dhe fyerja mbeten shqetësime të rregullta për serbët e Kosovës, andaj edhe ndjenja e perceptuar e mungesës së sigurisë mbetet arsyeja kryesore pse serbët e Kosovës refuzojnë të integrohen në institucionet arsimore të IPVQ.

Në përgjithësi, ekziston perceptimi që shkollat që udhëhiqen nga IPVQ janë të pasigurta dhe në disa raste nxënësit serb të Kosovës vazhdojnë të udhëtojnë jashtë komunave të tyre për të vijuar mësimin në shkollat e mesme në enklavat serbe të Kosovës.<sup>54</sup> Që nga viti 2003, ekziston një përmirësim i dukshëm sa i përket përpjekjeve komunale për të siguruar transport të rregullt dhe të sigurtë për fshatrat e pakicave për nxënësit e tyre.<sup>55</sup> Ekzistojnë vetëm dy raste ku përcjellja me SHPK për transport ofrohet për nxënësin minoritar nga Gojbuja (komuna e Vushtrrisë/Vučitrn) për në Mitrovicën veriore, si dhe nga Obiliq/Obilići në vijën Babimoc/Babin Most - Plemetin/Plemetina - Caravodicë/Črkvena Vodica -Obiliq/Obilići.<sup>56</sup> Në disa vende, prania e shtuar e patrullave të SHPK-së ka kontribuar në uljen e brengave për sigurinë për pakicat.

#### 4.2.1.2 Pikëpamjet e komunitetit shqiptar dhe serb të Kosovës për tolerancën dhe gjetjen e gjuhës së përbashkët

Mbrojtja e pakicave është përcaktuar nga IPVQ dhe bashkësia ndërkombëtare si parakusht i domosdoshëm për zgjidhjen e statusit, i garantuar më tutje në Planin për Implementimin e Standardeve të Kosovës, Planin e Veprimit të Partneritetit Europian, Ligjin e Kuvendit të Kosovës Nr. 2004/3 –Ligjin për Anti Diskriminim të miratuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9, e cila parasheh që “Institucionet e përkohëshme vetëqeverisëse do të mbrojnë dhe sigurojnë të drejtat ndërkombëtarisht të njohura të të drejtave dhe lirive të njeriut , përfshirë edhe ato të drejta dhe liri të përcaktuara me [...] Konventën Kornizë të Këshillit të Sigurimit për Mbrojtjen e Minoriteteve Nacionale.”<sup>57</sup> Ndonëse, as MASHT dhe as ndonjë autoritet komunal nuk ka draftuar

<sup>54</sup> Novobërdë – nxënësit udhëtojnë në Gjilan (shërbimet e ofruara nga komuna e Gjilanit/Gnjilane) Ferizaj për Shtërpçë dhe Lypjan; Vushtrri/Vučitrn për në Mitrovicën veriore.

<sup>55</sup> Përfshirje bënë: Novobërdë – ka transport minimal dhe ka vështirësi të për të rregulluar sistemin e transportit për minoritete për këto arsye: shkollat janë të shpërndara në tërë komunën; mbajtja e mësimin në orët e hershme shton vështirësitë për të koordinuar marrjen e nxënësve; dhe minibusi i vetëm ka 9 ulëse. Nuk janë marrë parasysh komunitetet/etnitë se cilave shkolla do tu shërbehet. Por vendimi është bazuar në afërsinë mes dy shkollave. Aq më shumë që nxënësit duhet të paguajnë 5 euro për shërbimin. Janë të liruar nxënësit, prindërit e të cilëve nuk janë në gjendje të paguajnë Komuna e Pejës e njëhë një përgjegjësinë që duhet të ofrojë këtë shërbim për disa serb të Kosovës dhe minoritete tjera të Komunës. Mungesa e mjeteve duket të jetë arsyeja për shërbime të kufizuara. Skenderaj/Srbica – MSAS ofron transport për nxënësit prej Suhogërlë në Bajë. Dragash/Dragaš – transporti ofrohet vetëm për shkollat e mesme për shkak të mungesës së mjeteve. Prishtinë/Priština – I tërë transporti për Preoc -/Gračanica/Gračanicë dhe Brnicë e Ulët – Gračanica/Gračanicë mundësohet nga MSAS.

<sup>56</sup> Kërkesat për përcjellje të transportit janë bërë nga shumë prindër në shumë komuna, por janë vlerësuar si të panevojshme pas vlerësimeve të SHPK-së dhe KFOR-it.

<sup>57</sup> Shih Kornizën Kushtetuese Kaptina 3 –Të drejtat e njeriut.

ndonjë plan gjithëpërfshirës që do të mundësonte integrimin e komunitetit serb dhe goran të Kosovës në sistemin arsimor të MASHT.<sup>58</sup>

Në tërësi, nuk ka ndonjë shenjë të përmirësimit të tolerancës dhe as përpjekje për të gjetur gjuhë të përbashkët ndërmjet komunitetit shqiptar dhe serb të Kosovës në nivelin qëndror. MASHT ka provuar të inkurajojë serbët e Kosovës për të aplikuar për vende të punës në arsim përmes konkurseve të shpallura në media në gjuhën serbe: porse përgjigjet gradohet prej të ultë deri në joekzistente.<sup>59</sup>

Situata është po aq e komplikuar edhe në nivelin komunal ku stafi i arsimit vazhdon të jetë peng i udhëzimeve nga MASHT dhe MAS për çështjet vitale siç janë planprogramet dhe pagat, duke përfshirë këtu edhe ndarjen e përgjithshme të përgjegjësisë për arsimin.<sup>60</sup> Kjo ndarje e thellë lejon fare pak hapësirë për bashkëpunim mes mësimdhënësve shqiptar dhe serb të Kosovës duke e bërë të pamundur që kjo ndarje të evitohet.<sup>61</sup> Është me rëndësi të thuhet që ka patur përpjekje të shumta pozitive nga të dyja palët në nivel lokal për të inicuar diskutimet dhe angazhuar në aktivitetet që do të mund të çonin në konsolidimin e sistemeve arsimore, apo së paku të ndërtohet toleranca dhe mirëkuptimi ndërmjet MASHT-it dhe zyrtarëve të MAS, të gjitha përpjekjet kanë stagnuar për shkak të qëndrimeve të pakompromis të zyrtarëve arsimor, komuniteteve vendore dhe rishtazi edhe për shkak të përfshirjes së QKK dhe klimës së pasigurtë politike me rastin e afrimit të zgjidhjes së statusit.<sup>62</sup>

Nismat e IPVQ për të akomoduar nevojat e komuniteteve minoritare, ka rezultuar në uljen e kërkesave për të shkollave paralele. Shumë komuna kanë demonstruar një shkallë të gatishmërisë për të bashkëpunuar me përfaqësuesit e MSA dhe shpesh kanë furnizuar shkollat paralele me asistencë dhe furnizime në formë të drurit për ngrohje, asistencë transporti, ndihmë infrastrukturore dhe furnizime tjera arsimore por jo edhe

---

<sup>58</sup> Sipas MASHT në nivelin qëndror janë bërë përpjekje gjatë këtyre viteve të fundit për të bashkëpunuar dhe për t'ju adresuar këtyre dallimeve me MSAS, por pa ndonjë rezultat. Në Skenderaj/Srbica, Departamenti për Arsim ka draftuar një projekt –propozim për rindërtimin e dhjetë shkollave përfshirë edhe një në Banjë Në Mitrovicën Jugore, organet komunale dhe regjionale takoheshin me komunitetin serb të Kosovës për të diskutuar integrimin por idetë janë hedhur poshtë nga serbt e Kosovës. Për më tepër komunikimi është ndërprerë në shumë komunat pas urdhërësës së QKK të lëshuar në dhjetor të vitit 2005. Në Rahovec/Orahovac, komuna ka lansuar një plan gjashtë mujor për integrim në mars të vitit 2006 për të ndërtuar besimin në mesin e komunitetit serb të Kosovës përmes aktiviteteve të zhvilluara në terren të udhëhequra nga drejtorët komunal. Mësimdhënësit goranë në Dragash/Dragaš kanë refuzuar planin për integrim kryesisht për arsye financiare.

<sup>59</sup> MASHT boton konkurset për vende të lira pune në shtypin serb dhe mediat tjera.

<sup>60</sup> Shkollat e mesme të MSA aplikojnë sisteme notimi më të detajizuara sesa ato të MASHT.

<sup>61</sup> Serbët e Kosovës pohojnë që ju duhet miratimi nga MSAS për të qenë në gjendje të integrohen apo që QKK ka bllokuar çdo shenjë për përpjekje. Shqiptarët e Kosovës përsërisin që ata vazhdimisht demonstrojnë iniciative nga ana e tyre apo shfaqin 'politikën e derës së hapur' drejt komunitetit serb në Kosovë.

<sup>62</sup> Skenderaj/Srbica –drejtori i shkollës serbe të Kosovës është i hapur për të diskutuar format e mundshme të bashkëpunimit por pohon të mos ketë përcjellje për në qytetin e Skenderaj/Srbica t; Vushtrri/Vučitrn, Ferizaj, Lipjan/Lipljan, Viti dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje janë vetëm disa nga komunat që pohojnë që komuniteti serb në Kosovë refuzon të bashkëpunojë. Në komunat tjera si në Gjilan, Rahovec/Orahovac, Dragash/Dragaš dhe Istog/Istok ka patur shenja pozitive të ndërtimit të tolerancës por jo edhe të ndonjë dialogu të vërtet. Në Viti, takimet për integrime janë ndërprerë në fund të vitit 2005 pas përfundimit të asistencës financiare të komunës për mirëmbajtjen dhe kostot shpenzuese të shkollave paralele kur drejtorët e shkollave refuzuan të vendosin shenjat në dygjuhësi në institucionet e tyre.

tekste shkollore.<sup>63</sup> Posaçërisht në Dragash/Dragaš, MASHT-i ka organizuar mësimin e përsheptuar për nxënësit goranë të klasës së nëntë. Në vitin 2006, IPVQ kanë ndërtuar shkolla në Lipjan/Lipljan, Ferizaj/Uroševac, dhe Gračanica/Gračanicë në përpjekje për të akomoduar nevojat e nxënësve serb të Kosovës.<sup>64</sup> Nuk ka patur raste të raportuara që nga viti 2003 të refuzimit të pjesëmarrjes së nxënësve serb apo goran të Kosovës në institucionet arsimore të IPVQ.

#### 4.2.1.3 Heqja dorë nga pagat e IPVQ-së për serbët e Kosovës

Që nga fundi i konfliktit deri në mars-qershor 2006, shumë mësimdhënës serb të Kosovës kanë marrë paga të dyfishta – një prej MSA dhe tjetrën nga IPVQ-të.<sup>65</sup> Nga QKK është lëshuar një urdhëresë në dhjetor të vitit 2005 që ftone stafin goran dhe serb të zgjedhin mes marrjes së pagës nga Serbia apo IPVQ-të.<sup>66</sup> Si rezultat, i tërë stafi i sektorit të arsimit ka hequr dorë nga pagat që merrnin prej IPVQ-ve duke hequr veten vullnetarisht nga lista e pagave apo duke dorëzuar deklaratat me shkrim komunave përkatëse, për të vazhduar me marrjen e pagave më të larta të paguara nga MSAS.<sup>67</sup>

---

<sup>63</sup> Tekstet shkollore furnizohen kryesisht nga MSAS për institucionet paralele arsimore. Disa komuna pohojnë që librat të jenë bërë gati në sërbiisht por nuk ka ndihmë nga ana e minoriteteve për ti përpiluar ato ndërkohë që disa të tjerë pohojnë që gjuha serbe është e institucionizuar në kuadër të sistemit arsimor komunal edhe pse nuk ka fakte për të mbështetur këtë pohim. Shpesh pala e shqipëtarëve të Kosovës pohon që serbët e Kosovës nuk respektojnë Rregullorën e UNMIK-ut Nr. 2002/19 për nënshkrimin e ligjit të miratuar në Kuvendin e Koson për Arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovën

<sup>64</sup> Është e qartë që në rastin e Kopshtit për Fëmijë në Gračanica/Gračanicë është arritur bashkëpunimi mes IPVQ dhe Sërbisë për të mundësuar shkollat të mbikëqyren dhe udhëhiqen nga MSAS. Në fshatin e të kthyerve në Videjë (komuna e Klinës), autoritetet komunale kanë ofruar që të kyqin fëmijët serb të Kosovës të vijnë në mësimin në shkollën në Jagodë, por komuniteti serb i Kosovës ka hezitur dhe në vend të kësaj kanë shëndruar një shtëpi private në shkollë dhe kanë punësuar një mësues serb për të mësuar nxënësit sipas planprogramit të SMES.

<sup>65</sup> Paga për mësuesit serb të Kosovës nga MSAS është përafërsisht dyherë sa mesatarja e mësuesve që paguhet në Sërbi ( kryesisht prej 200-250 Euro plus 100%, duke rezultuar në pagat që arrijnë m 400-500 Euro në muaj varësisht nga përvoja dhe përgatitja profesionale). MSAS pohon që qëllimi i pagave të larta është të kompenzohen mësimdhënësit serb dhe të inkurajohen që të mbajnë pozicionet e tyre në Kosovë. Ndërsa sipas MASHT paga mesatare mujore për një mësimdhënës pavarësisht nga përkatësia etnike është 189 Euro në muaj. Ekzistojnë lloje të ndryshme të kontratave sipas MASHT varësisht nga madhësia e klasave, niveli i arsimit (fillor apo i mesëm) të cilat ndikojnë në rritjen e një sasive të vogël të pagës. Thuhet që kur mësimdhënësit serb kanë marrë pagat prej MASHT ata nuk do të merrnin mesataren prej 189 Euro siç parashihte MASHT. Fondet janë dërguar si një tërësi në komuna të cilat më pastaj ua kanë shpërndarë ato drejtorëve të shkollave të cilët pastaj kanë vensodur tua shpërndajnë ato mjete gjithë mësimdhënësve pavarësisht nëse kanë pranuar apo jo të marrin mjete nga fondet e MASHT (kështu që një mësimdhënës mund të merrte vetëm 150 euro në muaj).

<sup>66</sup> Urdhëresa e QKK thotë: “Të gjithë individët që krijojnë marrëdhënie pune në institucionet jashtë kompetencave të Republikës së Sërbisë (UNMIK, IPVQ) apo që angazhohen në ndonjë mënyrë mënyrë në këto institucione duhet të vendosin për marrëdhënie të njëfishta pune. Në të kundërtën marrëdhëniet e punës në institucionet e Republikës së Sërbisë do të ndërpriten. Kërkojmë nga ju që të informoni të gjithë koordinatorët komunal që i mbikëqyrni.” Kjo gjithashtu plotësohet nga një udhëzim i lëshuar nga MSAS Nr. 611-364 on 06.10.2005

<sup>67</sup> Sipas rezultateve që marra nga Ekipet Komunale të OSBE-së, është treguar që stafi arsimor është dashur të sjellë konfirmimin që kanë mbyllur llogaritë bankare prej ku kanë tërhequr pagat nga MASHT për të dëshmuar respektimin e kësaj urdhërese. Hpor ka patur raste kur llogaritë bankare nuk kanë mundur të mbyllen sepse individët kanë marrë kredi dhe nuk kanë mundur të përmbyllin llogaritë pa i paguar kreditë deri në fund. Ata pak individë që nuk kanë mundur ti mbyllin llogaritë bankare nuk kanë mundur të marrin pagat në MSAS. Gjithashtu është raportuar që ka patur staf që ka rihapur



Duhet cekur që edhe pse stafi arsimor serb i Kosovës ndonëse merrte paga nga IPVQ-të, përveç disa personave, nuk ka nënshkruar kontrata individuale me MASHT.<sup>68</sup> OSBE-ja është e shqetësuar për faktin se jo të gjithë mësimitdhënësit mund të kenë hequr dorë vullnetarisht nga pagat, por këtë do ta kenë bërë nga frika se do të humbnin punën në MSAS, dhe të hynin në listën e zezë për punësim në Serbi apo të pësojnë nga fyerjet apo izolimi nga ana e komunitetit të tyre.<sup>69</sup>

Heqja dorë nga pagat në tërë Kosovën nuk ka pasur ndonjë efekt të dukshëm në sasinë dhe cilësinë e shërbimeve arsimore të ofruara nga institucionet përkatëse arsimore. Ekziston numër i mjaftueshëm i mësimitdhënësve për të plotësuar nevojat e nxënësve dhe deri tani nuk është detyruar ndonjë institucion të mbyllet për shkak të mungesës së stafit mësimitdhënës.<sup>70</sup> Është e rëndësishme të ceket që ristrukturimi komunal si pasojë e buxhetit të zvogëluar nuk ka pasur ndonjë ndikim në arsimin për pakica.<sup>71</sup>

Mundësitë gjithsesi ekzistojnë për mësimitdhënësit e shkollave paralele në institucionet komunale apo si shërbyes civil të paguhen nga komuna apo në përputhje me kuotat për Ndarjen e Drejtë të Financave për punësimin e pakicave. Sipas drejtorit regjional të MASHT për Pejë, drejtorët e shkollave fillore kanë shprehur zemërgjerësi sa i përket shkallës së punësimit të stafit mësimit në shkollat serbe të Kosovës, dhe në shumë raste janë punësuar më shumë mësimitdhënës nga numri që është paraparë me ligj. Kjo paguhet nga shfrytëzimi i pagave për mësuesit që kanë hequr dorë nga lista e pagave të IPVQ. Përfaqësuesit e MSAS pohojnë që sistemi i IPVQ është ‘mbyllur’ për mësimitdhënësit serb të Kosovës; por OSBE nuk mund të konfirmojë saktësinë e këtij pohimi.

Shumë zyrtarë komunal të MASHT-it në Kosovë konstatojnë që ka tepër mësimitdhënës dhe administratorë në shkollat serbe të Kosovës, porse nuk është bërë ndonjë reduktim i numrit të personave që paguhen për shërbimet që ofrojnë në lëmin e

---

llogaritë bankare për të marrë mjete nga IPVQ . Sipas drejtorëve të njëjtë komunal, mjetet vazhdojnë të transferohen në mënyrë që ato të shfrytëzohen për nevoja të tjera të shkollave serbe në Kosovë sipas kërkesës së Kryeministrit. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, drejtori komunal për arsim ka refuzuar të lëshojë një letër për mësimitdhënësit serb të Kosovës për tua ndërprerë marrëdhënien e tyre me IPVQ .

<sup>68</sup> Është nënshkruar një lloj marrëveshje mes shkollave dhe MASHT për të lejuar që serbët e Kosovës të marrin pagat e IPVQ. Kështu që stafi arsimor është dashur të nënshkruaj vetëm faturat bankare në çdo muaj për të marrë ato mjete. Në Gjilan, dy apo tre mësimitdhënës kanë pyetur nëse mund të marrin ato mjete, dhe atyre u është thënë që së pari ti kontaktojnë drejtorët e shkollave duke ua bërë kështu me dije për mundësinë e ‘izolimit’ të këtyre individëve nga komuniteti i tyre.

<sup>69</sup> Sipas koordinatorit për arsim të MSAS në Ranillug, ata që nuk kanë pasuar urdhëresën automatikisht janë hequr nga listat e MSAS. Në Vushtrri/Vuçitrn, Drejtori komunal për Arsim iu ka referuar një rasti të serbit të Kosovës i cili ka dashur të nënshkruaj kontratë dhe të marrë pagën nga MASHT por në fund ka vendosur që mos ta marrë atë nga frika e dhunës që mund të ushtrohet ndaj tij nga komuniteti serb i Kosovës. Në Viti, 48 mësimitdhënës kanë shprehur interesimin për të kthyer pagat e MASHT dhe kanë dashur që zyrtarisht të kthehen në listat e pagave të IPVQ. MSAS përmes QKK është informuar për këtë iniciativë dhe i ka suspenduar ata nga lista e pagave për muajin maj 2006. MSAS ka vendosur mos ti suspendojë kontratat e 48 mësimitdhënësve dhe ka indikacione që pagat e suspenduara për muajin maj të paguhen në mënyrë retroaktive. Ata janë ballafaquar me ultimatumin e QKK për të tërhequr kërkesat e tyre nga MASHT nëse dëshirojnë që të vazhdojnë kontratat me MSAS. Të gjithë mësimitdhënësit kanë tërhequr kërkesën e tyre dhe tani paguhen ekskluzivisht nga MSAS. .

<sup>70</sup> Në komunën e Pejës katër mësimitdhënës janë larguar nga pozitat e tyre, dy janë zëvendësuar dhe fushata e rekrutimit akoma po vazhdon për të plotësuar këto dy vende të lira pune .

<sup>71</sup> Në Rahovec/Orahovac, katër nga stafi mbështetës janë larguar vitin e kaluar sipas UA 2002/16 të Ministrisë së Arsimit ngaqë përçindja e stafit mbështetës tejkalon numrin e nxënësve. Kjo është pasojë e urdhëresës së QKK dhe heqjes dorë kolektivisht nga pagat e IPVQ .

arsimit.<sup>72</sup> Sikur edhe në vitin 2003, drejtorët e shkollave serbe të Kosovës vazhdojnë së emëruari mësimdhënësit pa konsultuar MASHT, qoftë edhe pa i respektuar procedurat e tyre qoftë edhe për stafin i cili ka marrë paga të IPVQ-ve.<sup>73</sup> Ka patur raste të izoluar kur zyrtarët e MASHT-it janë informuar për emërimet dhe atë për hir të bashkëpunimit.

#### 4.3.1. Efektet e strukturave paralele

##### 4.3.1.1. Planprogramet e ndryshme

Meqë MSAS dhe MASHT nuk kanë arritur marrëveshje për planprogramet për Kosovën, nxënësit vazhdojnë të kenë vështirësi me planprogramet që ndryshojnë varësisht prej sistemit që ata zgjedhin për të mësuar. Serbët e Kosovës nuk kanë alternativë tjetër pos të pasojnë sistemin e MSAS sepse ata nuk janë përllogaritur në sistemin e MASHT-it.<sup>74</sup> Këto ndryshime vazhdojnë të ushtrojnë ndikim tek studentët të cilët mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të mësuar gjuhën amtare dhe të mësojnë historinë dhe kulturën e grupit të tyre etnik. Në përgjithësi serbët e Kosovës i gëzojnë këto të drejta me planprogramet e MSAS, por romët janë shumë të kufizuar sepse në asnjërin sistem nuk ka pjesë për mësim në gjuhën rome, apo për grupin e tyre etnik: kështu që ata si tërësi mësojnë në gjuhën serbe.<sup>75</sup> Sidoqoftë romët, hashkalinjtë dhe egjiptianët janë plotësisht të integruar si në MSAS ashtu edhe në MASHT. Boshnjakët dhe turqit e Kosovës mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të mësojnë në gjuhën e tyre sipas planprogrameve të MASHT-it, ndërkohë që shumica e shkollave në gjuhën gorane punojnë me planprograme të MSAS-së përveç në Restelicë/Restelica dhe Krushevë/Kruševo të cilët punojnë me planprograme të MASHT-it.<sup>76</sup>

---

<sup>72</sup> . Në Rahovec/Orahovac, Dragash/Dragaš, Skenderaj/Srbica , Vushtrri/Vučitrn dhe Kamenicë, drejtorët komunal për arsim tregojnë për mos përputhjen e shkallës nxënës/mësimdhënës, ndërsa në Vushtri, komuna mendon që shkollat shqiptet kanë staf të tepërt

<sup>73</sup> Në Viti, MASHT nuk ka konsultuar drejtorët e shkollave serbe të Kosovës kur është bërë zvogëlimi i stafit në vitin 2005 .

<sup>74</sup> Ekziston një përjashtim; Kopshti për Fëmijë ‘Sunce’ në Kamenicë të Serbëve të Kosovës punon me planprograme të MASHT.

<sup>75</sup> Në Pejë, sipas MASHT, 100 Romë hashkalinjë dhe egjiptian nxënësve të shkollës Xhemajl Kada u është ofruar të kenë orë shtesë në gjuhën rome; komuna në anën tjetër e ka patur vështirë të identifikojë një mësimdhënës të kualifikuar. Edhe tekstet shkollore që ka të bëjnë me romë, hashkalinjë dhe egjiptianë është vështirë të gjenden sepse planprogramet e MASHT ofrojnë fare pak. Në Gjilan dhe Mitrovicën veriore sipas planprogramit të MSAS nxënësit romë kanë shkollim shtesë në gjuhën e tyre amtare. Në Zvečan/Zveçan dhe Shtërpçë, nuk mbahen orë shtesë për shkak të numrit të vogël të nxënësve romë. OJQ Programa de Apoyo a la Democracia Municipal (PADEM) ofron arsim plotësues në gjuhën rome në Leposaviç ndërsa në Mitrovicën veriore ofrohet një lëndë në gjuhën rome por komuna po has në vështirësi për të identifikuar një mësimdhënës të kualifikuar. .

<sup>76</sup> MASHT ka bërë të reja në boshnjakisht dhe turqisht të cilat mbulojnë edhe orët për katër lëndët kryesore nacionale – gjuhë, kulturë, art dhe histori – duke mbuluar klasët 1-13, përveç klasës së 5 e cila do të integrohet në sistem në vitin 2007. Deri vonë nxënësit boshnjak dhe goranë të Kosovës kanë përporur librat nga Bosna të cilat nuk ishin në përputhje me plan programin e reformuar të MASHT. MASHT ka botuar libra të rinjë për klasët 1, 2, 6 dhe 7 për vitin akademik 2006-2007 a. Librat e rinj për klasën e 9 janë shtypur në vitin 2005 -2006. Pjesa tjetër e librave pritet të botohet gjatë vitit 2007. Sipas *Institucionit të Ombudspersonit* në Kosovë Raporti i Gjashtë Vjetor 2005-2006] i adresuar në Kuvendin e Kosovës më 11 korrik 2006, faqe 31 thotë, ‘janë botuar vetëm disa libra në gjuhën turke. Dhe për këtë nxënësit e shkollave filllore dhe të mesme shfrytëzojnë librat nga Turqia edhe pse ato nuk janë në përputhje me plan programet e reja të Kosovës.’ Është e rëndësishme të ceket që e vetmja iniciativë për të krijuar plan programe të MASHT në gjuhën serbe është të përkthehen librat për secilën

Në radhët e komunitetit serb të Kosovës ekzistojnë shqetësime se me plan-programin e MASHT-it, fëmijët do të detyrohen të mësojnë versionin e 'shtrembëruar' të historisë dhe gjeografisë.<sup>77</sup> Kjo pikëpamje e shton nxitjen për komunitetin serb të Kosovës që të mbajë në jetë ekzistimin e sistemit arsimor paralel. Komunitetet e tjera pakicë siç janë: rom, ashkali, egjiptas dhe goran shqetësim kryesor si me librat shkollor të MASHT-it, ashtu edhe me ato të MASHS-së është lënia tërësisht anash e disa grupeve.<sup>78</sup>

Gjatë viteve janë zhvilluar disa aktivitete dhe projekte të sponsorizuara nga autoritetet komunale, OJQ-të dhe donatorë të tjerë kanë ndihmuar në përmirësimin e arsimit shkollor të pakicave. Kjo përfshin projektet për përkrahje në infrastrukturë, trajnimin lidhur me sigurinë në shkolla, fushatat kundër analfabetizimit, sigurimin e librave shkollor për nxënësit me gjendje të dobët materiale, mësimin në gjuhën amtare dhe organizimin e ngjarjeve multietnike për të forcuar bashkëpunimin ndëretnik.

Është me rëndësi të shtohet se në shumicën e lokacioneve në të cilat në shkolla janë të emëruar nga dy drejtorë si në Lipjan/Lipljan, Pejë/Peç dhe Dragash/Dragaš (njëri i emëruar nga MASHT-i dhe tjetri nga MASHS-ja), drejtorët bashkëpunojnë dhe takohen rregullisht për të diskutuar për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me funksionimin efikas të shkollës.<sup>79</sup>

Diplomat dhe certifikatat e arsimit të shkollave fillore dhe të mesme në kuadër të MASHT-it nuk njihen nga MASHS-ja. MASHS-ja vazhdon që ta mbajë plan-programin e vet për të garantuar që nxënësit serb të Kosovës dhe nxënësit e tjerë pjesëtarë të pakicave nga Kosova të jenë të kualifikuar për të kërkuar çfarëdo niveli të arsimit në Serbi. Po ashtu, mund të thuhet se MASHS-ja refuzon që të pranojë sistemin e MASHT-it, pasi që kjo mund të ketë ndikim në kthimin e serbëve të Kosovës në të ardhmen në Kosovë.<sup>80</sup>

---

klasë për katër lëndët kryesore nga boshnjakishtja në serbisht me disa adoptime, por këto libra as sot e kësaj dite nuk janë përdorur nga nxënësit serb të Kosovës.

<sup>77</sup> Në Rahovec/Orahovac i janë paraqitur shqetësime OSBE-së se udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) përshkruhen si heronj kombëtarë. Në Novobërdë, Drejtori i Arsimit ka shpjeguar se në librat shkollor të MASHT-it shpërfilllet historia e serbëve të Kosovës dhe i përshkruan ata në mënyrë të shtrembëruar.

<sup>78</sup> Në Dragash/Dragaš, goranët i janë ankuar OSBE-së se librat e MASHS-së e portretizojnë popullin e tyre historikisht, fetarisht dhe në literaturë në një dritë negative. Në Ferizaj, komuniteti rom ka ngritur shqetësimin e vet se librat e leximit të klasës së 7-të u referohen atyre në mënyrë poshtëruese si 'magjup'. Përveç referimit të parë, edhe lidhur me pëdorimin e flamurit të shqiptarëve të Kosovës në fillim të shekullit të kaluar, përmendet se romët janë përpjekur që të pengojnë përpjekjet e udhëheqësve shqiptarë të Kosovës për të përdorur flamurin. Kjo çështje i është vënë në dijeni MASHT-it.

<sup>79</sup> Deri në nxjerrjen e direktivës së QKK-së për t'i refuzuar pagat, drejtorët e shkollave nga MASHS-ja e kishin vizituar ndërtesën komunale në Vushtrri/Vučitrn për të diskutuar me Drejtorin Komunal të Arsimit lidhur me çështjet akademike. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, janë tre drejtorë në shkollën 'Sveti Sava' dhe si pikë e vetme e kontaktit për bashkëpunim ndërmjet të treve është bordi i shkollës.

<sup>80</sup> Vazhdojnë të rriten tensionet në fshatrat e të kthyerve në Sigë dhe Brestovik (Komuna e Pejës) në pritje të zgjidhjes se ku do të vijojnë mësimin fëmijët e serbëve të kthyer të Kosovës. Komuna ka ofruar që të përdoren dy dhoma mësimi në shkollën e Brestovikut dhe janë të gatshëm që të lejojnë që fëmijët të përcjellin plan-programin e MASHS-së. Pavarësisht nga përpjekjet e komunës për t'i integruar fëmijët në sistemin e MASHT-it, prindërit serb të Kosovës frikësohen që të jenë të parët që t'i përmbahen plan-programit të MASHT-it për shkak të mosnjohjes së diplomave në Serbi. Është e qartë se politika e komunës për ndarjen e hapësirës do të forconte stimulimin për serbët e Kosovës për t'u kthyer në zonën në periferi të Goraždevac/Gorazhdec it në Pejë. Tani për tani mbetet të zgjidhet

Situata është veçanërisht akute për komunitetin goran në Dragash/Dragaš, pasi që fillimi i vitit shkollor ka qenë i çrregulluar seriozisht për shkak të kontestit mes komunës, arsimtarëve në shkollat paralele, prindërve dhe nxënësve, i shkaktuar nga refuzimi i arsimtarëve goranë që t'i nënshkruajnë kontratat me IPVQ-të.<sup>81</sup>

#### 4.3.1.2 Ndikimi në fëmijë dhe në cilësinë e arsimit

Niveli i mbikëqyrjes së shkollave nga MASHS-ja duket se është i ndryshueshëm sipas rajonit. Në Mitrovicë, sistemi përcillet nga afër pasi që Sekretari Krahinor për Arsim si dhe degët rajonale dhe komunale të MASHS-së janë të vendosura në zonat ku banojnë serbët e Kosovës. Është e qartë se ekzistojnë mekanizmat e drejtpërdrejtë për mbikëqyrje në rajonet e Mitrovicës, Prishtinës/Priština dhe Gjilanit/Gnjilane, ndërsa situata është e ndryshueshme në rajonet e Prizrenit dhe Pejës/Peç.<sup>82</sup>

---

konflikti ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës/Prištinas. Komuniteti i kthyer ia ka përcjellë një kërkesë MASHT-it për të miratuar zyrtarisht përdorimin e dhomave të mësimit, megjithatë, deri më tani Ministria është pajtuar që ta miratojë këtë kërkesë vetëm jozyrtarisht. Shkolla do të konsiderohej si paralele e ndarë e asaj të vendosur në Gorazdevac/Gorazhdec , por drejtori i shkollës nuk mund ta miratojë këtë pa miratimin zyrtar nga Beogradi. Në ndërkohë, tre fëmijë nuk po e vijnë mësimin, ndërsa njërit komuna ia siguron transportin e përditshëm deri në Gorazdevac/Gorazhdec . Është e rëndësishme të ceket se kjo mungesë e qartësisë tanimë ka rezultuar me shkuarjen e gjashtë nxënësve në Serbi dhe Mal të Zi për të vazhduar mësimin. Nëse gjendet ndonjë zgjidhje, ka mundësi që fëmijët të kthehen dhe të tërheqin të kthyer të tjerë. Pas vizitës së Kryesuesit të QKK-së, është dakorduar që fëmijëve t'u lejohet përdorimi i hapësirave të ndara nga komuna. Nxënësit do të duhej të fillonin vijimin e mësimit që në fillim të tetorit 2006, pas identifikimit të një arsimtari.

81 Refuzimi që po vazhdon i arsimtarëve goranë për t'i nënshkruar kontratat me IPVQ-të është çështje politike. Po ashtu, kjo ka të bëjë me reformën arsimore, të cilën MASHT-i dëshiron ta vëjë në përdorim në shkollat gorane. Deri në kohët e fundit, arsimtarët goranë në Dragash/Dragaš, që e zbatojnë plan-programin e Republikës së Serbisë, kanë marrë paga nga Beogradi dhe nga IPVQ-të. Beogradi është përpjekur që të luajë me këtë situatë përmes QKK-së duke i nxitur arsimtarët që të mos i nënshkruajnë kontratat me IPVQ-të për periudhën 2007/2008. Shumica e arsimtarëve i janë përmbytur udhëzimeve të QKK-së, duke marrë parasysh pakon më të mirë të sigurimit social dhe përfitimet financiare nga kontratat e Serbisë. Problemi ka eskaluar në gusht të vitit 2006 kur komuna kishte rishpallur 161 poste për arsimtarë goranë. Situata është përshkallëzuar edhe mëtej për shkak të përpjekjes së vazhdueshme të Drejtorisë Komunale të Arsimit për ta zbatuar vendimin. Arsimtarët të cilët nuk i kanë nënshkruar kontratat nuk lejohen që të japin mësim në shumicën e shkollave. Komuna ka lëshuar një komunikatë e cila thekson se do të respektohen të drejtat e pakicave për arsimim duke i ftuar njëkohësisht prindërit që të mos i lejojnë arsimtarët që t'i shfrytëzojnë fëmijët e tyre si instrument politik. Prindërit vazhdojnë të këmbëngulin se arsimtarët e rekrutuar rishitazi nuk janë të kualifikuar dhe insistojnë që arsimtarëve të mëparshëm t'u mundësohet t'i mësojnë fëmijët e tyre në gjuhën serbe, përndryshe planifikojnë që t'i bojkotojnë shkollat. Më 25 tetor, shumica e shkollave fillore në Gorë kanë qenë të hapura dhe kanë funksionuar, prapëseprapë situata ka qenë larg nga normale. Nxënësit e shkollës së përzier fillore në qytezën e Dragash/Dragašit kanë vazhduar bojkotimin e procesit arsimor. Shumica e nxënësve në shkollën fillore në Restelicë nga 650 nxënës të regjistruar vetëm 163 kanë vijuar mësimin, mirëpo disa prej tyre janë duke i ndjekur për momentin mësimet në kuadër të sistemit të MASHT-it. Edhe pse shkolla në Radeshë ishte hapur, nuk kishte kishte nxënës që ndjeknin mësimet si shenjë e protestës ndaj veprimit komunal të zëvendësimit të mësimdhënësve të vjetër me të rinjë. Shkolla fillore në Kukjan ka mbetur e mbyllur edhe pse Drejtoria Komunale e Arsimit kishte premtuar që ta hapë sërish atë. Megjithëse shkolla në Radeshë ishte hapur, në shenjë të protestës kundër veprimit të komunës për të zëvendësuar mësuesit e vjetër me ata të rinj nuk ka nxënës që kanë vijuar mësimin. Shkollat në Rapqë, Brod dhe Vranishtë kanë vazhduar të funksionojnë me personelin e mëparshëm i cili refuzon nënshkrimin e kontratave.

<sup>82</sup> Në Gjilan – koordinatori i MASHS-së dhe inspektorët e arsimit mbajnë mbledhje koordinuese mujore me drejtorët dhe arsimtarët e shkollave përmes zyrës së koordinatorit të arsimit në Ranillug, ndërsa në Shtërpçë, inspektorët bëjnë vizita një herë në dy muaj për të shqyrtuar kryerjen e punës së drejtorëve dhe të personelit, si dhe çështjet administrative dhe financiare. Shkollat e rajonit të Pejës i

Cilësia e mësimdhënies/marrjes duket se është e ndryshueshme në mbarë Kosovën. Në disa komuna, cilësia është mjaft e lartë pasi që numri i nxënësve serb të Kosovës është i vogël prandaj ka përqëndrim më të madh në nevojat individuale të nxënësve, kurse në lokacionet e tjera, numri i vogël i nxënësve ka çuar në bashkimin e nxënësve të niveleve të ndryshme të aftësive në një të vetme. Ekzistimi i hendekut ndërmjet të dy sistemeve arsimore në mënyrë të paevitueshme ka shpërthyer dhe vazhdon të shpiejë në pabarazi, nivele të ndryshme dhe në shpejtësinë e zhvillimit të komuniteteve të ndryshme pakicë. Për shembull, nxënësit pjesëtare të pakicës të cilët e vijnë në mësim sipas sistemit të MASHT-it mund të ndikohen negativisht nga rregulloret mbi relacionin arsimtar/nxënës.<sup>83</sup>

Niveli i trajnimit të personelit arsimor ndikon gjithashtu në cilësinë e arsimit që ofrohet. Megjithatë, MASHS-ja i ka kushtuar vëmendje më të madhe të asaj që arsimtarët serb të Kosovës të kenë kualifikime dhe trajnime adekuata para se të fillojnë punën, ende ka raste si në Viti ku një përqindje e madhe e arsimtarëve nuk janë trajnuar e as nuk janë të kualifikuar për t'i kryer funksionet e tyre në mënyrë adekuata. Kjo ka ndodhur për shkak se ata kanë punuar në Kosovë që nga viti 1999 dhe drejtorët e tyre të shkollave, në vend se t'i shpallin postet e tyre për t'u plotësuar nga personeli më i kualifikuar, i trajtojnë postet e tyre si shpërblim për lojalitetin e tyre. Trajnimi i vazhdueshëm profesional ofrohet nga MASHT-i për të gjithë arsimtarët, megjithatë, trajnimet e organizuara nga MASHS-ja në Kosovë dhe në Serbi nuk duket se janë në dispozicion për të gjithë personelin në mbarë Kosovën ose ka nivel të dobët të interesimit të arsimtarëve për t'i vijuar aktivitetet e tilla.<sup>84</sup>

---

mbajnë kontaktet përmes mekanizmave të raportimit. Megjithatë, nuk ka kontroll të drejtpërdrejtë si në rajonet e tjera, drejtorët e shkollave gjithnjë i drejtohen Beogradit për përkrahje pavarësisht nga sigurimi i rregullt me furnizime nga komunat siç janë drutë për ngrohje dhe pastrimi i lokaleve. Në Mitrovicë – përfaqësuesit e MASHS-së punojnë nga afër me Drejtorin e Departamentit për Arsim, Rini dhe Sport të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Mitrovicë (AKBM) mbi plan-programin dhe çështjet financiare. Në Leposavić/Leposaviq, zyra rajonale e MASHS-së dhe koordinatori për arsim i QKK-së luajnë role të rëndësishme duke shërbyer shpesh si lidhje ndërmjet shkollave dhe organizatave të tjera. Në Prizren – përfaqësuesi i QKK-së pohon se vizita e parë e MASHS-së në Komunën e Rahovec/Orahovacit është zhvilluar vetëm në qershor 2006, përndryshe nuk ka mbikëqyrje tjetër të drejtpërdrejtë nga MASHS-ja përveç nxjerrjes së plan-programit dhe politikave të punësimit/largimit. Ekziston një zyrë e MASHS-së e vendosur në veri të Mitrovicës ku personeli arsimor mund të marrë pjesë në mbledhje dhe të marrë udhëzime të drejtpërdrejta; përndryshe personeli njoftohet për ndryshime të tjera përmes internetit.

<sup>83</sup> Në Pejë, komuna e ka miratuar mësimin në gjuhën boshnjake megjithatë, në disa klasë numri i nxënësve bie nën kufirin minimal prej 14.2 nxënës pjesëtarë të pakicave sipas formulës së përcaktuar nga Banka Botërore. Drejtori Komunal i Arsimit planifikon që të zbatojë këtë formulë në përputhje me Qarkoren Buxhetore të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave (MEF) nr. 2007/2, të datës 26 maj 2006, e cila përcakton se si fondet e granteve komunale për arsim jepen për secilën komunë. Rrjedhimisht, shumica në dispozicion e fondit komunal për pagat e arsimtarëve është e kufizuar. Kjo do të vënte në rrezik mundësinë që këta fëmijë të ushtrorin të drejtën për arsimim në pikëpamjen e qasjes në arsimim në gjuhën e tyre amtare. Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/15 që e ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/09 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Shtojca IV, MASHT-i duhet të promovojë sistemin arsimor jodiskriminues në të cilin respektohet e drejta e secilit person për arsimim dhe mundësitë e mësimi cilësor të jenë gjithashtu në dispozicion dhe që mundëson zhvillimin dhe përmirësimin cilësor të sistemit arsimor, si dhe ofrojnë shërbime arsimore efikase.

<sup>84</sup> MASHT-i organizon trajnime mbi metodat e rëndësishme të mësimdhënies si dhe seminare të tjera. MASHS-ja organizon trajnime mbi mësimin aktiv dhe seminare të tjera të cilat kanë për qëllim përmirësimin e shkathtësive të mësimdhënies. Sipas Doracakut të MASHT-it mbi Arsimin në Komuna pjesa 1, faqe 24 “Është detyrë e Drejtorisë Komunale të Arsimit që të identifikojë personelin që ka nevojë për trajnim administrativ dhe/ose teknik. Ky personel duhet të marrë pjesë në kurset e trajnimit

Pa një gjuhë të përbashkët ose së paku pa një formë të pajtimit ndërmjet të dy sistemeve arsimore, nxënësit do të vazhdojnë të ndikohen negativisht nga kjo ndarje. Për më tepër, të drejtat e fëmijëve për arsimim shpesh vihen nën hije nga debatet e vazhdueshme ndërmjet autoriteteve dhe prindërve lidhur me çështjet e përmendura më lartë. Rezultati përfundimtar është rrezikimi i mundësisë së fëmijëve që të ushtrojnë të drejtën e tyre për arsimim pasi që ata janë zënë shpesh në një betejë të vazhdueshme politike ndërmjet grupeve etnike. Mungesa e një qasje gjithëpërfshirëse ndaj çështjes së arsimit të pakicave vazhdon të ndikojë negativisht në komunitetet numerikisht më të vogla siç janë ato boshnjake dhe turke. Për më tepër, nevojat e veçanta të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas ende nuk janë trajtuar në mënyrë konsekuente, ndërsa reformat arsimore që janë në vazhdim e sipër, kanë krijuar pengesa të reja për nxënësit goran që t'i qasen arsimit. Aktualisht, brenda sistemeve arsimore ekziston mungesa e ndërveprimit mes komuniteteve çka po e thellon ndarjen e shoqërisë kosovare dhe i detyron individët që të jetojnë vetëm brenda komuniteteve të tyre përkatëse.

#### 4.4 Arsimi terciar

Serbët e Kosovës që banojnë në Kosovë mbeten shumë të varur në sistemin shtetëror të Serbisë në ofrimin e arsimit terciar. Ndërsa Universiteti paralel i Prishtinës/Priština i zhvendosur në Mitrovicë është institucioni më i rëndësishëm në këtë pikëpamje, në Kosovë vepron edhe një numër i vogël i universiteteve private

Sa i përket Universitetit paralel të Prishtinës/Priština, studentët e regjistruar në të përgjithësisht shpërngulen në Mitrovicë/Mitrovica për të jetuar dhe studiuar. Ky Universitet në masë të madhe është i vetëqëndrueshëm: mësimdhënësit, provimet dhe aktivitetet jashtë programore zhvillohen brenda kompleksit, megjithëse një numër i personelit mësimdhënës (shumë nga të zhvendosur nga Kosova) që tani jetojnë në Serbi. Po ashtu, Universiteti vepron me disa fakultete në vende të tjera të Kosovës, përfshirë Fakultetin Filozofik në Gračanica/Graçanicë.

Përveç kësaj, ekziston Qendra Konsultuese e një fakulteti privat nga Novi Sadi ("Fakultet za Usluzni Biznis") që vepron në Shtërpçë. Është hapur në tetor të vitit 2002 në kompleksin e shkollës së mesme të Štrpce/Shtërpçë . Ky fakultet ofron studime në fushën e menaxhimit të biznesit, ekonomi, turizëm dhe menaxhim publik.

Gjenerata e parë e studentëve (rreth 40) ka diplomuar në vitin e kaluar, aktualisht janë të regjistruar rreth 20 studentë. Mësimdhënësit jetojnë në atë lokalitet, ndonëse fakulteti vizitohet rregullisht nga personeli i kompleksit nga Novi Sadi. Provimet mbahen në Štrpce/Shtërpçë dhe në Novi Sad, ndërsa të gjitha provimet me shkrim përgatiten në Novi Sad.

---

që ofrohen ose nga Ministria ose nga një apo disa komuna. Personeli arsimor është i obliguar që të marrë pjesë në këto kurse dhe është përgjegjësi e Drejtorisë Komunale të Arsimit të sigurojë pjesëmarrjen", Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2002/2 mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, neni 32.2, "Nga të gjithë arsimtarët duhet të kërkohet të ndërmarrin ritrajnime dhe zhvillim përkatës profesional kur kjo kërkohet nga MASHT-i."

## 5. KUJDESI SHËNDETËSOR PARALEL

### 5.1. Strukturat

Në tetor të vitit 2003, OSBE-ja ka identifikuar një numër të strukturave paralele të shëndetësisë brenda Kosovës.<sup>85</sup> Ky vlerësim do të tregojë se situata në komuna nuk ka pësuar ndryshime qenësore gjatë tri viteve të fundit.

Entet paralele të kujdesit shëndetësor gjenden në mbarë Kosovën, kryesisht në rajonet e Mitrovicës/Mitrovica, Prishtinës/Priština dhe Gjilanit/Gnjilane. Ente shëndetësore paralele në shkallë më të ulët ekzistojnë edhe në rajonet e Prizrenit dhe Pejës/Peç. Në Kosovën veriore këto ente duket se janë ofruesit e vetëm të kujdesit shëndetësor për pjesëtarët e komuniteteve pakicë. Shumica por jo të gjitha nga këto ente ofrojnë kujdes shëndetësor primar, me disa përjashtime.<sup>86</sup>

Në veri të Kosovës, entet paralele të kujdesit shëndetësor veprojnë në të gjitha komunat dhe përbëjnë shumicën e enteve të kujdesit shëndetësor që janë në dispozicion të popullatës. Një spital, pesë shtëpi të shëndetit dhe 16 klinika janë identifikuar se i takojnë strukturës shëndetësore paralele në Kosovën veriore. Në komunat e Zubin Potokut, Leposavić/Leposavić/Leposaviqit dhe Zvečan/Zveçanit shumica e enteve të kujdesit shëndetësor janë paralele, me përjashtim të enteve që udhëhiqen nga Ministria e Shëndetësisë (MSH).<sup>87</sup>

Në rajonin e Prishtinës/Priština, ekziston një spital paralel me disa degë të specializuara në lokacione të ndryshme, dy shtëpi të shëndetit dhe 15 klinika.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, ekzistojnë gjithsej 39 objekte paralele të kujdesit shëndetësor, kryesisht në komunat Shtërpçë, Gjilan dhe Kamenicë.

Dy komunat e vetme në rajonin e Prizrenit ku veprojnë strukturat shëndetësore paralele janë Rahovec/Orahovaci (Rahovec i Epërm /Orahovaci dhe Velika Hoca/Hoça e Madhe) dhe në Prizren (Sredska/Sreckë dhe Mushnikovë/Mušnikovo me shtëpitë e shëndetit të cilat menaxhohen nga shtëpia e shëndetit në Shtërpçë).

Në rajonin e Pejës janë identifikuar katër klinika dhe një shtëpi private si objektet e vetme të kujdesit shëndetësor paralel.

---

<sup>85</sup>Shih Shtojcën II të bashkangjitur për listën e plotë të enteve paralele të kujdesit shëndetësor në Kosovë.

<sup>86</sup>Disa nga përjashtimet janë spitali në veri të Mitrovicës; Qendra Klinike Spitalore e Prishtinës/Priština, që ka ente të ndryshme të specializuara të vendosura në Gračanica/Graçanicë dhe Llapnasellë; shtëpia e shëndetit në Gushtericë të Ulët (ofron shërbime të kujdesit shëndetësor primar dhe sekondar); spitali intern-pediatrik “Dr Josif Vasić” në Shillovë, rajoni i Gjilanit/Gnjilane; dhe shtëpia e shëndetit në qytezën e Štrpce/Shtërpçë (që ofron disa shërbime të kujdesit shëndetësor sekondar siç janë shërbimet ortopedike dhe operacione të vogla).

<sup>87</sup>Disa përjashtime si klinikat e siguruar nga MSH-ja, në fshatrat Koshtovë (Komuna e Leposavić/Leposavić/Leposaviqit), Lipë (Komuna e Zvečan/Zveçanit), Çabër (Komuna e Zubin Potokut). Këto ente shfrytëzohen ekskluzivisht nga pakica shqiptare e Kosovës në Kosovën veriore, kurse serbët dhe boshnjakët e Kosovës përdorin strukturën paralele të kujdesit shëndetësor. Sa i përket kujdesit shëndetësor sekondar, shqiptarët e Kosovës drejtohen në spitalin e Mitrovicës jugore.

## 5.2. Shkaqet dhe efektet e strukturave paralele

OSBE-ja po vazhdon të identifikojë pengesat që ekzistojnë në Kosovë dhe në Serbi që e vështirësojnë integrimin e strukturave paralele të kujdesit shëndetësor në një sistem të unifikuar të kujdesit shëndetësor në Kosovë. Duhet të ceket që ka pasur pak ose nuk ka pasur fare ndryshime në tri vitet e kaluara për të zgjidhur çështjen e strukturave paralele të shëndetësisë.

### 5.2.1. Shkaqet e strukturave paralele të kujdesit shëndetësor

#### 5.2.1.1. Qëndrimet në mesin e komunitetit serb të Kosovës dhe komunitetit shqiptar të Kosovës dhe mungesa e dialogut në nivelin qendror

Serbët e Kosovës përmendin shqetësimet për sigurinë si një nga faktorët që i bënë ata të preferojnë përdorimin e enteve të kujdesit shëndetësor në enklavat e tyre dhe në Kosovën veriore. Përveç kësaj, në mesin e serbëve të Kosovës ende është i rrënjosur thellë perceptimi se profesionistët shqiptar të Kosovës mund të mos e kenë nivelin e njëjtë të aftësive profesionale si profesionistët mjekësorë serb të Kosovës.<sup>88</sup> Popullata shqiptare e Kosovës i shfrytëzon ekskluzivisht entet e kujdesit shëndetësor të udhëhequra nga MSH-ja.

Është thelbësore të përmendet që ideja se komuniteti mund të shërbehet vetëm nga pjesëtarët e komunitetit të vet është e ngulitur si në perceptimet e serbëve të Kosovës, ashtu edhe në ato të shqiptarëve të Kosovës. Segregacioni i përgjithshëm i shoqërisë së Kosovës rrjedhimisht shpie në segregacion në kuptimin e kërkitimit dhe të ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

OSBE-ja ka vërejtur se përgjithësisht, në strukturat e udhëhequra nga IPVQ-të nuk ka probleme komunikimi ndërmjet personelit mjekësor dhe pacientëve të komuniteteve pakicë, pasi që mjekët dhe infermieret zakonisht e flasin gjuhën serbe. Megjithatë, gjuha nuk respektohet plotësisht në disa shenja që janë të vendosura vetëm në gjuhën shqipe në entet e kujdesit shëndetësor.

---

<sup>88</sup> Për shembull, në Komunën e Podujevës jetojnë vetëm 21 serb të Kosovës në një fshat të vogël, të largët dhe gjeografikisht të izoluar të Sekiraqës, rreth një orë udhëtim nga Orllani. Këta serb të Kosovës i pranojnë shërbimet e kujdesit shëndetësor nga shtëpia e shëndetit në Orllan ku punon një mjek në baza të përhershme. Me kërkesë të tyre, personeli i shtëpisë së shëndetit bën vizita familjare në koordinim me KFOR-in. Recetat jepen në gjuhën serbe dhe personeli shëndetësor flet në gjuhën serbe. Sipas Drejtorit të Shëndetësisë, kujdesi shëndetësor për komunitetet serbe, rom, ashkali dhe egjiptas të Kosovës është i kënaqshëm. Instrumentet e nevojshme janë në dispozicion. Pavarësisht nga mungesa e përgjithshme e personelit, shërbimet komunale pohohet se janë në dispozicion të të gjitha komuniteteve. Megjithatë, për shkak të lokacionit të largët të fshatit të vogël serb, rreth dy orë udhëtim nga qyteza e Podujevës, por vetëm 500 metra nga Serbia, këta serb të Kosovës mund të preferojnë – veçanërisht në rastet urgjente – të vizitojnë shtëpitë e shëndetit në Serbi. Një shembull tjetër është rajoni i Pejës ku serbët e Kosovës preferojnë të mos shkojnë në spitalin e Pejës dhe do ta bënë këtë vetëm në situata urgjente (disa nuk do të shkonin as në situata të tilla). Në vend të kësaj ata do të vizitonin spitalet në Kosovë që udhëhiqen nga serbët e Kosovës.



Në tri vitet e kaluara, autoritetet komunale të kujdesit shëndetësor nuk kanë parashtruar asnjë strategji ose plan veprimi i cili do të ofronte hapat drejt integritit të strukturave paralele në sistemin e unifikuar të kujdesit shëndetësor. Disa përpjekje të izoluara kanë dështuar në veçanti në Štrpce/Shtërpçës ku Departamenti i Administratës Civile (DAC) në vitin 2004 i kishte bërë disa përpjekje për të organizuar takime ndërmjet mjekëve serb të Kosovës me mjekët shqiptar të Kosovës në mënyrë që të kërkohet një zgjidhje për ri-integrim në strukturat e MSH-së por asnjëri nuk është dëshmuar si i suksesshëm.

Megjithatë, ekzistojnë disa përjashtime në nivelin lokal që janë tregues të përparimit drejt integritit. Klinika në fshatin Drajkovce/Drajkofc (Komuna e Štrpce/Shtërpçës ) herë pas here përdoret nga serbët e Kosovës për të marrë shërbime mjekësore nga mjekët që paguhen nga MSH-ja. Ka raste edhe më të shpeshta kur shqiptarët e Kosovës shfrytëzojnë shërbimet mjekësore në shtëpinë e shëndetit në Shtërpçë e cila vepron plotësisht nën MSSH-në. Sipas Zëvendës Drejtorit të Departamentit Komunal të Shëndetësisë në Štrpce/Shtërpçë, të gjithë pacientët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë.

Në përgjithësi, janë ndërmarrë disa masa proaktive për të shtrirë ndihmën për serbët e Kosovës, për t'i tejkaluar perceptimet dhe frikën e tyre. Megjithatë, në nivelin komunal Rahovec/Orahovaci është një shembull pozitiv me Planin e vet Gjashtëmujor të Integritit,<sup>89</sup> komuna ka lansuar një sërë aktivitete duke i pikësnyuar komunitetet pakicë për të inkurajuar integrimin e tyre në sistemin komunal. Drejtori i Departamentit të Shëndetësisë dhe Drejtori i Qendrës së Kujdesit Shëndetësor Primar kanë zhvilluar aktivitete kontaktuese në zonat ku jetojnë pakicat dhe kanë inkurajuar popullatën lokale që të shfrytëzojnë entet në qendër. Gjer më sot, ata i kanë vënë në dispozicion automjetet e klinikave të MSH-së si dhe shoferët nga radhët e pakicave për ata që ngurrojnë të kërkojnë shërbimet duke i përdorur automjetet e tyre private. Prandaj, në mënyrë që të shmangen udhëtimet e gjata deri në komunat veriore, serbët e Kosovës nga Rahoveci/Orahovac herë pas here e përdorin shtëpinë e shëndetit në qendër e cila është e banuar nga shumica. Është vërejtur se në periudhën qershor-gusht 2006, është rritur shfrytëzimi i enteve të udhëhequra nga IPVQ-të nga komunitetet pakicë.

Në të vërtetë, komuna e Rahovecit/Orahovac me Departamentin e saj Komunal të Shëndetësisë është jashtëzakonisht proaktive, duke punuar vazhdimisht me personelin mjekësor në zonat serbe të Kosovës në mënyrë që të zvogëlohet nevoja për të shfrytëzuar entet në Kosovën veriore. Përveç kësaj, mbahen mbledhje koordinuese mujore ndërmjet personelit mjekësor të MSH-së dhe të MSSH-së dhe ato po vazhdojnë megjithëse serbët e Kosovës i kanë refuzuar pagat e tyre nga IPVQ-të.

#### 5.2.1.2. Mungesa e dialogut në nivelin qendror

Shembujt e lartpërmendur janë më shumë përjashtime, sesa rregull. Për më tepër, ato nuk mbështeten nga asnjë përpjekje sistematike për të zgjidhur problemet në nivelin

---

<sup>89</sup> Plani Gjashtëmujor i Integritit mund të shihet si një projekt krahas aktiviteteve të tjera të kontaktimit me popullatën nga drejtoritë e tjera komunale dhe përfshin një qasje të përmirësuar ndaj enteve shëndetësore. Komuna duhet të vazhdojë inkurajimin e popullatës lokale pakicë që të shfrytëzojë strukturat e IPVQ-ve.

qendror. OSBE-ja është e brengosur se në vitet e kaluara, nuk është zhvilluar kurrfarë dialogu ndërmjet MSH-së dhe MSSH-së, rrjedhimisht nuk është arritur asnjë marrëveshje për të konsoliduar sistemet paralele të kujdesit shëndetësor. Në veçanti, kjo mungesë absolute e bashkëpunimit në nivelin qendror është për të ardhur keq, pasi që qasja e duhur ndaj kujdesit shëndetësor është nevojë themelore e të gjitha komuniteteve dhe do të duhej të mbetej mbi konsideratat politike.

Sa i përket rajonit thellësisht të ndarë të Mitrovicës, sipas bashkëbiseduesve veriorë nuk ka pasur asnjë diskutim ndërmjet MSSH-së dhe MSH-së lidhur me atë se si të konsolidohen strukturat paralele në nivelin rajonal ose komunal. Megjithatë, sipas bashkëbiseduesve jugore, janë zhvilluar dy takime joformale me ndërmjetësim të KFOR-it. Po ashtu, me rastin e përirimit të Qendrës së Dializës nga MSH-ja, atyre që përfaqësojnë sistemin e kujdesit shëndetësor në veri u është dërguar një njoftim me shkrim dhe një ftesë për bashkëpunim. Serbët e Kosovës nuk janë përgjigjur.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, ka pasur një përpjekje për dialog përkitazi me shfrytëzimin e përbashkët të spitalit të Bresjes në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, i cili është rindërtuar pas shkatërrimit të tij në trazirat e marsit 2004. Megjithatë, ky dialog ka ngecur për shkak të refuzimit nga strukturat paralele të kërkesës për të punësuar një përqindje të caktuar të mjekëve dhe personelit mjekësor shqiptar të Kosovës. Kohëve të fundit është bërë një ofertë e re nga kryetari i Kuvendit Komunal (KKK-ja) për personelin e shtëpisë së shëndetit që të fillojnë të shfrytëzojnë ndërtesën e rindërtuar pa ndryshime të menjëhershme të personelit të tyre, me kusht që ata të zotohen për të punësuar në një datë të mëvonshme një numër të personelit shqiptar të Kosovës. KKK-ja ende nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Ndarja e thellë në mes të dy sistemeve po vazhdon, ndërkaq përpjekjet për të arritur një kompromis deri më tani janë sporadike dhe të pasuksesshme. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, përfaqësuesit e IPVQ-ve kanë marrë pjesë në bisedime për radion në Ranilug/Ranillug dhe në emisionet televizive në Silovo/Shillovë për të ngritur vetëdijen përkitazi me rëndësinë e bashkimit të strukturave të kujdesit shëndetësor. Fatkeqësisht, këto tentime nuk ishin të suksesshme për shkak të mosgatishmërisë së Beogradit për t'u përfshirë në dialog. OSBE-ja vëren se sipas përfaqësuesit të MSSH-së në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, prioritet aktual i MSSH-së është ngritja e strukturave paralele të enteve shëndetësore sekondare (që nuk ekzistojnë në atë rajon), aktualisht janë në dispozicion vetëm në Vranjë/Vranje, Gračanica/Graçanicë dhe Mitrovicë/Mitrovica. Ky plan do të përforcojë sistemin paralel dhe do ta bëjë ri-integrimin më sfidues.

#### 5.2.1.3. Refuzimi i kohëve të fundit i pagave të IPVQ-ve nga serbët e Kosovës

Situatat e kompensimit të dyfishtë, nga IPVQ-të dhe nga Beogradi, kanë ekzistuar në Kosovë që nga përfundimi i konfliktit. Pas nxjerrjes së direktivës së Qendrës Koordinuese për Kosovë (QKK) në dhjetor 2005, shumica dërmuese e të punësuarëve serb të Kosovës që kishin vendosur marrëdhënie pune me IPVQ-të i kanë refuzuar

pagat e tyre nga IPVQ-të<sup>90</sup> në favor të kompensimeve paralele nga Republika e Serbisë.

Në sektorët e kujdesit shëndetësor primar dhe në arsimin fillor dhe të mesëm, autoritetet kompetente komunale është dashur që t'i ndërprejnë pagesat e pagave për punëtorët e angazhuar të IPVQ-ve. Këto pagesa mbulohen nga grantet qendrore që u ndahen komunave si pjesë e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK). Siç duket QKK-ja e ka zbatuar direktivën e vet përmes vizitave në terren, gjatë të cilave nga punëtorët e angazhuar serb të Kosovës është kërkuar që të paraqesin dëshmi se e kanë ndërprerë marrjen e pagave nga IPVQ-të, si kusht për vazhdimin e marrjes së pagave nga Republika e Serbisë.

OSBE-ja është e brengosur se në disa komuna mund të ushtrohet një shkallë e caktuar e presionit mbi profesionistët mjekësorë serb të Kosovës që t'i refuzojë pagat e IPVQ-ve. Sipas informatave të OSBE-së,<sup>91</sup> Drejtorit të Divizionit për të Drejtat e Pakicave dhe Monitorim Gjinor të MSH-së kohëve të fundit i janë afruar tre pjesëtare të komunitetit serb që punojnë si infermiere në qendrën e mjeksësisë familjare në Gushtericë të Ulët (Komuna e Lipjanit/Lipljane) u kanë kërkuar këshilla lidhur me përfshirjen e tyre të sërishme në listën komunale të pagave.<sup>92</sup>

Me disa përjashtime, refuzimi i pagave në tërë Kosovën nuk ka shkaktuar ndryshime të dukshme në cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor që ofrohen nga secili ent i kujdesit shëndetësor.<sup>93</sup>

Në veri të Kosovës, mjekët, infermieret dhe punëtorët e kujdesit shëndetësor marrin vetëm pagat nga MSSH-ja.<sup>94</sup> Pohohet se IPVQ-të kanë një buxhet të veçantë për entet shëndetësore të serbëve të Kosovës.<sup>95</sup> Rrjedhimisht, direktiva e QKK-së mbi refuzimin e pagave nuk ka pasur ndikim në personelin e sektorit të kujdesit shëndetësor në Kosovën veriore, pasi që ai vepron tërësisht i pavarur nga IPVQ-të. Të gjithë të punësuarit që punojnë në kujdesin shëndetësor paguhet nga MSSH-ja dhe i kanë refuzuar pagat nga MSH-ja që nga fillimi i administrimit ndërkombëtar në Kosovë. Edhe punëtorët e kujdesit shëndetësor që janë serb të Kosovës në

---

<sup>90</sup> Pagat e IPVQ-ve sillen nga 200 deri në 280 euro në muaj në varësi të llojeve të ndryshme të kontratave dhe në bazë të kualifikimeve dhe të përshkrimit të punës (mjekët e mjeksësisë së përgjithshme dhe të specializuar, infermieret dhe administrata shëndetësore). Paga mesatare që u paguhet mjekëve specialistë nga MSH-ja është 250 euro në muaj (sipas të dhënave nga Qendra Rajonale (QR) në Mitrovicë e Misionit të OSBE-së në Kosovë); 234 euro në muaj (të dhënat nga QR-ja në Gjilan); sillen nga 200 deri në 280 euro në muaj (të dhënat nga QR-ja në Prizren); 273 euro në muaj (të dhënat nga QR-ja në Pejë).

<sup>91</sup> Informata nga Koordinator i Njesisë së të Drejtave të Njeriut në MSH/IPVQ, shih Raportin Javor të Njesisë Qendrore Këshillëdhënëse për të Drejtat e Njeriut të OSBE-së - Periudha e raportimit përfshin periudhën 26 gusht – 8 shtator 2006.

<sup>92</sup> Me sa duket zyrtari i përfshirë i ka këshilluar infermieret që të kontaktojnë drejtpërdrejtë me Ministrinë e Financave.

<sup>93</sup> Në Viti, i tërë personeli mjekësor serb i Kosovës (20) pohohet se i kanë refuzuar pagat e tyre nga IPVQ-të. Refuzimi i kontratave me IPVQ-të nuk shpie vetëm në humbjen e pagave të IPVQ-ve por gjithashtu edhe në mungesën e barërave, pasi që siç duket, strukturat e kujdesit shëndetësor të MSH-së i furnizojnë shtëpitë e shëndetit me barëra dhe sigurojnë forma të tjera të përkrahjes.

<sup>94</sup> Me përjashtim të një punëtojeje, e cila është në listën e pagave të IPVQ-ve dhe ofron shërbime të kujdesit shëndetësor pjesëtarëve të komunitetit rome.

<sup>95</sup> Për shembull, pohohet se në vitin e kaluar është blerë një autoambulancë enkas për spitalin e Mitrovicës veriore.

Vushtrri/Vučitrn dhe Skenderaj/Srbica /Srbica asnjëherë nuk kanë qenë në listën e pagave të IPVQ-ve.

Sipas përfaqësuesit të MSSH-së dhe burimeve komunale, në rajonin e Prishtinës/Priština që nga fillimi i vitit 2006 nuk ka asnjë të punësuar në strukturat e kujdesit shëndetësor që merr pagë nga IPVQ-të.<sup>96</sup>

Në Lipjan/Lipljan, i tërë personeli serb i Kosovës që punon në sektorin e kujdesit shëndetësor i është përmbajtur direktivës së QKK-së të lëshuar në dhjetor të vitit 2005 dhe zyrtarisht i kanë refuzuar pagat e tyre nga IPVQ-të, me përjashtim të tre anëtarëve të personelit.<sup>97</sup> Që nga viti 2002, numri i serbëve të Kosovës që punojnë në këtë sektor është zvogëluar nga 291 në 82 në vitin 2005. Arsyeja zyrtare për një zvogëlim të tillë e dhënë nga komuna, është se kanë personel të tepërt dhe se numri i mjekëve duhet të jetë në proporcion me numrin e popullatës. Në janar 2006, rreth një muaj pas nxjerrjes së direktivës së QKK-së, në listën komunale të pagave kanë qenë gjithsej 78 anëtarë të personelit. Aktualisht, vetëm tre punëtorë serb të Kosovës janë zyrtarisht në listën komunale të pagave. Megjithatë, jozyrtarisht numri i serbëve të Kosovës në organet komunale është përafërsisht 20. Këta 20 serb të Kosovës që punojnë në strukturat paralele të kujdesit shëndetësor i kanë mbyllur xhirollogaritë e tyre të mëparshme bankare dhe kanë hapur xhirollogari të reja, dhe ende vazhdojnë të marrin paga të dyfishta, një pagë nga komuna dhe një pagë nga MSSH-ja. Sipas Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, mjetet e mbetura financiare për serbët e Kosovës të cilët i kanë refuzuar pagat e tyre janë grumbulluar në një fond të veçantë. Nuk ka raste të raportuara ose të njohura që ndokush ka mbetur pa pagë.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, situata ndryshon nga një komunë në tjetrën, me një trend të përgjithshëm ku shumica e personelit shëndetësor serb të Kosovës i kanë refuzuar kontratat e tyre me IPVQ-të, por ende vazhdojnë të punojnë në postet e njëjta. Në Gjilan/Gnjilane, 161 punëtorë serb të Kosovës i kanë refuzuar pagat nga komuna pasi që janë udhëzuar nga QKK-ja që të zgjedhin mes dy punëdhënësve. Asnjëri nuk ka mbetur pa pagë. Janë 35 infermiere serbe të Kosovës të cilat ende janë në listën komunale të pagave pasi që ato kurrë nuk kanë marrë paga nga MSSH-ja. Në Novobërdë, të nëntë punëtorët që punojnë në ente paralele i kanë refuzuar pagat e tyre nga IPVQ-të; asnjëri nuk e ka refuzuar vendin e tij të punës. Në Kamenicë, deri më tani i kanë refuzuar pagat e tyre 47 punëtorë serb të Kosovës. Pavarësisht nga kjo, pagat e tyre ende po transferohen në xhirollogaritë e tyre bankare (ka deklaruar drejtori i një shtëpie të shëndetit, në bazë të listës së pagave të marrë nga banka). Në Shtërpçë, deri më 15 shkurt 2004, në listën e pagave të BKK-së kanë qenë 114 punëtorë serb të Kosovës. Pas kërkesës së MSH-së për zvogëlim të numrit në 66 punëtorë, menaxhmenti i qendrës shëndetësore e ka konsideruar këtë si të papranueshme për shkak të numrit të madh të të zhvendosurve të punësuar në strukturat shëndetësore të Štrpce/Shtërpçës . Si rezultat, të gjithë punëtorët serb të Kosovës janë marrë vesh që të refuzojnë pagat e MSH-së/IPVQ-ve. Prandaj, në kohën

---

<sup>96</sup> Së paku në një komunë (në Fushë Kosovë/Kosovo Polje) ka të punësuar serb të Kosovës (një mjek, disa infermiere dhe personeli ndihmës – gjithsej 19 punëtorë serb të Kosovës) që punojnë në institucionet e rregullta të kujdesit primar shëndetësor të IPVQ-ve. Sipas tyre, pagat që ata i marrin nga IPVQ-të nuk kanë ndikim në pagat tjera që i marrin nga Qeveria Serbe. Megjithatë, këto pagesa janë ndalur pasi ata nuk i kanë refuzuar pagat nga IPVQ-të.

<sup>97</sup> Aktualisht, ata janë në listën komunale të pagave dhe nuk marrin paga nga MSSH-ja – 1 nga qyteza e Lipjanit/Lipljan dhe 2 nga Rubovci.

kur është marrë direktiva e QKK-së, nuk ka pasur punëtorë serb të Kosovës në listën e pagave të MSH-së.

Sa i përket Prizrenit, i gjithë personeli i strukturave shëndetësore (gjithsej pesë persona) i marrin pagat nga MSSH-ja dhe kurrë nuk kanë qenë të përfshirë në skemën e pagave të IPVQ-ve. Në anën tjetër, situata në Rahovec/Orahovac është më komplekse. Para lëshimit të direktivës të QKK-së, nga 15 punëtorë serb të Kosovës të punësuar në strukturat paralele, 11 kanë qenë të përfshirë në skemën e pagave të IPVQ-ve, ndërsa katër të tjerët kanë marrë paga nga MSSH-ja. Në përputhje me direktivën e QKK-së të lëshuar në dhjetor 2005, të gjithë punëtorët serb të Kosovës të cilët më parë kanë qenë të përfshirë në skemën e pagave të IPVQ-ve i kanë refuzuar pagat e tyre. Megjithatë, sipas autoriteteve relevante të shëndetësisë në komunë, autoritetet komunale janë përmbytur nga informimi i autoriteteve të nivelit qendror lidhur me refuzimet. Prandaj, personeli në fjalë edhe tani merr pagat nga IPVQ-të, si dhe pagat nga MSSH-ja, por refuzojnë që t'i nënshkruajnë dëftesat e pagave nga IPVQ-të për të mos e shkelur direktivën e QKK-së.

Në rajonin e Pejës/Peç, kjo çështje nuk ka marrë përmasa të mëdha dhe ndikimi nuk është domethënës. Veçanërisht në Komunën e Pejës, të pesë anëtarët e personelit që kanë marrë paga nga IPVQ-të i kanë refuzuar ato, por komuna ende ua paguan atyre pagat. Në Klinë, tri infermiere marrin paga vetëm nga MSSH-ja. Në Istog/Istok, në fillim të vitit 2001, gjatë katër ose pesë muajve, të punësuarit i kanë marrë pagat e DAC-it të UNMIK-ut në Komunën e Istogut/Istok. Pasi përgjegjësitë për pagesat e pagave ishin bartur te IPVQ-të, të gjithë të punësuarit e enteve paralele të kujdesit shëndetësor, përveç një infermiereje, kanë refuzuar marrjen e pagave nga IPVQ-të. Një infermiere që punon në klinikën e Osojane/Osojanit, ka qenë në listën e pagave të IPVQ-ve dhe ka marrë pagë nga IPVQ-të që nga viti 2001; ajo nuk e ka nënshkruar kontratën e punës me IPVQ-të për vitin 2006.

Në përgjithësi, refuzimi i pagave në mbarë Kosovën deri më tani nuk ka pasur efekte të dukshme në cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të ofruara të kujdesit shëndetësor. Asnjë ent nuk është detyruar që të mbyllet dhe zakonisht ka mbetur një numër adekuat i profesionistëve mjekësorë për të plotësuar nevojat e pacientëve.<sup>98</sup>

#### 5.2.1.4. Pagesa e pagave të dyfishta nga MSSH-ja

Gjatë viteve, faktori kryesor që ka përforcuar ekzistimin e strukturave paralele ka qenë pagesa e pagave të dyfishta nga MSSH-ja.<sup>99</sup> OSBE-ja është vetëdijshme për natyrën delikate të kësaj çështje dhe për vështirësitë që janë hasur në procesin e grumbullimit të të dhënave të sakta. Si rezultat i kësaj, informatat e grumbulluara nga OSBE-ja mbi këtë çështje të veçantë janë kundërthënëse dhe ndryshojnë nga rajonin në rajonin. Megjithatë, praktika e përgjithshme mbetet e njëjtë siç është vlerësuar nga

<sup>98</sup> Megjithatë, në Komunën e Leposavić/Leposavić/Leposaviqit nuk ka specialistë të mjaftueshëm, domethënë laringologë, oftamologë dhe dentistë.

<sup>99</sup> Shprehja “pagë e dyfishtë” i referohet praktikës së MSSH-së që një punëtori shëndetësor në Kosovë t’ia paguaj shumën e pagës dy herë më të madhe se një punëtori shëndetësor me kualifikime të barabarta në Serbi.

OSBE-ja në vitin 2003 – pagat (dyfish) më të larta vazhdojnë të paguhen nga MSSH-ja profesionistëve mjekësorë serb të Kosovës.<sup>100</sup>

### 5.2.2 Efekti i strukturave paralele të kujdesit shëndetësor

#### 5.2.2.1. Standardi i enteve të kujdesit shëndetësor dhe mbikëqyrja nga MSSH-ja ndikimi mbi pacientët dhe cilësinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor

Supozohet se standardet e shëndetësisë në strukturat paralele të kujdesit shëndetësor në tërë Kosovën kontrollohen nga Inspekcioni për Mbrojtjen e Shëndetit nga MSSH-ja, i cili rregullisht i viziton këto objekte.

Pas direktivës së QKK-së nuk është vërejtur asnjë ndryshim sa i përket cilësisë dhe sasisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Ka numër të mjaftueshëm të profesionistëve mjekësorë dhe nuk është mbyllur asnjë ent i kujdesit shëndetësor. Në këtë kuptim, udhëzimi i QKK-së nuk ka pasur ndonjë ndikim negativ në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

Shërbimet e kujdesit shëndetësor që u ofrohen pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në përgjithësi vlerësohen si të kënaqshme, por në disa aspekte të kufizuara dhe nën standardin e duhur. Çështjet kryesore të identifikuara lidhen me numrin e pamjaftueshëm të mjeteve të transportit (autoambulancat), mungesa e hapësirës së mjaftueshme në disa objekte, mungesa e pajisjeve bashkëkohore të nevojshme siç janë pajisjet për kujdesin dental dhe pajisjet gjinekologjike, sistematizimi joadekuat i profesionistëve mjekësorë në zonat e largëta, mosgatishmëri dhe jofleksibiliteti për të iu përgjigjur rasteve urgjente shëndetësore, pamjaftueshmëria e objekteve të kujdesit shëndetësor sekondar. Për shembull, në Kosovë nuk ka asnjë pajisje të rezonancës magnetike në hapësirat e banuara nga serbët e Kosovës, kështu që pacientët duhet që çdoherë të shkojnë në Serbi.

Në Kosovën veriore ka një numër të mjaftueshëm të profesionistëve mjekësorë në dispozicion për t'u ofruar kujdes shëndetësor pacientëve dhe të gjitha objektet shëndetësore funksionojnë. Në disa komuna, në Kosovën veriore supozohet madje të ketë plane për hapjen e objekteve të reja.<sup>101</sup> Ka numër të mjaftueshëm të profesionistëve mjekësorë për ofrimin e kujdesit shëndetësor, meqë shumë

---

<sup>100</sup> Paga mesatare që u jep MSSH-ja profesionistëve mjekësorë është rreth 500 Euro. Këto paga janë rreth dyfishi i shumës që një punëtor shëndetësor merr në Serbi, mirëpo shumica e saktë ndryshon në rajon. Duket se Serbia akoma i paguan të gjithë punëtorët që punojnë në Kosovë me 100% pagë shpërblim. Megjithatë, nuk kemi mundur të marrim asnjë informacion lidhur me saktësinë e këtyre shifrave. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane/Gnjilane, pagat e MSSH-së janë rreth 700 Euro, që është dyfishi i asaj që i njëjti punëtor shëndetësor do të merrte në Serbi. Sa i përket rajonit të Prizrenit, informacionet e mbledhura lidhur me këtë çështje janë kontradiktore. Sipas personelit serb të Kosovës, në strukturat paralele në Rahovec/Orahovac, pagat e MSSH-së që u paguhen profesionistëve mjekësorë sillen ndërmjet 400 deri 560 Euro. Sipas personelit serb të Kosovës në Prizren, në strukturat paralele të kujdesit shëndetësor dhe sipas zyrtarit komunal për komunitete, pagat e tyre sillen prej 250 deri në 350 Euro. Në komunën e Prizrenit, personeli mjekësor varet vetëm nga paga e IPVQ-ve ose nga paga e MSSH-së, çdonjëri e merr vetëm nga një pagë. Në fund, në rajonin e Pejës, paga mesatare e MSSH-së është rreth 362 Euro – megjithatë, specialistët shëndetësor që punojnë në Gorazdevac/Gorazhdec marrin pagë të dyfishtë (724 Euro)

<sup>101</sup> Në pjesën veriore të Mitrovicës.

profesionistë mjekësorë në këtë rajon janë të zhvendosur brenda vendit nga tërë Kosova, të cilët janë zhvendosur me forcë nga komunat e tyre, gjatë dhe pas vitit 1999. Megjithatë, përkundër kësaj, duket që ata nuk janë shpërndarë në atë mënyrë, që t'u shërbejnë klinikave, veçanërisht në enklavat serbe të Kosovës.<sup>102</sup> Veçanërisht në Leposavić/Leposaviq, klinikat qëndrojnë dobët me kuadro dhe me furnizime. Që të gjitha këto shtëpi të shëndetit dhe ndërtesat klinike kërkojnë renovime të mëdha dhe riparime.<sup>103</sup> Është interesante të shtohet se në Leposavić/Leposaviq është një objekt mjekësor, i cili që nga viti 1999 shërben si qendër kolektive për refugjatët nga Kroacia, që si rrjedhim zvogëlon disponueshmërinë me objektet mjekësore në qytetin e Leposavić/Leposavić/Leposaviqit .

Në rajonin e Prizrenit, në entet paralele në Rahovec/Orahovac, shërbimi i ofruar i kujdesit shëndetësor akoma nuk i përmbush standardet ekzistuese për shkak të mungesës së specialistëve. Në raste të sëmundjeve të rënda dhe testeve gjithëpërfshirëse mjekësore, pacientët detyrohen të udhëtojnë në distanca të largëta (duke i përdorur konvojet e KB-ve) për në objektet mjekësore në Mitrovicën veriore ose në Gračanica/Graçanicë.

OSBE-ja ka konstatuar që asnjë klinikë të mos vendoset në shtëpi private përveç asaj në Komunën e Klinës dhe dy qendra të ndihmës së parë në Komunën e Štrpce/Shtërpçë .<sup>104</sup> Megjithatë, duket se kjo nuk ndikon në funksionimin efikas, meqë shërbimet ofrohen në baza *ad hoc*. Kjo zakonisht shërben vetëm gjatë vizitave të mjekëve në klinikat ambulante nga Osojane/Osojani, tri here në muaj. Infermieret, të cilat punojnë në këtë klinikë janë nga po i njëjti fshat. Ato zakonisht ofrojnë shërbime në bazë të kërkesës së banorëve, duke i vizituar ata në shtëpitë e tyre. Në anën tjetër, disa ente të kujdesit shëndetësor paralel gjenden në ndërtesa tjera, të cilat nuk janë ndërtuar për ushtrimin e aktiviteteve të kujdesit shëndetësor dhe kjo shpie në mosefikasitetin e funksionimit të këtyre enteve.<sup>105</sup>

---

<sup>102</sup> Për shembull, në Zubin Potok nuk janë të mjaftueshme vizitat e mjekëve një herë në javë, veçanërisht enklavave serbe të Kosovës jashtë kufijve komunal. Ka një numër disproporcional të personelit në shtëpinë e shëndetit të Zubin Potokut, derisa nuk ka numër të mjaftueshëm në të gjitha klinikat. Kjo do të mund të shpjegohej me mungesë të automjeteve dhe pajisjeve. Në Skenderaj/Srbica , dy klinikat në Bajë dhe Suhogërlë ofrojnë kujdesin shëndetësor primar dhe mjekime të vogla emergjente. Në përgjithësi, në këto dy klinika punojnë dhjetë persona: një mjek, katër infermiere, dy pastrues, dy shoferë dhe një mjeshtër. Mjeku vjen nga Serbia, duhet të thuhet që mjeku i kësaj klinike dhe personeli i tij punojnë në tri lokacione; i treti është Cërkolez/Crkolezi në Komunën e Istog/Istokut. Mjeku qarkullon ndërmjet këtyre tri klinikave dhe nga një infermiere i mbulon çdoherë gjatë orarit të punës (deri në orën 14:00).

<sup>103</sup> Sa i përket mungesës së pajisjeve dhe infrastrukturës, më të nevojshmet janë si në vijim: autoambansportin urgjent të pacientëve nga komuna në Mitrovicë për ndihmë mjekësore, dhe pajisjet për ringjallje (në shtëpitë e shëndetit si dhe në autoambulanca)

<sup>104</sup> Sipas rezultateve të OSBE-së, në komunën e Klinës është një shtëpi në Videjë, ku ekipi mjekësor ambulant nga qendra shëndetësore e fshatit Osojanë kryen kontrolla mjekësore. Gjithashtu janë tre infermiere, të cilat janë të punësuar nga MSSH-ja, të cilat e kryejnë punën e tyre në bazë të thirrjeve nga pacientët serb të Kosovës(duke i bërë vizita pacientëve në shtëpitë e tyre). Megjithatë, kur klinika ambulante nga Osojani vie në shtëpi private në Videjë, këto dy infermiere vijnë dhe punojnë aty. Në Komunën e Štrpce/Shtërpçë , në fshatrat Sushicë dhe Biti e Epërme, hapësira e ofruar në shtëpitë private supozohet se i plotëson kriteret e nevojshme sipas zëvendës drejtorit të departamentit komunal të shëndetësisë.

<sup>105</sup> Një shembull i këtillë është në Kamenicë/Kamenica.

Objektet e kujdesit shëndetësor paralel, të cilat nuk kanë personel të përhershëm (disa klinika) pranojnë shërbime mjekësore zakonisht dy herë në javë nga ekipet mjekësore ambulante të përbëra nga mjekët dhe infermieret.

#### 5.2.2.2 Mbikëqyrja e strukturave paralele të kujdesit shëndetësor nga MSSH-ja

Si duket, entet e kujdesit shëndetësor të udhëhequra nga MSSH-ja në tërë Kosovën nuk mbikëqyren nga Beogradi në baza ditore. Kjo do të mund të çonte në keqpërdorimin e resurseve financiare, të cilat sigurohen nga MSSH-ja një strukturë të caktuar të kujdesit shëndetësor. Pasqyra e përgjithshme e këtyre rajoneve tregon mekanizma të krijuara mirë dhe lidhje me Beogradin. Megjithatë, niveli i mbikëqyrjes dallon nga rajoni në rajon, e që është më i drejtpërdrejtë dhe më i afërt në Kosovën veriore.<sup>106</sup> Nuk ka përfaqësues të MSSH-së që jetojnë në rajonet Prizren dhe Pejë.

Me pak fjalë, OSBE-ja ka vënë re që koordinimi paralel, kontrolli dhe mekanizmat e llogaridhënies janë krijuar në mbarë Kosovën përmes emërimeve (emërime direkte të drejtorëve dhe të koordinatorëve rajonalë nga MSSH-ja), vizitave dhe inspektime të shpeshta nga Inspekcioni për Mbrojtjen e Shëndetit i MSSH-së. Ka një koordinim të vazhdueshëm ndërmjet nivelit primar dhe sekondar, i cili është siguruar goxha mirë meqë, të dyja nivelet mbikëqyren drejtpërsëdrejti nga MSSH-ja. Përveç kësaj, koordinatori për strukturat paralele të shëndetësisë së Kosovës në kuadër të MSSH-së në Beograd, ka detyrë që ndër të tjera të bëjë koordinimin ndërmjet këtyre niveleve. Koordinatori, ndonëse i vendosur në Beograd, bën vizita të shpeshta në terren, strukturave paralele të kujdesit shëndetësor në Kosovë. Për më tepër, MSSH-ja është përgjegjëse për trajnimin dhe mundësitë profesionale të specialistëve mjekësor. Gjithashtu, furnizimi me barna bëhet nga Serbia. Përveç kësaj, entet e kujdesit shëndetësor paralel të Kosovës në shumë raste janë të obliguara të dorëzojnë raport gjysëmjetor ose vjetor MSSH-së, për t'u siguruar informacione mbi aktivitetet, nevojat dhe problemet e tyre.

#### 5.2.2.3. Mundësitë për profesionistët mjekësorë, shkëmbimi i informacioneve profesionale dhe vazhdimi i arsimimit mjekësor

Për momentin OSBE-ja nuk ka dijeni për çfarëdo përpjekje në integrimin e personelit mjekësor serb të Kosovës në strukturat e kujdesit shëndetësor të administruara nga

---

<sup>106</sup> Veçanërisht në rajonin e Mitrovicës, MSSH-ja mbikëqyr nga afër strukturat paralele të kujdesit shëndetësor sa i përket komunave veriore. Objektet e kujdesit shëndetësor shpeshherë vizitohen dhe inspektohen nga zyrtarët e MSSH-së në mënyrë që të kontrollojnë efikasitetin dhe në mënyrë që t'u përgjigjen nevojave lokale. Ka një koordinim të vazhdueshëm ndërmjet enteve të kujdesit shëndetësor primar dhe sekondar, meqë të gjitha klinikat dhe shtëpitë e shëndetit janë nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e qendrës mjekësore. Në rajonin e Prishtinës/Priština, sipas drejtorit të shtëpisë së shëndetit në Gračanica/Gračanicë, objekti i takon plotësisht MSSH-së, me kontrolla të rregullta nga Inspekcioni për Mbrojtjen e Shëndetit nga MSSH-së. Drejtorët e të gjitha enteve zgjidhen dhe i japin përgjegjësi MSSH-së. Qendrat Sekondare të Kujdesit Shëndetësor gjithashtu janë nën mbikëqyrjen e MSSH-së. Kohëve të fundit këto objekte janë vizituar nga MSSH-ja, që ka kontrolluar standardet shëndetësore. Rezultatet kanë qenë pozitive. Gjithashtu, është zgjedhur drejtori i këtij spitali dhe ai i përgjigjet MSSH-së. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, MSSH-ja ka zgjedhur një koordinator rajonal (me mandate 4 vjeçar), që është në kontakt të vazhdueshëm me komunitetin lokal dhe i njej nevojat dhe druajtjet e tij. Objektet e kujdesit shëndetësor paralel në rajonin e Prizrenit janë nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të MSSH-së rajonale me prani në Mitrovicë. Drejtori i shtëpisë së shëndetit në Shtërpçë megjithatë mbikëqyr personelin e MSSH-së në Sreckë dhe Mushnikovë.



IPVQ-të.<sup>107</sup> Përveç kësaj, kombinimi i zvogëlimit dhe masat për balancimin e përfaqësimit etnik në strukturat e kujdesit shëndetësor të drejtuara nga MSSH-ja do të mund të çonte në diskriminimin indirekt të punëtorëve shëndetësor serb të Kosovës, të cilët nuk kanë qasje të barabartë në punësim në mbarë Kosovën, për shkak të lirisë së kufizuar të lëvizjes, si rezultat i kërcënimeve reale dhe ato të përceptuara të sigurisë. Në institucionet komunale mundësitë janë të kufizuara, nëse specialistët mjekësorë nga strukturat paralele të kujdesit shëndetësor duan t'i mbajnë punët e tyre të tanishme. Kjo gjithashtu lidhet me direktivën e QKK-së nga dhjetori i vitit 2005, duke kërkuar që të heqin dorë nga pagat e tyre në strukturat e IPVQ-ve. Opsioni i vetëm është ndryshimi në strukturat e IPVQ me kusht që të heqin dorë nga marrja e pagës nga MSSH-ja. Kuptohet që kjo nuk është gjë e zakonshme. I vetmi veprim efikas i IPVQ-ve duket të jetë integrimi i profesionistëve mjekësorë serb të Kosovës dhe shpallaja e vendeve të lira të punës në të gjitha gjuhët zyrtare, por madje edhe kjo nuk është praktikë konsekuente e IPVQ-ve. Ky është një hap pozitiv, megjithatë duhet të shoqërohet me strategji gjithëpërfshirëse, garancione të qarta dhe paga konkurruese, në mënyrë që të ketë sukses. Gjithashtu, duhet të trajtohet çështja e profesionistëve mjekësorë të zhvendosur, të cilët janë grumbulluar dhe përqëndruar në disa komuna në veri dhe nuk kanë perspektiva dhe mundësi të reja për punë nëpër Kosovë.

Një çështje tjetër është që personeli profesional mjekësor në entet e drejtuara nga IPVQ-të dhe në entet paralele, nuk kanë mundësi të shkëmbejnë informacione dhe ekspertiza rreth çështjeve lidhur me kujdesin shëndetësor. Sipas informatave të OSBE-së, përveç klinikës shumëetnike në Dragkoc në Komunën e Štrpce/Shtërpçë, ku personeli mjekësor i të dy sistemeve e shfrytëzon objektin e njëjtë dhe si rrjedhim ka mundësi të shkëmbejë përvoja profesionale, por OSBE-ja nuk është në dijeni për raste të tilla në Kosovë.

Sa u përket mundësive për vazhdimin e arsimit mjekësor në përgjithësi, asnjë pjesëtar i personelit mjekësor serb të Kosovës nuk kishte vijuar kurset apo trajnimet e organizuara nga MSH-ja, në vitet e kaluara. Në anën tjetër, ka raste ku profesionistët mjekësorë serb të Kosovës i kanë bojkotuar ftesat e IPVQ-ve. Për shembull, sipas informatave nga Komuna e Štrpce/Shtërpçë, koordinatori rajonal i shëndetësisë i IPVQ-ve në vitin 2005, u ofroi specializim mjekësor serb të Kosovës në mjekësinë familjare. Por, kjo ofertë u refuzua.

Shumica e profesionistëve të kujdesit shëndetësor në sistemin paralel marrin pjesë në trajnime dhe konferenca në Serbi. Megjithatë, ata nuk kanë çdoherë qasje të lehtë në arsimin e tillë mjekësor të vazhdueshëm. Gjithashtu, duhet të theksohet që personeli në entet e kujdesit shëndetësor të drejtuara nga IPVQ-të nuk mund të vijojë edukim të vazhdueshëm mjekësor të ofruar nga MSSH-ja në Kosovë ose në Serbi.

Me pak fjalë, mungesa e ndërveprimit konstruktiv ndërmjet dy sistemeve të kujdesit shëndetësor ndikon negativisht tek pacientët që kanë nevojë për kujdes shëndetësor. Derisa të miratohet një qasje e gjithanshme dhe kompromise nga të dyja palët, Prishtina dhe Beogradi, ekzistenca e strukturave paralele të kujdesit shëndetësor do të

---

<sup>107</sup> Për shembull në rajonin e Prishtinës/Priştinas dihet vetëm për një rast ku punon një mjek serb i Kosovës në institucionet e IPVQ-ve në Fushë Kosovë/Kosovo Polje. Sipas drejtorit të shëndetësisë në Prizren, para tre viteve një mjeku serb të Kosovës që punonte në shtëpi të shëndetit i është ofruar bashkëpunim në strukturën e IPVQ-ve në Prizren, si dhe pagë të IPVQ-ve. Megjithatë, personi në fjalë nuk ka qenë i interesuar për këtë ofertë. Në ndërkohë ai e ka lëshuar punën.

vazhdojë të arsyetohet deri në një masë të caktuar, si përmbushje e nevojës dhe ofrim i shërbimit themelor shëndetësor për komunitetet pakicë.

## 6. PËRFUNDIMET

Siç është paraqitur në raport nga viti 2003 dhe e konfirmuar në këtë rivlerësim, strukturat paralele vazhdojnë të ekzistojnë në disa fusha të sektorit publik. Strukturat paralele janë një çështje shumë e politizuar. Duke vazhduar financimin e këtyre strukturave, Qeveria e Serbisë vazhdon të ushtrojë kontroll mbi disa pjesë të Kosovës. Është për t'u diskutuar se të drejtat dhe interesat e individëve janë prekur nga refuzimi i UNMIK-ut dhe i IPVQ-ve për njohjen e vendimeve të marra nga strukturat paralele dhe nga refuzimi i autoriteteve serbe që të shpërbëjë ose integrojë strukturat paralele.

Ekzistimi i strukturave paralele mund ta dëmtojë sundimin e ligjit. Ndonjëherë, ndonëse, mund ta plotësojë këtë sistem, duke i mbuluar zbrazëtirat dhe më pas duke siguruar qasje në shërbime të caktuara për pjesëtarët e komuniteteve pakicë.

Mungesa e njohjes së lejeve të ndërtimit nga strukturat e IPVQ-ve ose të dhënat kadastrale të lëshuara nga autoriteti paralel mund të rezultojë me humbjen e pronave për kosovarët. Njësoj alarmues është problemi nga gjykimi i dyfishtë në dritën e vendimeve të gjykatave paralele nga gjykatat e qarkut në Serbi. UNMIK-u dhe IPVQ-të duhet gjithashtu ta kenë parasysh që nxënësit nga Kosova, të cilët dëshirojnë t'i vazhdojnë studimet e tyre në Serbi, nuk mund ta bëjnë poqëse nuk kanë dokumente të lëshuara nga autoritetet serbe.

OSBE-ja beson se spitalet dhe entet e tjera të kujdesit shëndetësor të drejtuara nga serbët kanë dëshmuar të jenë të nevojshme akoma për ofrimin e shërbimeve të disa komuniteteve pakicë, të cilët i shmangen kërkit të ndihmës nga institucionet kosovare të kujdesit shëndetësor për shkak të mungesës së besimit. Në shumë zona të kthimit, ofrimi i kujdesit shëndetësor është ngushtësisht i lidhur me kthimin e suksesshëm të serbëve të Kosovës. Kështu që është me rëndësi që MSH-ja të alokoj resurset e nevojshme dhe të merrë masa praktike për të iu qasur komuniteteve pakicë për t'i ndihmuar që ta tejkalojnë frikën e tyre për materializimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga MSH-ja. Përveç kësaj, që të dy ministritë e shëndetësisë (MSH-ja dhe MSSH-ja) duhet të bashkëpunojnë me qëllim të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore për të gjitha komunitetet në Kosovë.

Nevojitet një qasje pragmatike dhe angazhim i fuqishëm për ta realizuar shpërbërjen dhe integrimin e strukturave paralele. Për më tepër, njohja e kësaj duhet të jetë pjesë thelbësore e negociatave mbi statusin e ardhshëm të Kosovës. Rruga pa krye aktualisht duhet të zgjidhet me marrëveshje politike ndërmjet IPVQ-ve dhe autoriteteve serbe për mënyrat e shkuarjes përpara. Një mënyrë për të iu qasur kësaj çështjeje të ndërlikuar është përmes procesit të decentralizimit. Në lidhje me këtë, bartësit relevantë duhet ta kenë parasysh kur të negocijojnë për decentralizimin, që çështjet si e drejta për qasje të barabartë në arsim, e drejta për qasje të barabartë në kujdes shëndetësor, e drejta për liri të lëvizjes, e drejta pronësore dhe e drejta për mjete juridike efikase janë gjëra thelbësore.

Sa i përket çështjeve të sigurisë, të gjithë policët e SHPK-së përballen me të njëjta vështirësi gjatë kryerjes së punës së tyre, duke përfshirë ato të cilat dalin nga papërvoja, mungesa e pajisjeve të duhura dhe paga e ulët. Gjendja e sigurisë në Kosovën veriore dhe sidomos në pjesën veriore të Mitrovicës, është shumë larg nga gjendja normale dhe vazhdon të paraqet probleme për vendosjen e sundimit të ligjit dhe funksionimin e shërbimit policor. Për ta përmirësuar këtë situatë, do të jetë vështirë të gjenden zgjidhje, që janë në interesin e të gjitha palëve të interesuara në Kosovën veriore: banorët, udhëheqësia politike, shërbimi policor dhe komuniteti ndërkombëtar.

Çfarëdo mjete dhe metoda që bashkësia ndërkombëtare dhe IPVQ-të vendosin për të përdorur, në mënyrë që ta zgjidhin problemin e strukturave paralele gjatë marrëveshjes për statusin dhe implementimin e saj ata duhet të përipiqen që mos t'i dëmtojnë ata, të cilët kanë përfituar nga ata për fat të mirë ose të largohen ata, cilët kanë punuar në kuadër të strukturave paralele. Duhet të mbizotërojë sistemi ku mbrohen dhe sigurohen të gjitha të drejtat e njerëzve, kur të zgjidhet çështja e strukturave paralele në Kosovën e sotme.

## **Shtojca I: Institucionet arsimore paralele në Kosovë**

### **Rajoni i Gjilanit/Gnjilane/Gnjilane**

Gjilan/Gnjilane:

Shkolla Filllore ‘Sveti Sava’ (Paralovo/Parallovë me degë në Ponesh/Poneš, Shkolla Filllore ‘Bora Stanković’ në Koretište/Koretishtë dhe me degën e saj në Straža/Strazhë, Shkolla Filllore ‘Petar Petrović Njegos’ në Kufcë të Epërme me degët në Gornji Makreš/Makresh i Epërm dhe Stanišor/Stanishor, Shkolla Filllore ‘Vuk Karadžić’ në Šilovo/Shillovë me degët në Kmetoc/Kmetovce, Livoc i Epërm/Gornji Livoč dhe Gjilan/Gnjilane, Shkolla Filllore ‘Miladin Popović’ (Pasjane/Pasjan), Shkolla Filllore ‘Dositej Obradović’ (Parteš/Partesh) dhe me degën në Budrikë e Poshtme, ‘Branko Radičević’ në Cernicë/Cernica, Shkolla e Mesme Ekonomike dhe Biznes në Koretište/Koretishte me degën në Parteš/Partesh), Shkolla e Mesme Teknike në Kusce/Kufcë e Epërme me degën në Parteš/Partesh dhe Shkolla e Mesme në Shillovë, me degën në Pasjane/Pasjan.

Viti/Vitina:

Shkolla Filllore ‘Marko Rajković’ (Vrbovac/Vërboc, me degën në Mogillë/Mogila, Shkolla Filllore ‘Sveti Sava’ (Klokot/Kllokot), Shkolla Filllore ‘Mladan Marković’ në qytetin Viti/Vitina me degën në Binçë/Binač dhe Shkolla e Mesme Teknike në (Vrbovac/Vërboc).

Novobërdë:

Shkolla Filllore ‘Dositej Obradović’ (Prekovce/Prekoc me degët në Izvor dhe Zebincë/Zebince), Shkolla Filllore ‘Miladin Popović’ (Bostane/Boston) me degën e saj në Stara Kolonia dhe Shkolla Filllore ‘Sveti Sava’ (Jasenovik).

Štrpce/Shtërpçë:

Shkolla Filllore ‘Staja Marković’ në Štrpce/Shtërpçë, me degët në Biti të Epërme dhe Sushicë, Shkolla Filllore ‘Rajko Urošević’ në Gotovuša/Gotovushë, me degë në Viçë, Shkolla Filllore ‘Šarski Odred’ në Sevcë, me degët e saj në Jažince/Jazhincë dhe Vrbeštica/Vrbeshticë dhe Shkolla e Mesme ‘Jovan Cvijić’ në Štrpce/Shtërpçë, me degën në Gornja Bitina/Biti të Epërme.

Kamenicë/Kamenica:

Shkolla Filllore ‘Trajko Perić’ në Veliko Ropotovo/Ropotovë e Madhe, Shkolla Filllore ‘Veljko Dugošević’ në Ranillug/Ranilug, Shkolla Filllore ‘Desanka Maksimović’ në Kamenicë/Kamenica, Shkolla Filllore ‘Brastvo i Jedinstvo’ në Strezovce/Strezocë, Shkolla Filllore ‘9 Maj’ në Kololeč/Kolloleq, Shkolla e Mesme Teknike në qytetin e Kamenicës/Kamenica dhe Veliko Ropotovo/Ropotovë e Madhe, Gjimnazi në qytetin e Kamenicës dhe në Ropotovë të Madhe, Shkolla e Mesme e Mjekësisë në Veliko Ropotovo/Ropotovë e Madhe dhe në Pasjane/Pasjanë, Shkolla e Mesme Ekonomike

në Ranillug dhe Kusce dhe Institucioni Parashkollor 'Pčelica Maja' në Veliko Ropotovo/Ropotovë të Madhe me degët e saja në Ranillug/Ranilug, Korminjane/Korminjanë, Berivojcë/Berivojce, Domorovce/Domorovcë, Bošče/Boscë, Ajnovce/Hajnovc, Tomance/Tomancë and Kamenicë/Kamenica.

### **Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica:**

Leposavić/Leposaviq:

Shkolla Fillore 'Leposavić' në Leposavić/Leposaviq me degët në Dren, Jošanica/Jashanicë dhe Kijevčići/Kijevçiqë, Shkolla Fillore 'Vuk Karadžić' në Sočanica/Soçanicë, me degët në Gornja Sočanica dhe Vuča/Vuçë, Shkolla Fillore 'Stana Bačanin' në Lešak/Leshak, me degët në Belo Brdo/Belobradë, Guvnište/Guvnishtë, Miokovići/Miokoviq, Vračevo/Vraqevë, Ostraće/Ostraqë, Donji Krnjin/Këmin i Ulët, Beluće/Beluqë dhe Bistrica/Bistricë), Shkolla e Mesme Teknike 'Nikola Tesla' në Leposavić/Leposaviq dhe Shkolla e Mesme e Bujqësisë në Leposavić/Leposaviq e zhvendosur nga Prishtinë/Priština që nga viti 1999.

Skenderaj/Srbica:

Shkollat Fillore në Banja/Bajë dhe Suvo Grlo/Suhogërlle.

Zubin Potok:

Shkolla Fillore 'Jovan Cvijić' në Zubin Potok, me degët në Velji Breg/Breg i Madh, Crepulja/Crepulë, Kovače/Kovaçë dhe Dren, Shkolla Fillore 'Blagoje Radić' në Zupče/Zupç me degën në Rujšite/Rujishtë, Shkolla Fillore 'Petar Kocić' në Brnjak/Bërnjak, me degët në Lučka Reka/Lluçkarekë, Bube dhe Banja/Banjë, Shkolla Mesme Teknike 'Grigorije Božović' në Zubin Potok.

Zvečan/Zveçan:

Shkolla Fillore 'Vuk Karadžić' në Zvečan/Zveçan, Shkolla e Mesme 'Zvečan' në Zvečan/Zveçan, Shkolla Fillore 'Sveti Sava' në Žerovnica/Zherovnicë dhe Shkolla Fillore 'Banović Strahinja' në Bajnska/Banjškë.

Vushtrri/Vučitrn:

Shkolla Fillore 'Vuk Karadžić' në Priluzje/Prelluzhë, Shkolla Fillore 'Sveti Sava' në Gracë, Shkolla e Mesme Teknike 'Nikola Tesla' në Priluzje/Prelluzhë dhe Shkolla e Mesme '21 Novembar' në Gojbulja/Gojbulë.

Mitrovica veriore:

Shkollat Fillore: 'Branko Radičević' dhe 'Sveti Sava'. Shkollat tjera fillore fillimisht kanë funksionuar në pjesën jugore të komunës, por janë rivendosur në veri pas konfliktit të vitit 1999 dhe trazirave të marsit 2004. Këtu përfshihen: 'Dositej Obradović', 'Desanka Maksimović', 'Miodrag Vasiljević' (shkolla fillore dhe e

mesme), ‘Veljko Banašević’, ‘Braća Mihajlović’, ‘Vlada Četković’ dhe ‘Rade Milićević’. Shkollat e Mesme: ‘Mihajlo Petrović’, Shkolla Teknike ‘Desa Tomović’, Shkolla e Mesme e Mjekësisë. Gjinnazi dhe shkollat e mesme të tregtisë dhe ekonomisë nga jugu u zhvendosën në veri pas konfliktit, derisa Gjinnazi dhe Shkolla e Mesme nga Vushtrri/Vučitrna funksionojnë në pjesën veriore.

### **Rajoni i Pejës/Peć**

Pejë/Peć:

Shkolla Fillore ‘Janko Jovičić’ në Goraždevac/Goraždevac/Gorazhdec , Gjinnazi ‘Sveti Sava’ në Goraždevac/Goraždevac/Gorazhdec , ‘Mileva Vuković’ Shkolla Ekonomike në Goraždevac/Goraždevac/Gorazhdec dhe Shkolla Teknike në Goraždevac/Goraždevac/Gorazhdec .

Klinë/Klina:

Shkolla Fillore në Vidanje/Videjë – është nëndegë e shkollës në Osojane/Osojan.

Istog/Istok:

Shkolla Fillore ‘Radoš Tošić’ në Osojan, Shkolla Fillore ‘Jedinstvo’ në Čerkolez/Crkolez/Crkolez dhe paralelen në Goraždevac/Goraždevac/Gorazhdec , Shkolla e Mesme në Osojane/Osojan.

### **Rajoni i Prishtinës/Priština**

Fushë Kosovë/Kosovo Polje:

Shkolla Fillore ‘Aca Marović’ në Bresje, Shkolla Fillore ‘Aca Marović’ paralele e shkollës në Kuzmin, Shkolla Fillore ‘Vuk Karadžić’ në Bresje, Shkolla Fillore ‘Ugljare’ në Ugljare/Uglar, Shkolla Fillore ‘Aca Marović’ në Batuse/Batushë, Çerdhja e Fëmijëve ‘Nasa Radost’ në Ugljare/Uglar dhe Shkolla e Mesme e Mjekësisë (më parë e vendosur në “Sveti Sava” kaloi në fshatin Lepina/Lepi në komunën e Lipjan/Lipljanit. Ish shkolla “Sveti Sava” në Bresje funksionon sipas vendimit ekzekutiv të PSSP-së. Kjo shkollë është e vendosur në zonën e dominuar shqipfolëse të Kosovës. Shkolla fillimisht funksiononte ndarazi, duke shfrytëzuar të njëjtin objekt, me strukturë të ndarë menaxhuese të mbledhur nga personeli i lartë nga të dy shkollat ‘Sveti Sava’ dhe ‘Hivzi Sylejmani’. Propozimet e departamentit komunal të arsimit për të themeluar personelin e përbashkët dhe strukturat menaxhuese u përballën me rezistencën e personelit serb të Kosovës dhe u refuzua, pasi që kjo do të interpretohej si pranim i sistemit arsimor dhe planprogramit të Kosovës. (Ndërrimi i mëngjesit për nxënësit serb dhe rom të Kosovës akoma funksionon sipas MASHS-it).

Prishtinë/Priština:

Shkolla Fillore ‘Kralj Milutin’ në Gračanica/Gračanicë, Shkolla e Mesme e Mjekësisë në Gračanica/Gračanicë, Shkolla e Fillore dhe e Mesme e Muzikës në Gračanica/Gračanicë, Shkolla e Mesme e Arkitekturës dhe Komunikacionit në

Gračanica/Gračanicë, Institucioni Parashkollor 'Djurdjevak' në Gračanica/Gračanicë, Shkolla Filllore 'Sveti Sava' në Sušica/Sushicë, Shkolla e Mesme Elektro-Teknike në Sushicë, Shkolla Filllore 'Miladin Mitić' në Llapnasellë, Gjinnazi në Laplje Selo/Llapnasellë, Shkolla e Mesme Teknike në Preoce/Preoc dhe Shkolla Filllore 'D. Prica' në Donja Brnjica/Bernicë e Poshtime.

Lipjan/Lipljan:

Shkolla Filllore 'Braća Aksić' në qytetin e Lipjan/Lipljanit dhe katër paralele të ndara në Rubofc/Rabovce, Suvi Do/Suhadoll, Novo Naselje/Lagje e Re dhe Grackë e Vjetër/Staro Gracko, Shkolla Filllore në Janjevë/Janjevo, 'Knez Lazar' në Donja Gušterica/Gushtericë e Ulët me tre paralele në Dobrotin/Dobratin, Livade/Livagjë and Gornja Gušterica/Gushtericë e Epërme, Shkolla Filllore 'Vuk Karadžić' në Lepina/Lepi dhe paralelen e shkollës në Skulanevo/Skullan, Shkolla e Mesme 'SAGS' me dy degët – Gjinnazi në Lepina/Lepi dhe Shkolla e Bujqësisë në Donja Gušterica/Gushtericë e Ulët.

Obiliq/Obilić:

Shkolla Filllore 'Branko Radičević' në Obiliq/Obilić, Shkolla Filllore 'Dositej Obradović' në Caravodicë/Crkvena Vodica, Shkolla Filllore 'Milan Rakić' në Babimoc/Babin Most dhe Shkolla Filllore 'Sveti Sava' në Plemetin/Plemetina dhe dy klasë paralele nga shkollat e mesme në Gračanica/Gračanicë.

## **Rajoni i Prizrenit**

Rahovec/Orahovac:

Shkolla Filllore 'Vuk Karadžić' në Rahovec/Orahovacin e Epërm, Shkolla Filllore 'Svetozar Marković' në Velika Hoča/Hoçë e Madhe dhe Gjinnazi në Rahovec/Orahovacin e Epërm). Një shkollë tjetër e quajtur 'Dositej Obradović', Shkolla Filllore në Rahovec/Orahovacin e Epërm ekziston vetëm në letër. Në të vërtetë, studentët janë regjistruar në 'Vuk Karadžić', ndërkaq personeli arsimor është bashkuar nga të dyja shkollat.

Dragash/Dragaš:

Shkolla Filllore 'Nezim Berati' në Dragash/Dragaš, Shkolla Filllore '22 Decembar' në Restelica/Restelicë<sup>108</sup>, Shkolla Filllore '5 Oktobar' në Kruševo/Krushevë, Shkolla Filllore '25 Maj' në Vranište/Vranishtë), Shkolla Filllore 'Zenun Zenuni' në Brod, Shkolla Filllore '9 Maj' në Rapča/Rapqë dhe Shkolla e Mesme 'Ruzhdi Berisha' në Dragash/Dragaš.

---

<sup>108</sup> Megjithatë në janar 2007, zyrtarët e OSBE-së ishin informuar se nxënësit në Restelica/Restelicë ndjekin mësimet sipas sistemit të MASHT-it të IPVQ-ve

## **Shtojca II: Entet e kujdesit shëndetësor paralel në Kosovë**

### **Rajoni i Gjilanit/Gnjilane**

Në Komunën e Gjilanit/Gnjilane – është spitali (reparti i internos dhe pediatriisë) “Dr. Josif Vasić”, në fshatin Shilovë, që ofron kujdes shëndetësor sekondar si dhe shtëpia e shëndetit në Shilovë. Përveç kësaj, disa klinika ofrojnë kujdes shëndetësor primar në fshatrat Shilovë, Kufcë e Epërme, Kmetovc, Stanishor, Koretishtë, Ponesh, Parallovë, Partesh, Budrikë, Pasjan dhe klinika e kishës në Gjilan.

Në Komunën e Vitisë/Vitina – dy objektet e kujdesit shëndetësor paralel të quajtura qendrat e mjekësisë familjare janë të vendosuar, respektivisht në fshatin Kllokot dhe Verbovc (që të dyja ofrojnë kujdes shëndetësor primar).

Në Komunën e Štrpcë/Shtërpçë – ka disa (11) objekte të kujdesit shëndetësor paralel: Shtëpia e Shëndetit e qytetit të Štrpcë/Shtërpçë “Dom Zdravlja Štrpcë” (kryesisht qendër e kujdesit shëndetësor primar, që ofron gjithashtu disa shërbime të kujdesit shëndetësor sekondar, si shërbime ortopedike dhe operacione të vogla); klinika në fshatin Drajkovce/Drajkofc (objekti i kujdesit shëndetësor primar (multietnik, përdorej nga IPVQ-të/MSH-ja dhe Ministria Serbe e Shëndetësisë - sistemi i saj shëndetësor); klinika në fshatin Brezovicë (kujdes shëndetësor primar); klinika në fshatin Sevcë/Sevcë (kujdes shëndetësor primar); klinika në fshatin Gotovuša/Gotovusha (kujdes shëndetësor primar); klinika në fshatin Jažince/Jazhincë (kujdes shëndetësor primar); qendra për ndihmë të parë në fshatin Donja Bitinja/Biti e Poshtinë (kujdes shëndetësor primar); qendra për ndihmë të parë në fshatin Vrbeštica/Verbeshticë (kujdes shëndetësor primar); qendra për ndihmë të parë në fshatin Sušice/Sushiq (kujdes shëndetësor primar); qendra për ndihmë të parë në fshatin Gornja Bitinja/Biti e Eperme (kujdes shëndetësor primar); qendra për ndihmë të parë në qendrën kolektive “Lahor” (kujdes shëndetësor primar).

Në Komunën e Kamenicës/Kamenica – Qendra e Mjekësisë Familjare në Ranilug/Raniluk, Ambulanta e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Kamenicë/Kamenica dhe nëntë (9) klinika tjera, të cilat janë të vendosura në Gornje Korminjane/Korminjan i Epërm, Veliko Ropotovo/Ropotovë e Madhe, Bosce/Boscë, Ajnovce/Hajnoc, Kololec/Kolloleq, Domorovce/Domoroc, Božovce/Bozhevcë, Rajanovce/Rajanoc dhe Bušince/Bushincë ofrojnë kujdes shëndetësor primar.

Në Komunën e Ferizajit/Uroševac – nuk ka struktura paralele të kujdesit shëndetësor. Megjithatë, është një ekip i mjekëve serb të Kosovës nga klinika e Gušterica/Gushtericë, në Komunën e Lipjan/Lipljanit, që në koordinim me autoritetet vendore u bëjnë vizita të kthyerve në Bablak/Babljak rregullisht. Në parim, shërbimet paralele të kujdesit shëndetësor në Bablak/Babljak përbëjnë mjekët dhe personelin shëndetësor që vizitojnë Bablak/Babljak, në mënyrë që të takohen me të



kthyerit dhe t'i furnizojnë me barna. Klinika në Gušterica/Gushtericë është strukturë paralele. Në të kaluarën komuna u ka siguruar transportin këtyre mjekëve dhe personelit mjekësor, tani nuk u duhet më kjo, por komuna është e gatshme t'u siguroj, nëse nevojitet. Zyrtari komunal për komunitete u takua me menaxherët e kësaj klinike dhe Komuna e Ferizajit/Uroševac ishte dhe është e vetëdijshme që kjo është strukturë paralele, por me këtë deshën t'u ndihmojnë të kthyerve.

Në Komunën e Novobërdës/Novo Brdo – janë dy objekte të kujdesit paralel shëndetësor- një ambulantë e vendosur në Jasenovik dhe një Qendër e Mjekësisë Familjare e vendosur në Prekoc/Prekovce. Nuk ka emër të caktuar dhe që të dyja ofrojnë kujdes shëndetësor primar.

### **Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica**

Në Komunën e Zubin Potokut – shtëpia e shëndetit (ofron kujdes primar shëndetësor-me mjekë dhe infermiere të përgjithshëm dhe të specializuar, por jo trajtime klinike) dhe tri klinika, ku ka të punësuar infermiere dhe mjekët u bëjnë vizita një herë në javë fshatrave të largëta.

Në Komunën e Leposavić/Leposavić/Leposavić/Leposaviqit – ka një shtëpi shëndeti (që ofron kujdesin shëndetësor primar- mjekë dhe infermiere të specializuar dhe të përgjithshëm, por jo trajtim klinik) dhe tri klinika ku punojnë vetëm infermiere dhe mjeku i viziton njëherë në javë në Kaljin (nuk ekziston emri në gjuhën shqipe pasi që fshati nuk është regjistruar zyrtarisht) (boshnjak të Kosovës) Socanica/Socanice (serb e Kosovës) dhe Lesak/Leshak (serb e Kosovës).

Në Komunën e Zvečan/Zveçanit – një shtëpi shëndeti në qytetin e Zvečan/Zveçanit dhe tre klinika në fashtrat Grabovac/Graboc, Žerovnica/Zherovnicë dhe Banjska/Banjskë. Të gjitha objektet e përmendura të kujdesit shëndetësor ofrojnë kujdes shëndetësor primar.

Në Mitrovicën veriore – një spital dhe një shtëpi shëndeti, si dhe një klinikë e locuar në Suvi Do/Suhodolli dhe një klinikë në Qendrën Studentore (konvikte). Spitali në Mitrovicën veriore ofron kujdes shëndetësor sekondar, ndërsa objektet tjera të përmendura ofrojnë kujdes shëndetësor primar.

Në Mitrovicën jugore – Pas konfliktit të vitit 1999, Spitali i Mitrovicës mbeti në pjesën veriore të qytetit, derisa shtëpia e shëndetit (klinika) në jug u shndërrua në një spital të përshtatur vetëm për kujdesin shëndetësor primar. Klinika në jug qeveriset nga Ministria e Shëndetësisë së IPVQ-ve. Në pjesën jugore ka pjesëtarë të ndryshëm të komuniteteve pakicë (boshnjak, turq, ashkali) por vetëm pesë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës jetojnë në fshatin Svinjarë/ Svinjare. Në pjesën jugore të Mitrovicës nuk ka struktura shëndetësore paralele.

Në Komunën e Skenderaj/Srbica it/Srbica – funksionojnë dy klinika, një në Bajë/Banja dhe një në Syriganë/Suvo Grlo, ku ofrohet kujdesi shëndetësor primar dhe kryhen trajtime të lehta emergjente.

Në Komunën e Vushtrrisë/Vuçitrne – tani ka katër objekte të kujdesit shëndetësor paralel – një shtëpi të shëndetit “Dom Zdravlja” që fillimisht funksiononte në Obiliq/Obilić, por tani funksionon në Prelluzhë/Priluzje; shtëpia e shëndetit mban tri degë në formë të klinikave në Gracë/Grace (gjashtë infermiere dhe dy persona për logjistikë), në Goibulë/Gojbulja (pesë infermiere, një person për logjistikë dhe një roje); dhe në Banjskë/Banjska (një infermiere dhe një person për logjistikë).

### **Rajoni i Pejës/Peć**

Në Komunën e Pejës/ Peć – një kinikë në Goraždevac/Goraždevac/Gorazhdec , e cila ofron kujdes shëndetësor primar.

Në Komunën e Istog/Istokut – ka klinika në tri (3) fshatra - Osojan/Osojane, Crkoljez/Cërkolez/Crkolez dhe Suvo Gerlo/Suho Gërlë – ofron kujdes shëndetësor primar.

Në Komunën e Klinës/Klina – nuk ka ndonjë objekt shëndetësor ose shtëpi të shëndetit. Serbët e Kosovës shkojnë në shtëpinë e shëndetit në Osojan/Osojane, që gjendet në Komunën e Istog/Istokut. Megjithatë, është një shtëpi e shëndetit në Videjë/Vidanje, ku një ekip mjekësor ambulant nga qendra shëndetësore e fshatit Osojan/Osojane kryen kontrolla mjekësore. Gjithashtu, janë edhe tri infermiere, të cilat janë punësuar nga MSSH-ja, që punojnë në bazë të kërkesave/thirrjeve të pacientëve serb të Kosovës (duke i vizituar pacientët në shtëpitë e tyre).

### **Rajoni i Prishtinës/Priština**

Në enklavën e Gračanica/Graçanicës – qendra e kujdesit shëndetësor primar është shtëpia e shëndetit në Gračanica/Graçanicë, nën administrimin e së cilës janë ambulancat në fshatrat vijuese: Laplje Selo/Llapnaselle, Preoce/Preoce, Čaglavica/Cagllavicë, Donja Brnjica/Bërnice e Ulët, Sušica/Sushicë, Slivovo/Sllivovë dhe Prekovce/Prekovc (Komuna e Novobërdës/Novo Brdo ).

Qendër e kujdesit shëndetësor sekondar është Qendra Klinike Spitalore (QKS) “Priština”, që gjendet në Gračanica/Graçanicë, nën administrimin e së cilës janë objektet në vijim: Klinika Gjinekologjike “Majka devet Jugovica” në Gračanica/Graçanicë; Klinika Kirurgjike “Simonida” në Gračanica/Graçanicë; Klinika Interno-Pediatrike “Kralj Milutin” në Laplje Selo/Llapnaselle; Kabineti Radiologjik (RTG) në Gračanica/Graçanicë; Mikro-biologjia në Gračanica/Graçanicë; pjesë e Spitalit të Prizrenit në Rahovec/Orahovac, ambulancat në Velika Hoca/ Hoca e Madhe, Osojane/Osojan, Goraždevac/Goraždevac/Gorazhdec , Dragash/Dragaš

gjithashtu janë nën mbikëqyrjen dhe në listën e pagave të Qendrës Klinike Spitalore të Prishtinës/Priština (që gjendet në Gračanica/Graçanicë).

Në Komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje – janë tri objekte të kujdesit shëndetësor paralel, të cilat ofrojnë shërbime shëndetësore të kujdesit shëndetësor primar dhe gjenden në fshatrat Ugljare/Uglar, Kuzmin/Kuzmin dhe Batuše/Batushe.

Në Komunën e Lipjanit/Lipljan – është një shtëpi shëndeti që gjendet në Donja Gušterica/Gushtericë e ulët, e cila ofron shërbime të kujdesit shëndetësor primar dhe sekondar dha ka njëmbëdhjetë (11) ambulanca, të cilat ofrojnë kujdes shëndetësor primar në qytetet vijuese: Gornja Gušterica/Gushtericë e Epërme, Rubovc/Rabovce, Grackë e Vjetër/Staro Gracko, Novo Naselje/Lagje e Re, Suvi Do /Suhadoll, Lepina/Lepi, Livade/Livagjë, Skulanevo/Skullan, Dobrotin/Dobratin, Janjevë/Janjevo.

Në Komunën e Obiliqit/Obilić – janë katër klinika, të cilat ofrojnë kujdes shëndetësor primar, repsektivisht në qytetin Obiliq/Obilić (ndonëse atje nuk ka personel të përhershëm, por mjekë të kohëpaskohshëm, që nga marsi 2004) dhe në fshatrat Caravodicë/Crkvena Vodica, Plemetin/Plemetina dhe Babimoc/Babin Most. Për kujdesin shëndetësor sekondar ose në rast të ndonjë problemi seroiz shëndetësor, pacientët udhëzohen të shkojnë në spitalet në Mitrovicës/Mitrovica, Gračanica/Graçanicës ose Laplje Selo/Llapllaselle. Klinka kryesore ka qenë në qytetin e Obiliq/Obilićit, por është zhvendosur pas vitit 1999 në Priluzje/Prelluzhe, në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn. Kjo klinikë tani i furnizon katër të sipërpërmendurat me barna dhe ka rol mbikëqyrës si hallkë me MSSH-në.

### **Rajoni i Prizrenit**

Në Komunën e Prizrenit – janë dy shtëpi paralele të shëndetit (SHSH), të cilat ofrojnë kujdes shëndetësor primar, që të dyja menaxhohen nga SHSH-ja e Štrpce/Shtërpçë . Njëra gjendet në Sredska/Sreckë, një fshat me serb të Kosovës me 110 banorë, të gjithë janë serb të Kosovës, dhe tjetra gjendet në Mushnikovë/Mušnikovo, një fshat shumëetnik me 1370 shqiptarë të Kosovës, 140 boshnjakë të Kosovës dhe 90 serb të Kosovës. (burimi - dhjetor 2005, profilet e fshatrave, të përpiluara nga ekipi komunal (EK) në Prizren. Veçanërisht, është një SHSH tjetër në fshatin Mushnikovës/Mušnikovo, e cila menaxhohet nga Drejtoria e Shëndetësisë në Prizren.

Në Komunën e Rahovec/Orahovacit – janë dy klinika paralele (kujdes shëndetësor primar) në Rahovec/Orahovacin e Epërm dhe në fshatin Velika Hoča/Hoçë e Madhe (nuk është dhënë ndonjë emër i veçantë).